

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit**  
**Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**KOSOVË**

**SHQYRTIMI I PARË I SISTEMIT TË DREJTËSISË CIVILE**

**Qershor 2006**

<b>FJALORTH.....</b>	<b>4</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>5</b>
<b>Kapitulli 1.....</b>	<b>7</b>
Vonesat në procedurën civile .....	7
1. Menaxhimi i dobët i lëndëve.....	7
1.1 Mungesa e menaxhimit dhe menaxhimi joefektiv i lëndëve në fazën paraprake të procedurës .....	8
1.1.2 Mos ekzaminimi ose ekzaminimi i gabuar paraprak i padisë.....	8
1.1.3 Dështimi për dorëzimin e padisë palës së kundërt para seancës kryesore.....	10
1.1.4 Dështimi në paraqitjen e dëshmive para fillimit të seancës së shqyrtimit .....	11
1.2 Numri i tepruar i seancave dhe shtyerjet.....	12
2. Problemet lidhur me dorëzimin e ftesave gjyqësore.....	14
3. Të metat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore .....	16
3.1 Përgjigjja në padi dhe kundërpadi .....	16
3.2 Dështimi në përcaktimin e afateve kohore .....	17
3.3 Mungesa e dispozitave me të cilat rregullohet çështja e shtyerjeve .....	18
4. Rekomandimet .....	18
<b>Kapitulli 2.....</b>	<b>20</b>
Transaksionet Pronësore.....	20
1. Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dhe jo të rregullta.....	21
2. Kërkesat pronësore kundër personave në mungesë pa njohurinë e tyre .....	25
2.1 Çështjet periodike përkitazi me emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në kontestet pronësore që përfshijnë pakicat etnike .....	26
3. Trashëgimia nga e kaluara.....	30
3.1. Kontratat joformale .....	31
3.2. Problemet rreth pronës së trashëguar.....	34
4. Rekomandimet .....	36
<b>Kapitulli 3.....</b>	<b>38</b>
<b>Ndërhyrjet në procedurat gjyqësore dhe gjyqësinë .....</b>	<b>38</b>
1. Ndërhyrjet jo të rregullta nga ana e autoriteteve komunale .....	39
2. Ndërhyrjet jo të rregullta nga ana e Departamentit të Drejtësisë.....	40
3. Rekomandimet .....	44

<b>Kapitulli 4.....</b>	<b>46</b>
<b>Çështjet që kanë të bëjnë me procedurat përmbarimore .....</b>	<b>46</b>
<i>1. Dështimi i gjykatave në procedimene menjëhershëm të procedurës përmbarimore....</i>	<i>46</i>
<i>2. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në procedurën për përmbarim: frikësimi dhe korruptimi i gjyqtarëve.....</i>	<i>47</i>
<i>3. Rekomandimet .....</i>	<i>49</i>

## FJALORTH

DD	Departmenti i Drejtësisë
KEDNJ	<b>K</b> onventa Evropiane për Mbrojtjen e të <b>D</b> rejtave dhe Lirive Themelore të <b>N</b> jeriut
GjEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
DÇPB/KÇPBA	Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore për Ankesa
KFOR( <b>Orig</b> )	Forca e Kosovës
LPK	Ligji mbi Procedurën Kontestimore
LPP	Ligji mbi Procedurën Përmbarese
SMSJ	Seksioni për Monitorim e Sistemit Juridik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqevërisëse
UNMIK( <b>Orig</b> ) Bashkuara në Kosovë	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Seksioni i Monitorimit të sistemit Juridik (SMSJ), në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë, është duke monitoruar gjyqësinë në Kosovë që nga viti 1999. Kjo punë ka sjellë dhjetë raporte publike dhe tetë raporte gjysëm-publike, që e analizojnë sistemin e drejtësisë penale nga perspektiva e drejtave të njeriut, duke identifikuar shqetësimet kryesorë në rastet penale dhe duke dhënë rekomandime se si të tejkalohen problemet në mënyrë që të sigurohet që sistemi të jetë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare. Duke e njohur poashtu rëndësinë e funksionalitetit të procedurës civile për vendosjen e një sistemi gjyqësor efektiv në çdo aspekt, në Janar të vitit 2005 SMSJ e zgjeroni mandatin e tij dhe filloi monitorimin e rasteve civile nëpër gjykata. Pas monitorimit të llojeve të ndryshme të rasteve civile ky është shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë civile në Kosovë.

Kapitulli i parë i këtij shqyrtimi adreson një problem i cili u vërejt nga SMSJ gjatë monitorimit të rasteve civile është numri i madh i lëndëve të pezulluara nëpër gjykata, gjë që shkakton vonesa të panevojshme dhe kështu cenon të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Përderisa ka shumë faktorë të cilët kanë kontribuar në këto vonesa, ky shqyrtim përqendrohet në ato më të rëndësishmet të cilat mund të adresohen nga ana e gjyqtarëve në mënyrë që të eliminohet problemi i lëndëve të grumbulluara. Shqetësimi i parë në lidhje me këtë problem është menaxhimi i dobët i lëndëve nga ana e gjyqtarëve, të cilët ose bëjnë shkelje procedurale duke mos i dërguar me kohë paditë palës së paditur gjë që rezulton me shtyerje të seancave gjyqësore, ose tjeshtë i caktojnë gjykimet pa i përmbushur të gjitha elementet e nevojshme për ta mbajtur gjykimin, duke çuar kështu në shtyerje të parashikueshme. Në këtë kontekst OSBE-ja është shqetësuar me numrin e madh të seancave dhe shtyerjeve në çdo rast, që shkaktojnë vonesa të panevojshme në shumicën e rasteve civile. Për më tepër, vështirësitë në dorëzimin e ftesave palëve dhe dëshmitarëve poashtu rezulton me shtyerje të njëpasnjëshme të seancave të gjykimit. Përfundimisht, ky kapitull identifikon disa mangësi në Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, dështimi i të cilit për të vendosur afate kohore për një numër të madh dhe të rëndësishëm të veprimeve procedurale jep shkallë të gjërë diskrecioni gjyqtarëve dhe rezulton në zgjatjen tej mase të rasteve civile.

Në kapitullin e dytë, shqyrtimi analizon problemet të cilat janë vërejtur gjatë zgjidhjes së kontesteve pronësore para gjykatave. I pari nga këto probleme është përdorimi i dokumentave të falsifikuar nga ana e individëve me qëllim të vërtetimit të kontratave të rrejshme të shitblerjës para gjykatës, në lidhje me pronat të cilat më herët ishin pronësi e Sërbëve të Kosovës të cilët i lanë shtëpitë e tyre pas konfliktit. Një shqetësim tjetër i referohet rasteve pronësore të personave në mungesë, zakonisht Sërbëve të Kosovës të cilët janë të zhvendosur, adresa dhe vendndodhja e të cilëve nuk dihet, ku gjykata cakton përfaqësues të përkohshëm për ta mbrojtur palën e cila mungon. Edhe pse kjo procedurë parashihet me ligj, gjykatat nuk po i respektojnë rregullat e saj si dhe as frymën e ligjit, që rezulton në zgjidhjen e rastit duke cenuar të drejtën në gjykim të drejtë të palës në mungesë, pasi që ata nuk marrin pjesë në procedurë dhe nuk kanë dijeni mbi vendimet e gjykatës në lidhje me ish pronat e tyre dhe nuk janë të mbrojtur në mënyrë efektive nga përfaqësuesit e përkohshëm. Përfundimisht, kapitulli analizon problemet në kontestet pronësore që rezultojnë nga trashëgimia e së kaluarës në Kosovë, do të thotë fakti se shumë nga transaksionet e vjetra pronësore nuk i kishin përmbushur kushtet ligjore për të qenë valide (duke përfshirë vërtetimin e kontratave në gjykatë dhe regjistrimin e pronës në librat kadastral), për shkak të legjislacionit diskriminues i cili ishte në fuqi në atë kohë dhe që ndalonte shitblerjet e pasurisë në mes të Sërbëve dhe Shqiptarëve në Kosovë. Si rezultat i kësaj gjykata sot duhet të vendosin mbi kontestet pronësore, duke u bazuar vetëm në kontratat gojore ose jo formale, të cilat nuk janë valide sipas ligjit ekzistues.

Duke patur parasysh se gjyqësori në Kosovë ende kalon nëpër fazën fillestare të zhvillimit dhe degët ekzekutive në nivel lokal dhe qendror janë në proces të themelimit të plotë, gjatë transferit të kompetencave nga UNMIK-u në autoritetet lokale, çështja e ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit kërkojnë kujdes të veçantë në këto moment kohore. Duke i njohur këto shqetësime, kapitulli i tretë i shqyrtimit përqendrohet në ndërhyrjet e parregullta nga ana e aktorëve qeveritar në procedurat gjyqësore gjë që ndikon në pavarësinë e gjykatave në Kosovë. Në bazë të informatave të mbledhura nga monitorët e OSBE-së, forma kryesore e ndërhyrjes së autoriteteve komunale në punën e gjykatave konsiston në aktet e pengimit të procedurave dhe presionit mbi gjyqtarë, gjë që shfaq një përbuzje të dukshme të autoriteteve gjyqësore nga ana e zyrtarëve komunal. Në anën tjetër, gjykatave u janë dërguar letra nga ana e Departamentit të Drejtësisë me të cilat udhëzohen gjykatat që të mos i dëgjojnë një kategori të caktuar të rasteve. Këto raste të pezulluara përbëjnë më së 17.000 padi për kompenzim të cilat janë ngritur nga ana e Sërbëve të Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-ut, IPVQ-së, komunave dhe personave individual, për shkak të dëmeve që pronat e tyre kanë pasur gjatë dhe pas konfliktit. Këto instruksione të dërguara nga Departamenti i Drejtësisë në gjykata të cilat i ndaluan këto kategori të rasteve, pa pasur edhe aq argumente justifikuese, nuk ofruan një afat kohor të definuar ose një mekanizëm për zgjidhje eventuale të këtyre padive. Si rezultat ka mijëra banorë të Kosovës paditë e të cilëve në këtë moment kanë mbetur të pezulluara për kohë të pacaktuar.

Kapitulli i katërt dhe i fundit i këtij shqyrtimi merret me problemet që OSBE-ja i ka identifikuar në lidhje me procedurat e ekzekutimit. Duke patur parasysh që procedura e ekzekutimit është mekanizëm ligjor që e detyron palën që ta respektojë vendimin e plotfuqisjëm në rast se ai/ajo nuk e bën këtë vullnetshëm, efikasiteti i kësaj procedure është i rëndësishëm për sistemin gjyqësor në mënyrë që ai të jetë në gjendje të zbatoj ligjin dhe të sigurojë realizimin e drejtës së palëve. Për shkak të rëndësisë që procedura ekzekutive ka në ndërtimin e besimit në sistemin gjyqësor në Kosovë, problemet të cilat e rëndojnë këte duhet të adresohen urgjentisht. Një nga shqetësimet është se aktgjykimet e plotfuqishme nuk po ekzekutohen ose nëse po ekzekutohen kjo bëhet me vonesa të mëdha, duke cenuar të drejtën në gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Ky joefikasitet në ekzekutimin e aktgjyqimeve shkaktohet për shkak të shkëlqës së dispozitave të ligjit mbi procedurën e ekzekutimit që kërkon veprim të menjëhershëm të gjykatës pas dorëzimit të kërkesës për ekzekutim. Këto shkelje mund të jenë rezultat i ngarkesës së madhe të gjyqtarëve dhe grumbullit të madh të lëndëve, ose mund të shkaktohen nga faktorë të jashtëm. Pasi që kanë përgjegjësi direkte për zbatimin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, gjyqtarët për ekzekutim lehtë mund të jenë shënjestër e formave të jashtme të presionit si kërcënime, sulme, korrupsion, që ndikon në aftësinë e tyre të merren me rastet e ekzekutimit në mënyrë të pavarur dhe efektive. Në këtë drejtim, frikësimi i gjyqtarëve dhe korrupsioni janë probleme serioze që ndikojnë në procedurat e ekzekutimit.

Shqetësimet e identifikuar në këtë raport të parë mbi shqyrtimin e Sitemit të Drejtësisë Civile, japin një vështrim të përgjithshëm të problemeve që prekin gjykatat civile në Kosovë në lloje të ndryshme të rasteve që janë identifikuar nga monitorët e OSBE-së. Llojllojshmëria e qështjeve të adresuara qëndron për shkak të faktit se ky është shqyrtimi i parë i këtij lloji i cili ka pasur për qëllim të nxjerr një raport gjithëpërfshirës mbi problemet të cilat ndikojnë në sistemin e drejtësisë civile. Rekomandimet në fund të çdo kapitulli kanë për qëllim që të merren me këto probleme për të siguruar pajtueshmërinë e sitemit me standardet ndërkombëtare. Pasi që disa nga këto probleme janë sistematike dhe janë më shumë rrjedhojë e kontekstit të gjendjes së tanishme në Kosovë e jo gabime të gjykatave, zgjedhja e tyre poashtu përfshin akterë të ndryshëm që janë jashtë sitemit gjyqësor. Mirëpo, këto vështirësi sistematike nuk duhen të shihen si pengesa të pakapërcyeshme për përmirësimin e drejtësisë civile, por më tepër si shqetësime që mund dhe duhen të adresohen në mënyrë aktive nga të gjitha etnitetet që janë të kyçyra në këtë periudhë të rëndësishme për ardhmërinë e Kosovës, duke siguruar një sistem gjyqësor efektiv në të gjitha aspektet.

## Kapitulli I

### VONESAT NË PROCEDURËN CIVILE

Një nga problemet kryesore të cilat ndikojnë në procedurën civile anekënd Kosovës është numri i madh i lëndëve të pazgjdhura nëpër gjykatat civile. Sipas të dhënave statistikore më të fundit, që janë siguruar nga Departamenti i administratës gjyqësore, momentalisht janë 43760 lëndë civile të pazgjdhura<sup>1</sup>.

Në këtë kapitull trajtohen tri çështje për të cilat OSBE-ja konsideron se ndikojnë rëndësishëm në rritjen e numrit, edhe ashtu tanimë të madh të lëndëve civile të pazgjdhura nëpër gjykata. Së pari, mungesa apo menagjimi joefektiv i lëndëve nga gjyqtarët; e dyta, problemet me të cilat ballafaqohen gjykatat në dërgimin e fletëthirrjeve<sup>2</sup>. Dhe së fundi ky kapitull gjithashtu do të përqendrohet në disa vështirësi të cilat rezultojnë nga mangësitë e ligjit të aplikueshëm mbi procedurën kontestimore (më pas LPK), ligj ky i vitit 1977 me mangësi serioze të cilat duhet trajtuar si çështje prioritare.

#### *1. Menaxhimi i dobët i lëndëve*

Përderisa bën të ditur se palët në rastet civile mbajnë përgjegjësi më të madhe për mbarëvajtjen e procedurës sesa në rastet penale, mendimi i OSBE-së është se gjyqtarët si autoritete vendimmarrëse që drejtojnë procedurën, janë gjithashtu përgjegjës që në kohë t'i zgjidhin lëndët civile. Ky qëndrim mbështetet jo vetëm nga LPK, i cili i vë gjykatat nën obligim që të drejtojnë procedurën me zell të duhur<sup>3</sup>, por kjo mbështetet edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilës, gjykatat në rastet civile nuk përjashtohen “ të sigurojnë zbatimin e kërkesave nga neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me kohën e arsyeshme ”<sup>4</sup>.

Pas monitorimit të rasteve civile për më se një vit, OSBE-ja përfundon se menaxhimi i dobët i lëndëve është një nga shkaqet kryesore për ekzistimin e numrit ekzistues të lëndëve të pazgjdhura. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve civile të monitoruara, është vërejtur

<sup>1</sup> Shih “*Pasqyrën e numrit të kontesteve civile të pazgjdhura*” për periudhën prej 1 - 31 dhjetor 2005 nga Departamenti i administratës gjyqësore.

<sup>2</sup> Duhet të përmendet se sipas “Standardit për sundimin e ligjit” [numri i lëndëve civile të pazgjdhura [duhet] të reduktohet gradualisht,” si një nga veprimet e nevojshme përmendet realizimi i një sistemi të automatizuar të menaxhimit të lëndëve në mënyrë që të përmbushet ky standard (Standardi 12, veprimi 12.3 i “Standardit për sundimin e ligjit – Plani i Kosovës për përmbushjen e standardeve).

<sup>3</sup> Neni 10 i Ligjit mbi procedurën kontestimore (RSFJ GAZETA ZYRTARE 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 35/91), më tutje LPK, parashikon “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zbatohet pa vonesa të panevojshme, mundësisht me sa më pak shpenzime dhe të parandaloj çfarëdo shpërdorimi të drejtave që u takojnë palëve në procedurë”. Gjithashtu shih nenet 311, paragrafin 2 dhe 314, paragrafi 1 LPK, të cilat parashikojnë që “detyra e kryetarit të kolegjit është të kujdeset [...] që procedura të mos zvarritet [...] kështu që gjykimi të përfundohet nëse është e mundur brenda një seance”; dhe “Kur kolegji vendos që të shtyj seancën gjyqësore, kryetari i kolegjit duhet të kujdeset që për seancën e ardhshme të sigurohen të gjitha provat, paraqitja e të cilave është caktuar për atë seancë dhe të bëhen përgatitje të tjera në mënyrë që shqyrtimi të mund të përfundojë në atë seancë të ardhshme”.

<sup>4</sup> Shih *Unión Alimentaria Sanders SA kundër Spanjës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, A 157 paragrafi 35 (1989).

se udhëheqja joefektive e procedurës ka shkatuar vonesa të panevojshme gjatë procedurës dhe ka ndikuar negativisht në të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme<sup>5</sup>.

### *1.1 Mungesa e menaxhimit dhe menaxhimi joefektiv i lëndëve në fazën paraprake të procedurës.*

Mungesa e menaxhimit të lëndëve gjatë fazës përgatitore të procedurës është çështje veçanërisht shqetësuese, për shkak se zhvillimi i duhur i kësaj faze është thelbësor për zgjidhjen e shpejtë të çfarëdo lënde civile. Faza përgatitore e procedurës fillon me parashtrimin e padisë. Qëllim kryesor i kësaj faze është përgatitja e lëndës për seancë kryesore ku bëhet ekzaminimi i shkeljeve të mundshme procedurale, përmirësimi i parashtrësive, konstatimi i fakteve të kontestueshme dhe të pakontestueshme dhe nëse është e mundur paraqitja e dëshmive. Në shumë sisteme juridike, faza paraprake e procedurës përdoret gjithashtu edhe si rast për pushimin e procedurës ose arritjen e marrëveshjes.

LPK përmban një numër dispozitash me të cilat rregullohet faza paraprake e procedurës<sup>6</sup>. Sipas ligjit kjo fazë paraprake duhet të përfshijë “ekzaminimi paraprak i padisë, dërgimi i padisë të paditurit për përgjigje, mbajtja e seancës përgatitore dhe caktimi i shqyrtimit kryesor [...]”<sup>7</sup>. Gjithashtu është në fazën përgatitore që pas ekzaminimit paraprak të padisë, kryetari i kolegjit do t’i thërret palët në seancën përgatitore<sup>8</sup> gjatë së cilës paraqitet padia dhe përgjigjja e të paditurit ndaj saj. LPK më tej përcakton që “[p]as konstatimit se nuk ekzistojnë pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës, kryetari i kolegjit [...] do të vendos se cilët dëshmitarë dhe ekspertë do të thirren për në shqyrtimin kryesor dhe cilat dëshmi tjera duhet të sigurohen [...]”<sup>9</sup>.

Përkundër dispozitave të LPK-së, të cilat rregullojnë këtë fazë të rëndësishme të procedurës, OSBE ka monitoruar disa raste në të cilat gjykatat i kanë injoruar ose i kanë zbatuar gabimisht këto dispozita. Nën-seksionet në vazhdim të këtij raporti do t’i paraqesin shqetësimet e identifikuar nga OSBE-ja në këtë drejtim.

### *1.1.2 Mos ekzaminimi ose ekzaminimi i gabuar paraprak i padisë*

Dështimi i gjyqtarëve që ta bëjnë ekzaminimin paraprak të padive para caktimit të shqyrtimeve kryesore ka rezultuar në shtyrje të cilat, po qe se do të kryheshin ato ekzaminime paraprake në fazën përgatitore, këto shtyrje nuk do të ndodhnin. Në këtë kontekst, vlen të rikujtohet se sipas LPK-së, “[k]ur vërteton se padia është e pakuptueshme ose jo e plotë, ose se ekzistojnë të meta të cilat kanë të bëjnë me aftësitë e paditësit ose të paditurit për të qenë palë në procedurë [...] kryetari i kolegjit, do të ndërmer masa të nevojshme të parashikuara me ligj”<sup>10</sup>.

<sup>5</sup> Për më shumë shënime mbi menaxhimin e lëndëve, shih publikimin e përgatitur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe nga Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore, “Menaxhimi i lëndëve dhe reduktimi i vonesave”, *Studimet statistikore të zhvillimit të lëndëve dhe numri i lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykatat e zgjedhura* tetor 2005.

<sup>6</sup> Shih kreun 20 të LPK, nenet prej 277 deri në 293.

<sup>7</sup> Neni 277(2) LPK.

<sup>8</sup> Neni 284 LPK.

<sup>9</sup> Neni 289(1) LPK.

<sup>10</sup> Neni 281 LPK. Gjithashtu shih nenin 109 të LPK-së, të cilit i referohet neni 281, i cili thekson se “në qoftë se parashtrësia është e pakuptueshme, apo nuk përmban të gjitha që nevojiten për të vepruar sipas saj, gjykata do ta udhëzojë paraqitësin e dhe do t’i ndihmojë që ta përmirësoj parashtrësën, respektivisht ta plotësojë atë, e për këtë qëllim mund ta ftojë në gjykatë ose t’ia kthejë parashtrësën për përmirësim”.



Pa marrë parasysh kornizën punuese ligjore në fuqi, OSBE-ja ka monitoruar raste në të cilat gjykatat kanë dështuar t'i zbatojnë dispozitat e lartpërmendura dhe kanë i kanë caktuar seancat kryesore me paditë të cilave i mungojnë të dhëna themelore.

Shembulli i parë ka të bëjë me një kontest pronësor në Gjykatën Komunale të Gjilanit/Gnjilane. Në këtë rast, paditësi e ka paraqitur padinë më 3 shtator 2003. Edhe pse në padi nuk ishte dhënë adresa e të paditurit, gjykata e ka vërtetuar këtë fakt vetëm gjatë seancës së parë të shqyrtimit kryesor të mbajtur më 18 prill 2005. Gjatë seancës, kryetari i trupit gjykues ka urdhëruar paditësin që në afat prej 15 ditësh ta ndryshojë padinë duke e përfshirë adresën e të paditurit në padi. Pas këtij aktvendimi, seanca është shtyrë për kohë të pacaktuar (*sine die*).

Në shembullin e dytë, para të njejtës gjykate, që gjithashtu ka të bëjë me një kontest pronësor, padia ishte paraqitur më 14 shtator 2004, dhe nuk përmbante adresën e të paditurit. Më 14 mars 2005, në fillim të seancës së parë të shqyrtimit kryesor, kryetari i kolegjit ka vërtetuar se i padituri nuk është ftuar për shkak se paditësi nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e tij. Vetëm në këtë ditë gjykata e ka pyetur paditësin për vendndodhjen e të paditurit dhe ishte njoftuar se paditësi nuk kishte njohuri për këtë gjë.

Në këto raste gjykata e kishte caktuar datën për shqyrtim kryesor përkundër mungesës së informatave për adresën e të paditurve. Rrjedhimisht, seancat e gjykimut janë mbajtur vetëm sa për t'u shtyrë me qëllim të gjetjes dhe thirrjes të palëve të paditura. Është e rëndësishme të përmendet se sipas ligjit të gjitha parashtrirat duhet të jenë të kuptueshme dhe duhet të përmbajnë sidomos, "emrin, profesionin dhe vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e palëve [...]”<sup>11</sup>. Rrjedhimisht, në të dy shembujt gjykata ka qenë dashur të kërkojë nga paditësit që t'ia sigurojnë informatat e rëndësishme që para caktimit të seancave për shqyrtim kryesor.

Në raste tjera, seancat është dashur të shtyhen për shkak të mungesës së informatave tjera relevante.

Një kontest pronësor para Gjykatës Komunale të Prizrenit, më 20 qershor 2005 paditësit e kanë paraqitur padinë duke kërkuar nga komuna e Prizrenit që t'ua kthejë parcelën e tokës, duke pretenduar me atë rast se janë trashëgimtarë të pronarit legjitim të pasurisë së paluajtshme të kontestuar. Kryetari i kolegjit pa e mbajtur seancën paraprake<sup>12</sup>, e ka caktuar fillimin e shqyrtimit kryesor për datën 11 korrik 2005 dhe i ka ftuar palët në mënyrë të rregullt. Megjithatë, seanca nuk mund të mbahej për shkak se paditësit nuk ia kishin bashkëngjitur kërkesëpadsisë dokumentet e nevojshme për vërtetimin e legjitimitetit aktiv, siç janë certifikatat e vdekjes dhe lindjes, me të cilat dëshmohet lidhja familjare me pronarin legjitim të tokës.

Rrjedhimisht seanca ishte shtyrë me qëllim që paditësve t'ju mundësohet t'i sigurojnë dhe dorëzojnë dokumentet e lartcekura.

Një shembull i ngjajshëm mund të gjendet edhe në rastin e kërkesës për kompenzim të dëmit para Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priština<sup>13</sup>. Edhe pse padia ishte paraqitur më 25 prill 2002, gjykata ka pritur deri më 1 mars 2005, seanca e nëntë e caktuar për këtë rast, që të kërkojë nga paditësi të dorëzojë një dëshmi elementare dhe

---

<sup>11</sup> Neni 106(2) i LPK-së.

<sup>12</sup> Neni 284(3) i LPK-së.

<sup>13</sup> OSBE ka raportuar për këtë rast në raportin dyjavor të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit, të muajit shkurt 2005, në të cilin trajtohen çështjet e problemeve të komunikimit të thirrjeve.

të nevojshme<sup>14</sup>. Përveç këtij aktvendimi, asgjë tjetër nuk është arritur gjatë seancës, me ç'rast gjykimi ishte shtyrë që të mbahet me 23 mars 2005.

Në këto shembuj shtyrja e seancave gjyqësore ka mundur të evitohet lehtë, poqëse kryetari i trupit gjykues pas ekzaminimit paraprak të padive në seancat përgatitore, ashtu siç parashihet me ligj<sup>15</sup>, të kishin kërkuar nga paditësit që t'i dorëzonin provat relevante qysh para caktimit të datave të fillimit të shqyrtimeve kryesore.

### 1.1.3 Dështimi për dorëzimin e padisë palës së kundërt para seancës kryesore.

Edhe pse duket qartë se i padituri nuk do ketë mundësi të përgatitet për gjykim deri në momentin kur ai/ajo të informohet për përmbajtjen e padisë, OSBE ka vërejtur se në disa raste gjykatat nuk ua kanë dorëzuar palëve të paditura kopjet e padive para mbajtjes së shqyrtimit kryesor. Edhe pse me ligj nuk saktësohet qartazi afati për dorëzimin e padisë palës së paditur<sup>16</sup>, nga interpretimi i disa dispozitave ligjore mund të nxirret lehtë përfundimi se ajo duhet dorëzuar para seancës përgatitore (në rastet kur ajo mbahet)<sup>17</sup> ose para mbajtjes së seancës së parë të shqyrtimit kryesor, si dhe nga nevoja që të sigurohet se të paditurit i është ofruar kohë e mjaftueshme për përgatitje të lëndës, ashtu siç kërkohet nga standardet vendore dhe ndërkombëtare<sup>18</sup>. Gjithashtu vlen të përmendet se kontesti mundet të fillojë vetëm atëherë kur padia t'i dorëzohet të paditurit<sup>19</sup>.

Sipas LPK-së, nëse gjatë fazës paraprake kryetari i kolegjit konsideron se në bazë të kërkesë padisë mund të veprohet më tej, “do të [...] urdhërojë që kopja e padisë t'i dërgohet të paditurit”. Ligji gjithashtu thotë se gjatë caktimit të datës për shqyrtim kryesor, “bashkë me ftesën për gjykim të paditurit do të i dërgohet padia, po qe se nuk i është dërguar më parë”<sup>20</sup>. Për këtë arsye, edhe pse nuk është dhënë ndonjë afat specifik, duket në mënyrë të qartë dhe logjike që padia duhet të servohet para fillimit të seancës përgatitore dhe shqyrtimit kryesor.

Përkundër rregullave të lartpërmendura, në rastin e paraqitur më poshtë të paditurit i ishte dërguar kopja e padisë pasi kishte filluar shqyrtimi kryesor. Kjo ka rezultuar me shtyrje të seancës së gjykimit nga shkak se të paditurit nuk i ishte dhënë kohë e mjaftueshme për përgatitje adekuate dhe ka shkaktuar zvarritje të panevojshme të procedurës.

Në një rast para Gjykatës Komonale të Mitrovicës/Mitrovica, në një kontest që kishte të bënte me shkelje të kontratës, që ishte parashtruar në gjykatë më 3 janar 2001, kryetari i kolegjit e ka caktuar seancën për shqyrtim kryesor për 18 shkurt 2003. Pa

<sup>14</sup> Dokumenti me të cilin vërtetohet se paditësi është pronar i objektit.

<sup>15</sup> Nenet 281 dhe 109 i LPK-së.

<sup>16</sup> Afati i vetëm i paraparë me ligj është ai i cili parashihet në nenin 286(1) të LPK-së, i cili thotë: “Seanca përgatitore duhet të caktohet në mënyrë që palëve t’u mbetet mjaft kohë për t’u përgatitur, e të paktën tetë ditë nga marrja e thirrjes”, së bashku me kopjen e padisë e cila i dërgohet të paditurit (neni 284(1) i LPK-së). Mirëpo, këto dispozita u japin gjykatave oportunitetin në lidhje me caktimin e datës për seancën përgatitore.

<sup>17</sup> Sipas nenit 284(2) të LPK-së, “seanca përgatitore nuk do të caktohet kur për gjykim është kompetent gjyqtari i vetëm”.

<sup>18</sup> Shih nenin 286(1) të LPK-së dhe nenet 14(1) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Dombo Beheer kundër Hollandës*, kur gjykata ka vërtetuar se “kur është fjala për proceset gjyqësore me përfshirje të interesave të kundërta private, “barazia e mjeteve juridike” nënkupton që secila palë të ketë në disponim mundësinë e arsyeshme të paraqitjes së rastit të vet [...] në kushtet të cilat nuk e vendosin atë në pozitë të pafavorshme karshi palës së tij kundërshtarë” (shih A 274 para 33 (1993), shih J. Harris, M. O’Boyle, C. Warbrick, *E drejta e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Butterworths, Londër, 1995, f. 209).

<sup>19</sup> Shih Komentin mbi Ligjin e procedurës kontestimore të dr. Faik Brestovcit, Fakulteti Juridik i Prishtinës/Priştina, 2002, faqe 142.

<sup>20</sup> Shih nenet 284(1) dhe 293(2) të LPK-së.

marrë parasysh praninë e të dyja palëve, nuk ka mundur të fillojë shqyrtimi për shkak se të paditurit nuk i ishte dërguar padia së bashku me ftesën për në seancë. Me qëllim që t'i mundësohet kohë e mjaftueshme të paditurit për përgatitjen e lëndës, kryetari i kolegjit ka qenë i detyruar ta shtyjë seancën për 24 mars 2003<sup>21</sup>.

I njëjti shqetësim paraqitet edhe në çështjen e dorëzimit të provave palës së kundërt, që do të trajtohet në nën-pjesën në vazhdim.

#### *1.1.4 Dështimi në paraqitjen e dëshmimeve para fillimit të seancës së shqyrtimit kryesor*

Një nga rezultatet e rëndësishme të fazës përgatitore duhet të jetë paraqitja e provave nga palët. Përderisa LPK-ja nuk parashikon afat për parashtrimin e provave, një numër dispozitash duket se parashikojnë obligimin në anën e paditësit për paraqitjen e tyre (posaçërisht dokumentet dëshmuese), së bashku me kërkesëpadinë<sup>22</sup> ose, së paku në seancën përgatitore<sup>23</sup>. Nga ky shkak, sa herë që palët nuk e kryejnë këtë veprim në kohën e duhur, me qëllim që gjykata t'i pranojë dëshmitë ajo duhet të kërkojë që palët ta arsyetojnë paraqitjen e vonuar të provave. Duke e pranuar vonesën të paarsyetuar për paraqitjen e provave gjatë seancave gjyqësore dhe duke mos kërkuar nga palët që këtë ta bëjnë në fazë më të hershme të procedurës, gjykatat vetëm se i kontribuojnë zvarritjeve procedurale duke pasur parasysh se paraqitja me vonesë e provave shpeshherë rezulton në shtyrje të shqyrtimit për shkakun se pala e kundërt nuk ka pasur kohë të mjaftueshme t'i ekzaminojë provat.

Në një rasti para Gjykatës Komunale të Prizren që kishte të bënte me kërkesën për anulimin e kontratës gjykata kishte caktuar njëmbëdhjetë herë seanca për shqyrtim kryesor mes muajit tetor 2002 dhe qershor 2005. Mirëpo, edhe me 20 qershor 2005, ende nuk ishte e mundur që të hyhej në shqyrtim për shkak se paditësit nuk i kishin paraqitur disa nga dokumentet e propozuara si dëshmi në kërkesëpadi. Në mënyrë që përfaqësuesi i të paditurve të ketë mundësi t'i vlerësojë dokumentet mbi të cilat ishte bazuar padia dhe që të përgatitet për lëndë, gjykata i ka urdhëruar paditësit që t'i dorëzojnë provat e lartcekura në afat prej pesë ditësh dhe e ka shtyrë seancën.

Për këtë rast janë nevojitur dy vite dhe tetë muaj që nga fillimi i gjykimit që gjykata t'i urdhërojë paditësit t'i paraqesin provat e propozuara me padi<sup>24</sup>. Me qëllim që të respektohen kërkesat për mbarim të shpejtë të procedurës dhe për respektimin e parimit të barazisë së armëve, kryetari i kolegjit ishte dashur të kërkojë nga paditësit që t'i dorëzojnë ato dokumente menjëherë pas ekzaminimit paraprak të padisë.

Edhe nëse palët i paraqesin provat në kohë të duhur, shpesh ndodh që kjo provë të mos i përcillet palës së kundërt nga gjykata. OSBE i ka monitoruar rastet në të cilat janë shtyrë

<sup>21</sup> Vlen të përmendet se me 24 mars 2003, pas propozimit të paraqitur nga i padituri, gjykata ka vendosur ta pezullojë procedurën. Me 2 korrik 2003, paditësi ka paraqitur kërkesën që gjykata ta vazhdojë procedurën në pajtim me nenin 217(2) të LPK-së. Që nga atëherë, shtatë seanca gjyqësore janë caktuar midis 4 korrikut dhe 19 dhjetorit 2005, për shkak të vështirësive në dërgimin e thirrjeve për të paditurit. Me 13 janar 2006 gjykata e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurit dhe seanca e fundit për këtë lëndë ishte mbajtur me 9 shkurt 2006.

<sup>22</sup> Kur provat vetëm se janë në posedimin e tij/saj aktual.

<sup>23</sup> Neni 286(1) i LPK-së thotë: “në thirrjen për seancën përgatitore do t'u urdhërohet palëve që në seancë të sjellin të gjitha dokumentet që u shërbejnë si provë, si dhe të gjitha sendet që duhet të shikohen në gjykatë”. Gjithashtu neni 186(1) i LPK-së përcakton se: “padia duhet të përmbajë [...] provat që i vërtetojnë ato fakte [në të cilat paditësi e bazon kërkesën] dhe të dhënat tjera të cilat duhet t'i ketë çdo parashtresë”.

<sup>24</sup> Vlen të përmendet se padia është parashtruar në gjykatë me 11 nëntor 1998.

seancat për shkak se gjykatat kanë dështuar që provat t'ua përcjellin palëve kundërshtare para se të fillon seanca e shqyrtimit kryesor.<sup>25</sup>

Në një shembull para Gjykatës Komunale në Prizren, që ka të bëjë me një kërkesë për dëbim të parashtruar më 25 gusht 2005. Seanca e katërt e shqyrtimit kryesor ishte dashur të shtyhej për shkak të faktit se palëve nuk u ishin siguruar kopjet e raportit deri në seancën e mbajtur me 20 janar 2006<sup>26</sup>.

Ky rast është një shembull tjetër i menaxhimit të dobët të lëndëve që ndikon në efikasitetin e gjykatave. OSBE konsideron se këto janë situata të cilat lehtë do të mund të trajtohenin dhe përmirësohenin nga administratorët e gjykatave dhe nëpunësit, të cilët duhet të luajnë një rol më proaktiv në menaxhimin e lëndëve dhe të sigurojnë që të gjitha dokumentet relevante që arrijnë në gjykata t'i përcillen në kohë të duhur palës kundërshtare.

### *1.2 Numri i tepruar i seancave dhe shtyrjet*

Krahas fazës paraprake të procedurës, mungesa e menaxhimit të lëndëve gjithashtu është e pranishme edhe në fazat tjera të procedurës. Numri i tepruar i seancave të caktuara në procedurën civile, mungesa e planifikimit të duhur të këtyre seancave dhe numri i shtyrjeve të tyre paraqesin çështjet tjera brengosëse<sup>27</sup>. Në këtë kontekst, mendimi i OSBE-së është se në ligjin e aplikueshëm duhet të përfshihet një dispozitë ligjore e cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do t'i përcaktojë kushtet e përgjithshme për shtyrjen e seancave ndërsa gjyqtarëve duhet t'ju përcaktohet përgjegjësia për shtyrjet të cilat ndodhin dhe të cilat nuk lejohen shprehimisht me LPK.<sup>28</sup>

Rasti në vazhdim është një shembull i cili tregon mirë se si mungesa e përgatitjeve për seancë ka shkaktuar zvarritje të procedurës, ku seancat janë dashur të shtyhen dhe ku gjykata nuk ka hyrë fare në shqyrtimin e objektit të kontestit.

Në rastin e kërkesës për shpërblim të dëmit, i cili është në zhvillim e sipër në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priştina që nga 17 tetori 2001, edhe pse seanca ishte caktuar gjashtë herë, thuhet se është shkuar fare përpara me procedurë. Seanca e parë e caktuar për 20 nëntor 2001 ishte shtyrë për shkak se të paditurit nuk e kishin marrë

<sup>25</sup> Vlen të përmendet se ligji përcakton obligimin për palët që gjykatës t'ia sigurojnë numrin e mjaftueshëm të kopjeve të çdo parashtrës në mënyrë që këto të mund t'i përcillen palës së kundërt (neni 107 i LPK-së). Neni 109(5) i LPK-së gjithashtu përcakton se “në qoftë se parashtrësit apo anekset nuk janë paraqitur në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë paraqitësin që, brenda afatit të caktuar, t'i paraqes ato. Nëse paraqitësi nuk vepron sipas këtij urdhri, gjykata mund të urdhërojë që parashtrësit dhe anekset të kopjohen me shpenzimet e palës”.

<sup>26</sup> Duhet të përmendet se raporti i është dërguar gjykatës me 24 nëntor 2005.

<sup>27</sup> Kur është fjala për numrin e madh të seancave zakonisht që mbahen në procedurë civile, duhet të përmendet se në Këshillin e Evropës është rekomanduar nga Këshilli i Ministrave të shteteve anëtare që të zvogëlohet numri i seancave në procedurë civile. Në fakt, Parimi i parë i Parimeve të procedurës civile i cili ka për qëllim përmirësimin e funksionimit të drejtësisë, thekson se “në kushte normale, procedura nuk do të duhej të kishte më shumë se dy seanca, e para do të kishte natyrën e seancës paraprake-përgatitore, ndërsa e dyta, do të shërbente për marrjen e provave, dëgjimin e argumenteve dhe mundësisht dhënien e aktgjykimit. Gjykata duhet të sigurojë se të gjithë hapat e nevojshëm të ndërmerren për fazën e dytë dhe kjo të bëhet me kohë, dhe parimisht, të mos lejohen shtyrjet përveç rasteve kur paraqiten dëshmi të reja ose në rrethana të jashtëzakonshme dhe të rëndësishme”. Shih shtojcën për Rekomandimin nr. R (84) 5. LPK duket se e përfaqon të njëjtën qasje ku në nenin 311(2) thuhet “detyra e kryetarit të kolegjit është të kujdeset që objekti i kontestit të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme, por që për këtë arsye procedura të mos zvarritet, kështu që shqyrtimi të përfundohet mundësisht në një seancë”.

<sup>28</sup> Edhe pse ligji nuk e rregullon çështje e shtyrjes në mënyrë unike dhe nuk i përcakton kushtet e përgjithshme për këtë çështje, në LPK mund të gjinden dispozita të cilat e lejojnë shtyrjen. P.sh., neni 116(1), 190(6) dhe (7), 296(2), 318(3), 498 dhe 499.

kopjen e padisë e as të aktvendimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priština dhe i duhej kohë për t'u përgatitur. Seanca e dytë e caktuar për 13 dhjetor 2001 ishte shtyrë për shkak të propozimit të paditësit për thirrjen e ekspertit. Më 3 dhjetor 2003 seanca ishte shtyrë për shkak të propozimit për shiqimin e vendit;<sup>29</sup> më 3 shkurt 2005 është mbajtur një seancë e shkurtër dhe menjëherë ishte shtyrë për shkak se përfaqësuesi i të paditurit kishte pohuar se nuk e kishte marrë kopjen e aktvendimit të cilin ai e kishte kërkuar qysh në seancën e parë<sup>30</sup>. Më 11 maj 2005 është mbajtur edhe një seancë por ishte shtyrë menjëherë pasi që kishte filluar për shkak se eksperti dështoi ta parashtronte raportin e tij. Më 14 qershor 2005 edhe një seancë e re është dashur të shtyhej për shkak se nuk edhe një ekspertizë tjetër nuk ishte paraqitur<sup>31</sup>. Në fund eksperti e kishte paraqitur konstatimin e tij diku në 10 nëntorit 2005 dhe shkurtit 2006 dhe seanca e re është caktuar të mbahet me 30 mars 2006.

Në këtë rast, në shqyrtim nga viti 2001, shihet qartë mungesa e kontrollit ndaj procedurës. Numri i tepërt i shtyrjeve të cilat pasojnë menjëherë pas secilit propozim të palëve, dhe dështimi i gjykatës të caktojë afate për paraqitjen e mendimit të ekspertëve janë vetëm disa nga shembujt të cilët e vërtetojnë këtë mungesë kontrolli.

Në shembullin e dytë para Gjykatës Komunale të Pejës/Peć, një numër seancash gjykimi ishin shtyrë për shkak të menaxhimit të dobët të lëndës. Seanca e dytë e gjykimit e caktuar për 7 shtator 2005 ishte shtyrë për shkak se kryetari i kolegjit nuk kishte qenë vet i përgatitur për seancë<sup>32</sup> për shkak se kishte qenë i nxënë me disa raste tjera. Me 7 nëntor 2005, seanca e katërt e caktuar për këtë lëndë ishte shtyrë për pasdite me arsyetimin se kryetari i kolegjit kishte qenë i zënë me një rast tjetër. Dy seanca tjera ishin shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit i cili i ishte përgjigjur ftesës së gjykatës të datës 14 shkurt 2006.<sup>33</sup> Edhe pse gjykata e kishte dënuar me gjobë dëshmitarin më 16 janar 2006, ky vendim ishte revokuar për shkak se dëshmitari e kishte arsyetuar mungesën e tij me faktin se ka qenë shumë i zënë.

Ky shembull ilustron mungesën e përgatitjes të seancave gjyqësore nga gjyqtarët si dhe menaxhimin e dobët të agjendës së gjyqtarëve. Përderisa në dy rastet e para gjykata ka mundur t'i njoftojë paraprakisht palët se nuk do jetë e mundur të mbahet gjykimi, prapë ajo ka dështuar ta bëjë atë. Për më tepër, derisa shtyerja e gjykimit bazuar në faktin se gjyqtari nuk ka pasur mundësi ta përgatitet për rastin nuk parashikohet me ligjin në fuqi, fakti se i njëjti gjyqtar e ka anuluar vendimin për dënimin e dëshmitarit është gjithashtu i dyshimtë sa i përket ligjshmërisë.

Përveç numrit të tepërt të seancave, mënyra se si ato caktohen gjithashtu vërteton se ka mungesë të menaxhimit efektiv të lëndëve. Në shembujt e përshkruar më poshtë, gjykatat i kishin caktuar seancat gjatë festave zyrtare.

Në një rast para Gjykatës Komunale të Rahovecit /Orahovac ku përfshihet një padi për kompensim të dëmit e parashtruar më 30 korrik 2001, gjykata e ka caktuar seancën e gjashtë që të mbahet me 14 qershor 2005. Mirëpo, për shkak se kjo ditë ishte festë zyrtare në Rahovec/Orahovac, seanca nuk ka mundur të mbahet.

<sup>29</sup> Shiqimi i vendit është kryer me 8 dhjetor 2003.

<sup>30</sup> Gjyqtari e kishte shtyrë seancën pa e vërtetuar nëse i padituri ndërkohë e ka pranuar aktvendimin. Paditësi e kishte kundërshtuar shtyrjen e seancës duke theksuar se nuk ishte e nevojshme dhe se vetëm do ta zvarriste procedurën. Gjyqtari më vonë e ka vërtetuar se aktvendimi i ishte dhënë të paditurit.

<sup>31</sup> Vlen të përmendet se gjykata nuk e kishte caktuar afatin për dorëzimin e mendimit të ekspertit.

<sup>32</sup> Këtij kryetari të kolegjit i ishte ndarë lënda diku kah mesi i 2 qershorit 2005 dhe 7 shtatorit 2005, si zëvendësim i gjyqtarit të përjashtuar më herët nga shqyrtimi i lëndës

<sup>33</sup> Seancat e shtyra për shkak të mungesës së dëshmitarit ishin caktuar për 12 dhjetor 2005 dhe 16 janar 2006. Mirëpo, i njëjti dëshmitar nuk ishte paraqitur as me datën 7 dhjetor 2005 edhe pse ftesa i ishte komunikuar në mënyrë të rregullt.

Në një rast tjetër që gjithashtu kishte të bënte me kompensim të dëmit, padia ishte parashtruar më 22 qershor 2004 para Gjykatës Komunale të Prizrenit. Seanca e dytë ishte caktuar për 24 tetor 2005 por ishte shtyrë për shkak të faktit se ajo ditë ishte ditë feste dhe gjykatat nuk punonin.

Të gjithë shembujt e përshkruar më lart, demonstrojnë dështimin e gjykatave t'a drejtojnë procedurën në mënyrë efektive<sup>34</sup>. Sikur kur gjyqtarët nuk i përgatisin në mënyrë të gjithanshme lëndët par caktimit të seancave, ose sikur kur nuk ka organizim gjatë caktimit të orarit të seancave nëpër gjykata, e vërteta është se gjykatat nuk janë duke e luajtur rolin aktiv për të siguruar një zhvillim të shpejtë të procedurës gjyqësore. Si pasojë, shumë seanca në procedurën civile shtyhen sistematikisht, duke shkaktuar kështu zvarritje të panevojshme procedurale si dhe i kontribuojnë shtimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura civile në Kosovë.

## *2. Problemet lidhur me dorëzimin e ftesave gjyqësore*

Një problem tjetër që shkakton zvarritje të panevojshme të procedurës është fakti se shumë seanca gjyqësore shtyhen vazhdimisht për shkak të problemeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e ftesave<sup>35</sup>. Problemi më i madh që ndërlidhet me sistemin e dorëzimit të ftesave duket të jetë mos-organizimi dhe mungesa e kontrollit mbi këtë procedurë në shumicën e gjykatave. Në të njëjtën kohë, korrierëve të gjykatave dhe PTK-së duket se i mungon njohuria e duhur për dispozitat ligjore të aplikueshme për procedurën e dorëzimit të ftesave dhe si pasojë dispozitat që rregullojnë këtë çështje shpeshherë nuk përfillen.

Sipas LPK-së, ftesat normalisht do të duhej të dërgohen me anë të postës, por ato edhe mund të dorëzohen nga punëtori i caktuar nga personeli i gjykatës (korrierët gjyqësor), nga organi kompetent i komunës, ose drejtëpërdrejtë në gjykata<sup>36</sup>. Për më tepër, në disa raste, për shembull nëse personi të cilit duhet dërguar ftesa ngjan të mos ndodhet në adresën e vet, dërgesa mund të bëhet duke ia dhënë ftesën ndonjë anëtar të rritur të familjes ose personave të tjerë të caktuar me ligj<sup>37</sup>. LPK më tutje përcakton se vërtetimi mbi dorëzimin e bërë (fletëdorëzimin) e nënshkruajnë marrësi dhe dorëzuesi<sup>38</sup>.

<sup>34</sup> Në këtë kontekst, kur kjo është e mundur, gjykata duhet ta përdorin nenin 316 të LPK-së i cili thotë se "[...] gjykata mund që gjatë procedurës të gjobisë [...] palën, përfaqësuesin ligjor, autorizuesin ose ndërhyrësin, i cili me veprimet e veta procedurale ka shpërdorur rëndë të drejtat e njohura me këtë ligj".

<sup>35</sup> Tash së voni OSBE është informuar lidhur me problemet me të cilat ballafaqohet Gjykata Komunale e Mitrovicës/Mitrovica lidhur me dorëzimin e ftesave gjyqësore në veri, të cilën gjë e kanë ndërprerë për shkak të mungesës së personelit. Në anën tjetër, fakti se PTK-ja nuk funksionon në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe mungesa e punëtorëve të përkatësisë serbe nëpër gjykatat, të dyja këto janë probleme plotësuese. Për shkak se për korrierët e gjykatave-shqiptarë të Kosovës nuk konsiderohet e sigurt që të dorëzojnë ftesat, në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, këto ftesa nuk dorëzohen dhe seancat duhet të shtyhen.

<sup>36</sup> Shih nenin 133 të LPK-së.

<sup>37</sup> Nenet 141 dhe 142 të LPK-së. Për shkak se neni 142, i cili përcakton se cilat dokumente duhet dorëzuar personalisht tek pala dhe nuk i përfshin aty fletëthirrjet, mund të përfundohet se këto mund të dorëzohen njësoj sikurse dokumentet tjera të cilat mund t'i dorëzohen njërit nga personat e përmendur nga neni 141 të LPK-së. Gjithashtu vlen të përmendet se neni 141 përcakton se "në qoftë se askush nuk gjendet në banesë, letra do t'i jepet kujdestarit të shtëpisë, ose fqinjit, në qoftë se këta e pranojnë këtë".

<sup>38</sup> Shih nenin 149 të LPK-së, i cili parashikon që: "në qoftë se marrësi refuzon ta nënshkruaj fletëdorëzimin, letërdorëzuesi do ta shënojë këtë [...] dhe do ta shkruaj me shkronja ditën e dorëzimit dhe konsiderohet se me këtë gjë dorëzimi është kryer [...]. Kur sipas dispozitave të këtij ligji letra i është dorëzuar personit tjetër dhe jo atij të cilit është dashur që t'i dorëzohet letra, në fletëdorëzim letërdorëzuesi do ta shënojë raportin (marrëdhënien) në mes të këtyre dy personave".

Pa i marrë parasysh këto rregulla, shpesh ndodhë që vërtetimet për dorëzimin e ftesave kthehen në gjykatë pa përmendur fare nëse pala ishte thirrur rregullisht apo jo. Për shkak të mungesës së kësaj informate, gjykatës shpesh nuk i mbetet tjetër veçse ta shtyjë seancën<sup>39</sup>. Në shembujt tjerë këto vërtetime as që mund të gjinden në shkresat e lëndës.

Në një rast para Gjykatës Komonale të Prishtinës/Priština, në një padi për anulimin e kontratës, të parshtruar më 3 shtator 2003, gjykimi ishte shtyrë tri herë për shkak të faktit se nuk kishte informata nëse ishte thirrur rregullisht i padituri<sup>40</sup>.

Në një shembull të ngjashëm pranë Gjykatës Komonale të Prizrenit, që kishte të bënte me një padi për anulimin e kontratës, të parashtruar më 11 nëntor 1998, dhjetë nga katërbëdhjetë seancat për gjykim të caktuara për këtë çështje janë shtyrë për shkak se palët nuk ishin ftuar në mënyrë të rregullt ose për shkak se gjykata nuk kishte mundur të vërtetojë nëse ato kanë qenë të ftuara rregullisht<sup>41</sup>. Nga këto dhjetë raste të shtyrjeve të gjykimit, në katër prej tyre vërtetimet për dorëzimin e ftesave nuk gjendeshin në shkresat e lëndës.

Në shembullin e tretë para Gjykatës Komonale në Mitrovicë/Mitrovica lidhur me një kontest pronësor të pazgjidhur që nga 3 janari 2004 gjykata me gjasë ishte mundur t'ua dërgojë ftesat të paditurve për tri seancat e caktuara për 18 prill 2005, 3 maj 2005 dhe 23 maj 2005. Përderisa për seancën e parë të shqyrtimit kryesor nuk ka prova në shkresat e lëndës se gjykata me të vërtetë ishte mundur t'i ftojë rregullisht të paditurit, seanca e caktuar për 3 maj 2005 është dashur të shtyhet për shkak të faktit se vërtetimi për dorëzimin e thirrjes ishte kthyer në gjykatë pa asnjë nënshkrim. Lidhur me ftesat për seancën e caktuar për 23 maj 2005, vërtetimi mbi dorëzimin ishte kthyer me shënimin se të paditurit nuk jetonin më në adresën e shënuar.

Në një kontest pronësor para Gjykatës Komonale të Mitrovicës/Mitrovica, seancat gjyqësore të caktuara për 8 dhjetor 2005, 11 janar 2006 dhe 9 shkurt 2006 ishin shtyrë për shkak të faktit se i padituri nuk ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Lidhur me dy seancat e para të përmendura më lart, gjykata kishte bërë përpjekje ta thërrasë të paditurin përmes stacionit policor të SHPK-së i cili ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, por që asnjëherë nuk ka marrë njoftimin nga policia nëse i padituri ishte thirrur apo jo. Sa i përket seancës së caktuar për 9 shkurt 2006, nga arsyeja se policia nuk kishte mundur ta shoqërojë korierin gjyqësor i cili ishte shqiptar i Kosovës në pjesën veriore, fletëthirrja nuk ka mundur t'i dorëzohet të paditurit dhe seanca është dashur të shtyhet.

Derisa mungesa e trajnimit për personelin e PTK-së dhe korierët e gjykatave paraqitet si njëri nga problemet që ndikon në dorëzimin e ftesave, administratorët e gjykatave duhet gjithashtu të luajnë një rol më aktiv në përcjelljen e kësaj procedure dhe ta rrisin shkallën e mbikëqyrjes ndaj korierëve të gjykatës. Për më shumë, dorëzimi i ftesave në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica është një çështje tjetër problematike. Gjersa ka probleme sigurie të cilat e pengojnë dorëzimin e ftesave nga ana e korierëve gjyqësor të përkatësisë shqiptare në pjesën veriore, mungesa e korierëve gjyqësor të përkatësisë serbe krijon vështirësi plotësuese për zgjidhjen e këtij problemi.

---

<sup>39</sup> Sipas LPK-së, që të mbahet gjykimi në mungesë (*in absentia*) pala munguese duhet të ketë qenë e thirru rregullisht. Shih nenin 295 dhe 332(1) të LPK-së.

<sup>40</sup> Gjykimi ishte caktuar dhe shtyrë për këto data: 14 prill 2005, 17 maj 2005, 21 qershor 2005 dhe 8 shtator 2005.

<sup>41</sup> Gjykim ishte caktuar dhe menjëherë ishte shtyrë në këto data: 18 tetori 2002, 15 dhe 24 shtatori 2003, 7 tetori 2003, 21 qershori 2004, 12 korrik 2004, 16 gusht 2004, 6 janar 2005, 3 shkurt 2005 dhe 21 tetor 2005.

### *3. Të metat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*

Faktori i cili e luan rolin kryesor në zvarritjen e procedurës civile, është fakti se ligji i tanishëm mbi procedurën kontestimore tanimë është i vjetruar në shumë aspekte. Gjithashtu, shumë prej dispozitave të LPK-së janë të zbehta ose dështojnë të parashikojnë afate kohore për veprime të caktuara procedurale. Cilësia e dobët e ligjit dhe mungesa e aktivitetit në anën e gjyqtarëve në përpjekjen për tejkalimin e disa prej kufizimeve ligjore, luajnë rolin kryesor në zvarritjet të cilat ndikojnë në procedurën civile. Në fund, çështje të ngjashme shpesh rregullohen me dispozita të ndryshme të ligjit, me ç'rast shkaktojnë situata enigmatike të cilat lehtë mund të trajtohen me vetëm një dispozitë të drejtëpërdrejtë ligjore.

Kjo pjesë do të identifikojë disa prej të metave në kuadër të LPK-së, veçanërisht ato të cilat më së shumti ndikojnë në zhvillimin e procedurës civile.

#### *3.1 Përgjigja në padi dhe kundërpadi*

Një nga temat të cilat duhet të trajtohet nga LPK-ja është ajo e përgjigjes në padi (mbrojtja).

LPK përcakton që në disa raste, para caktimit të seancës përgatitore, kryetari i kolegjit mund të kërkojë nga i padituri ta paraqesë mbrojtjen. Gjithashtu me ligj parashikohet që “[m]brojtja të parashtrahet brenda afatit të cilin e cakton kryetari i kolegjit, por ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e dërgimit të padisë,” ose në rrethana të veçanta ky afat mund të jetë edhe 30 ditë<sup>42</sup>. Duke pasur parasysh se sipas ligjit në situatat kur për gjykim është kompetent gjyqtari i vetëm seanca përgatitore nuk thirret<sup>43</sup>, në këto raste nuk ka afat për paraqitjen e përgjigjes në padi.

Mendimi i OSBE-së është se këto dispozita nuk janë adekuate dhe se duhet të ndryshohen. Së pari, LPK-ja nuk parasheh asnjë pasojë për mos paraqitjen e përgjigjes në padi nga i padituri<sup>44</sup>. Gjithashtu, afati për përgjigje ndaj padisë duhet gjithmonë të caktohet para seancës përgatitore. Duke lejuar paraqitjen e përgjigjes gjatë seancës gjyqësore, ligji vetëm sa e pengon kalimin e lehtë në zgjidhjen e rasteve, për shkak se si gjykata ashtu edhe palët mund të ballafaqohen me fakte esenciale gjatë fazës së mëvonshme të procedurës, kur këto fakte mund dhe do të duhej të ishin shqyrtuar gjatë fazës përgatitore.

Paraqitja e mëhershme e përgjigjes në padi do t'i lejonte gjykatës të konstatojë gjatë fazës përgatitore se cilat fakte mbeten të kontestueshme dhe gjithashtu t'i identifikojë ato të cilat konsiderohen të provuara. Në fund të seancës përgatitore, kryetari i kolegjit do të duhej ta përpilonte vendimin paraprak me të cilin identifikohen faktet konkrete të cilat duhet të provohen gjatë shqyrtimit. Në këtë mënyrë si gjykata ashtu edhe palët do të kishin pasur mundësi t'a përgatisin seancën gjyqësore në mënyrë shumë më efektive, duke u fokusuar në çështjet të cilat me të vërtetë janë relevante për zgjidhjen e rastit. Për më tepër, një beneficion plotësues e paraqitjes së mëhershme të përgjigjes në padi do të ishte se kështu do të inkurajohej zgjidhja e rastit me marrëveshje, pa hyrë në shqyrtim të mëtutjeshëm gjyqësor.

Vërejtje të njejta mund të bëhen edhe në raport me kundërpadinë. Sipas LPK-së, “[i]padituri, para përfundimit të shqyrtimit kryesor në gjykatë, mund të paraqes para gjykatës së njëjtë kundërpadinë, në qoftë se kërkesa e kundërpadisë është në lidhje me origjinën e kërkesës në padi [...]”<sup>45</sup>. Gjithashtu në këtë rast, afati për paraqitjen e kundërpadisë duhet t'i paraprijë gjykimit. Në fakt, kundërpadia është një padi e re me të cilën pala kundërshtare ka të drejtën e

<sup>42</sup> Neni 285(1) dhe (2) i LPK-së.

<sup>43</sup> Neni 284(2) i LPK-së.

<sup>44</sup> Në sistemet e ndryshme juridike, një nga pasojat për shkak të dështimeve të ngjashme është përfundimi i gjykatës se faktet e pretenduara nga paditësi janë vërtetuar.

<sup>45</sup> Neni 189(1) i LPK-së.



përgjigjes. Kështu, nëse i padituri e paraqet kundërpandinë gjatë gjykimit, palës së kundërt duhet t'i ipet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e përgjigjes së tij/saj, gjë që domosdoshmërisht kërkon shtyerjen e seancës.

### 3.2 Dështimi në përcaktimin e afateve kohore

Mungesa e afateve të qarta kohore për veprime të caktuara procedurale dhe niveli i oportunitetit të lejura për gjykata për caktimin e afateve kohore është edhe një nga të metat në kuadër të ligjit të aplikueshëm mbi procedurën kontestimore.

Një boshllëk i rëndësishëm në ligj është edhe mungesa e dispozitës me të cilën caktohet afati për gjykatën për caktimin e seancës së parë dëgjimore. Duke mos e paraparë periudhën maksimale kohore brenda së cilës duhet të caktohet seanca e parë dëgjimore, ligji vetëm sa i ndihmon vonesat në rastet civile, sepse i është lënë gjyqtarit të vendosë për caktimin e këtyre seancave dhe shpesh ndodhë që ato caktohen me vite pas ngritjes së padive.

Një fushë tjetër në të cilën mungesa e afateve i kontribuon vonesave është ajo që ka të bëjë me përmirësimin e padive<sup>46</sup>. Në këtë drejtim, LPK përcakton se “[k]ur gjykata pranon propozimin për ndryshimin e padisë, ka për detyrë t'i lejojë të paditurit një kohë të mjaftueshme në mënyrë që ai/ajo të përgatitet për shqyrtim në baza të padisë së ndryshuar [...]”<sup>47</sup>. Referimi për “kohë e mjaftueshme” në këtë nen paraqitet si problematike ngase i lejon gjyqtarit një kufi të gjërë pushteti që të vendosë se çka do të konsiderohet kohë e arsyeshme për përgatitjen e mbrojtjes, gjë që do të mund të rezultojë në vonesa të paarsyeshme.. Edhe nëse ndërlikueshmëria e disa rasteve mund të kërkojë më shumë kohë për përgatitjen e përgjigjes së të paditurit, ligji do të duhej të parashih një afat të përgjithshëm me mundësi shqyrtimi lidhur me caktimin e vazhdimin të afatit të paracaktuar për një periudhë më të gjatë kohore kur kjo të jetë e nevojshme (p.sh., afati i përgjithshëm mund të jetë tetë ditë, me mundësi zgjatje për një afat kohor plotësues prej tetë ditëve tjera i cili mund të zbatohet për rastet e ndërlikuara).

I njëjti shqetësim vlen edhe për dispozitat të cilat e rregullojnë çështjen e parashtrësive dhe mendimit të ekspertit. Në rastin e parë, LPK thotë se: “[n]ëse parashtrësit ose anekset nuk janë paraqitur në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë paraqitësin që brenda afatit të caktuar, të paraqes kopje shtesë të tyre. [...]”<sup>48</sup> Lidhur me mendimin e ekspertit, ligji thekson se “[g]jykata do ta caktojë afatin për paraqitjen me shkrim të gjetjeve dhe mendimeve”<sup>49</sup>.

Në këto raste, i është lënë bindjes së lirë të gjykatës për të vendosur afatet kohore kur palët duhet t'i paraqesin ekzemplarët, ose kur ekspertët duhet t'i paraqesin mendimet e veta me shkrim. Ndodh shpesh në praktikë që gjykata të dështojë në përcaktimin e cילו afat kohor, duke krijuar kështu edhe më shumë vonesa në procedurë.

Në një rast para Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştina, ku përfshihet një padi për kompenzim të dëmit, në seancën e mbajtur më 23 mars 2005, gjykata ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit për përgatitjen dhe paraqitjen e mendimit të ekspertit pranë gjykatës. Mëpastaj gjykimi ishte shtyrë për kohë të pacaktuar (*sine die*), deri në paraqitjen e mendimit të ekspertit<sup>50</sup>.

<sup>46</sup> Neni 190 i LPK.

<sup>47</sup> Neni 190(6) i LPK.

<sup>48</sup> Neni 109 (5) i LPK.

<sup>49</sup> Neni 260 i LPK.

<sup>50</sup> Gjatë seancës së njëmbëdhjetë, të mbajtur më 19 janari 2006, kryetari i kolegjit i ka njoftuar palët se eksperti nuk ka patur mundësi ta paraqes mendimin sepse kishte humbur objektin e ekspertizës.

*Në mënyrë që të evitohen këso lloj situatash, përveç afateve specifike brenda secilës dispozitë, ligji do të duhej të përmbajë një rregull të përgjithshëm lidhur me afatin më të gjatë të lejuar për kryerjen e veprimeve procedurale nga palët, ekspertët ose nga palët tjera pjesëmarrëse në procedurë.*

### *3.3 Mungesa e dispozitave me të cilat rregullohet çështja e shtyrjeve*

Siç është përmendur paraprakisht, shtyrjet e pajustificueshme të seancave gjyqësore janë një nga shkaqet për zvarritjet në rastet civile. Në këtë drejtim, mungesa e një dispozite në LPK me të cilën përcaktohen qartë situatat kur mund të lejohen shtyrjet, është një mangësi serioze në ligj. Edhe pse, janë një numër dispozitash të cilat i referohen shtyrjes së seancave të gjykimit/dëgjimeve<sup>51</sup>, këto janë të shpërndara gjithandej LPK-së dhe nuk ka nen me të cilin taksativisht numërohen bazat për shtyrjen e gjykimeve.

Përveç që i ndihmon shtyrjeve, ky boshllëk ligjor u ofron gjyqtarëve një shkallë të gjerë të lirisë së vendosjes me rastin e marrjes së vendimit për shtyrjen e gjykimit. Nga ana tjetër, palëve nuk u janë lënë mundësi tjera përveç ta pranojnë vendimin e gjykatës për shtyrjen e rasteve.

Nga pikëpamja e asaj që u tha më lart, OSBE mendon se LPK-ja do duhej të ndryshohet në mënyrë që me ligj të përcaktohen kriteret e përgjithshme për shtyrjen e gjykimeve.

## *4. Rekomandimet*

- Kryetari i kolegjit duhet të merr një rol më aktiv dhe të jetë më i vëmendshëm gjatë fazës përgatitore të procedurës, duke i zbatuar me kujdes normat relevante të LPK-së. Në veçanti kryetari i kolegjit duhet që:
  - a) Ta ekzaminojë me kujdes padinë para caktimit të datës së seancës përgatitore ose shqyrtimit kryesor në pajtim me nenin 281 të LPK-së.
  - b) Në rast se ka mangësi në padi, ta ftojë paditësin dhe ta udhëzojë në lidhje me përmirësimin ose plotësimin e padisë, ashtu siç parashikohet nga neni 109(1) LPK-së.
  - c) Të sigurojë që padia t'i dorëzohet të paditurit së bashku me thirrjet, ose së paku, tetë ditë para seancës përgatitore, siç parashikohet nga neni 284(1) dhe 293(2) LPK.
  - d) Të shfrytëzojë në mënyrë efektive pushtetin e vendim-marrjes të cilin e parashikon neni 278, ose duke i urdhëruar palët t'i paraqesin para fillimit të gjykimit, të gjitha dokumentet që i kanë në posedim dhe në të cilat do t'i shfrytëzojnë si dëshmi.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të organizojë trajnim të vazhdueshëm ligjor për personelin e gjykatës me qëllim që të njoftohen me dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore dhe me qëllim të rritjes së efektivitetit të tyre.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Departamenti i Drejtësisë dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës, duhet të organizojnë trajnime lidhur me çështjen e menaxhimit të lëndëve për administratorët e gjykatave, nëpunësit dhe gjyqtarët civil.

---

<sup>51</sup> Shih fusnotën nr. 28.

- Gjykatat duhet t'i zbatojnë dispozitat ligjore në disponim dhe t'i gjobisin palët sa herë që ato përmes veprimeve procedurale i shkelin të drejtat e njohura me LPK (nenin 316 të LPK-së).
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të organizoj trajnime lidhur me procedurën e dorëzimit së ftesave gjyqësore, të adresuara për zyrtarët e PTK-së dhe korierët e gjykatave.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të punësojë korierë gjyqësor të përkatesive minoritare me qëllim që të sigurohet një dorëzim më efektiv i ftesave në rajonet e pakicave.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të rekrutoj më shumë gjyqtarë që të punojnë në rastet civile dhe t'i caktoj ata në bazë të sasisë së punës dhe nevojave të secilës gjykatë.
- Avokatët duhet të jenë më proaktiv gjatë procedurës duke kundërshtuar shtyrjet të cilat nuk arsyetohen siç duhet.
- Me qëllim të evitimit të vonesave të paarsyeshme në procedurë, duhet të bëhen këto ndryshime në LPK:
  - a) LPK-ja, duhet të vendosë afate kohore për paraqitjen e padisë dhe përgjigjes në padi për rastet kur nuk mbahet seanca përgatitore.
  - b) Paraqitja e padisë dhe kundërpadisë duhet gjithmonë t'i paraprijë datës se seancës përgatitore ose shqyrtimit kryesor.
  - c) Me ligj duhet të parashikohen pasojat për dështimin e të paditurit në paraqitjen e përgjigjes në padi.
  - d) LPK-ja duhet të vendosë obligimi për gjykatën që në fund të seancës përgatitore të lëshojë një vendim duke përcaktuar qartë se cilat fakte kanë mbetur të kontestueshme dhe duke identifikuar cilat nga to konsiderohen të provuara.
  - e) LPK-ja duhet të përcaktojë afate të qarta kohore për veprimet procedurale në vijim: caktimin e seancës së parë dëgjimore në lëndët civile; përgatitjen e të paditurit pas paraqitjes së padisë së ndryshuar; dhe dorëzimin e dokumenteve ose mendimit të ekspertit nga palët dhe/ose ekspertët.
  - f) LPK-ja duhet të përmbajë një dispozitë me të cilën parashikohen kushtet e përgjithshme për shtyrjen e gjykimeve.

## Kapitulli 2

### TRANSAKSIONET PRONËSORE

Si rrjedhojë e ndjeshmërisë së çështjeve pronësore në kontekstin e pas-konfliktit në Kosovë, ku komunitetet janë zhvendosur dhe prona shpesh është okupuar në mënyrë të paligjshme, gjykatat janë përballur me shumë raste komplekse. Në fakt, edhe pse Drejtorati për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisioni për çështje pronësore dhe banesore për ankesa (DÇPB/KÇPBA) janë marrë me një numër të madh të kërkesave që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore-banesore, shumë konteste pronësore nuk janë mbuluar me mandatin e këtij drejtorati dhe kanë mbetur nën jurisdiksionin e gjykatave<sup>52</sup>.

Për shkak të numrit të madh të serbëve të Kosovës të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi pas konfliktit të vitit 1999, gjykatat në Kosovë janë përballur me probleme të shumta në punën me transaksionet e mëtejme pronësore. Këto probleme, që adresohen në këtë kapitull, përfshijnë shfrytëzimin e dokumenteve të falsifikuara për certifikimin e transaksioneve mashtroese pronësore; fakti se një numër i madh i padive pronësore janë paraqitur kundër personave në mungesë, shumica e të cilëve janë të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi; dhe përfundimisht problemet e mbetura në kontestet pronësore të trashëguara nga e kaluara veçanërisht kur transaksioni në fjalë është kryer vite më parë pa respektimin e kërkesave formale siç është certifikimi gjyqësor i kontratës së blerjes.

Është fakt i njohur se kërkesat ligjore formale për transaksionet pronësore<sup>53</sup> kanë qenë rrallë të respektuara në Kosovë në të kaluarën për shkak të ekzistimit të ligjeve diskriminuese që kufizojnë transaksionet pronësore ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve,<sup>54</sup> dhe për shkak të faktit se njerëzit nuk pajtohen me këto formalitete me qëllim të shmangjes së tatimeve. Është befasuese se një sërë problemesh ngritën kur gjykatat thirren për të vendosur se kush është pronari i ligjshëm dhe se kush ka të drejtë të shes pronën përkatëse.

Ky problem është keqësuar me vërtetimin e transaksioneve in-ekzistente para gjykatës, dhe mungesa e shpeshtë e njëjës nga palët të prekura nga procedura, që e bën të vështirë për gjykatat të përcaktojnë të vërtetën në mesin e fakteve të prezantuara për shkak se shumë herë merr dëshmitë vetëm nga njëra palë. Kjo gjendje keqësohet edhe më tutje për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që veprojnë në Kosovë dhe organeve të Serbisë dhe Malit të Zi, me q'rast vlerësimi i origjinalitetit të dokumenteve si dhe vendndodhja e palëve në mungesë që janë të zhvendosur në atë territor duhet të bëhet nëpërmjet të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut (DD). Ky nuk është vetëm një proces i gjatë që shkakton vonesa serioze në procedurë, mirëpo gjer më tani ka prodhuar gjithashtu rezultate të dobëta, për shkak se nuk është e mundur të konstatohet vlefshmëria e këtyre dokumenteve me qartësi të sigurtë. Për më tepër për shkak të këtij bashkëpunimi të dobët, gjykatat dhe Departamenti i drejtësisë përballen me vështirësi në gjetjen e vendndodhjes së

<sup>52</sup> Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB) dhe Komisioni për ankesa (KA) është themeluar nga PSSP-ja përmes Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, të 15 nëntorit 1999. Shih edhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, 31 tetor 2000, mbi kërkesat pronësore banesore dhe rregullat procedurale dhe të dëshmimeve pranë DÇPB-së dhe KA-së. Pas përfundimit të mandatit të DÇPB/KA, me 04 mars 2006, PSSP-ja e ka shpallur në fuqi Rregulloren e UNMIK-ut nr 2006/10 mbi Zgjidhjen e kontesteve pronësore të pasurisë së paluajtshme në pronësi private, përfshirë pasurinë bujqësore dhe komerciale, me të cilën themelohet Agjencia pronësore e Kosovës si trashëgimtare e DÇPB-së.

<sup>53</sup> Siç është regjistrimi i të drejtave pronësore në zyrën kadastrale dhe vërtetimi i kontratave nga gjykatat.

<sup>54</sup> Shih ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e kufizimeve të transaksioneve të paluajtshmeve, *Gazeta Zyrtare e Serbisë*, Nr. 30 e 22 korrikut 1989, dhe ligji për ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji, *Gazeta Zyrtare e Serbisë*, Nr. 22 e 18 prillit 1991.

palëve që janë në mungesë dhe kumtimin e vendimeve gjyqësore atyre. Këto probleme përfundimisht rezultojnë në një dështim të gjykatave për t'ju përmbajtur të gjitha kërkesave të gjyqimit të drejtë gjatë vendosjes lidhur me kontestet pronësore.

### 1. Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dhe jo të rregullta

Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara për vërtetimin e transaksioneve pronësore mashtruese është një nga problemet që pengon gjykatën në aftësinë e vet për të vlerësuar dëshmitë në lëndët pronësore. Edhe pse ekziston një kornizë ligjore që rregullon kërkesat formale të transaksioneve pronësore, këto dispozita nuk janë duke u zbatuar në mënyrë të efektshme nga gjykatat. Shumë individë janë duke shfrytëzuar rrethanat e tanishme të zhvendosjes dhe mos komunikimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe atyre të Serbisë për të kryer mashtrim duke përdorur dokumentet e falsifikuara të lëshuara në Serbi dhe Mal të Zi. Këto dokumente janë vërtetuar më tutje nga gjykatat në Kosovë të cilat nuk kanë dijeni për origjinën e tyre mashtruese.

Në bazë të ligjit në fuqi “[n]jë kontratë në bazë të së cilës bartet e drejta për shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme apo e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, duhet të përpilohet me shkrim, dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen në gjykatë.”<sup>55</sup> Ligji më tutje parashikon se kontrata e cila nuk është në pajtim me këto kërkesa formale nuk është obligative në aspektin ligjor.<sup>56</sup>

Në rastet kur pala në transaksionin pronësor nuk është personi që ka nënshkruar kontratën, pala nënshkruese duhet të posedojë autorizimin ligjor me shkrim të vërtetuar nga gjykata për të përfaqësuar palën gjatë nënshkrimit dhe vërtetimit të kontratës.<sup>57</sup> Më tutje, në vërtetimin e kontratës pronësore ku pala shitëse është e përfaqësuar nga pala e tretë, zyrtari i gjykatës duhet të vërtetojë se pala e tretë nënshkruese e kontratës është e autorizuar në aspektin ligjor nga pala shitëse për ta përfaqësuar atë.<sup>58</sup> Pasi të ketë përfunduar kjo procedurë, nga gjykata kërkohet që t'ia dërgojë kontratën zyrës kadastrale në mënyrë që transaksioni të regjistrohet.

Përkundër kësaj procedure të detajuar për transaksionet pronësore, në shumë raste të monitoruara nga OSBE-ja këto rregulla nuk janë respektuar nga gjykatat<sup>59</sup>. Si rrjedhojë e kësaj gjykatat kosovare kanë zbatuar transaksionet mashtruese në bazë të dokumenteve të falsifikuara.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Klinë/Klina, dy të paditur shqiptar të Kosovës falsifikuan kartelën e identifikimit të pronarit të pronës nën kontest, që ishte një serb i Kosovës i cili kishte qenë i vdekur që 12 vjet dhe e përdorën atë për të

<sup>55</sup> Neni 4(2) i ligjit për bartjen e pronës së paluajtshme, më tutje LBPL, publikuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë*, Nr. 43/81 më 1 gusht 1981.

<sup>56</sup> Neni 4(3) i LBPP. Ligji gjithashtu parashikon që zyrtari i gjykatës i vërteton nënshkrimet e palëve pasi të vërtetohet autenticiteti, përmes nënshkrimit personalisht dhe në prani të zyrtarit të gjykatës dhe përmes deponimit të nënshkrimit si palë dhe personi i cili e paraqet dokumentin për verifikim duhet të dëshmojë para zyrtarit të gjykatës se ai ose ajo është autori i dokumentit (neni 4(1) dhe (2) i Ligjit mbi vërtetimin e nënshkrimeve dhe kopjeve). Nënshkrimet mund të vërtetohen vetëm atëherë kur zyrtari i gjykatës e njeh personalisht personin i cili kërkon vërtetimin, ose kur identiteti i tij ose saj vërtetohet plotësisht përmes letërnjoftimit. Kur personi nuk e ka letërnjoftimin, vërtetimit mund të bëhet edhe përmes deklaratës së dy dëshmitarëve të moshës madhore identiteti i të cilëve vërtetohet përmes letërnjoftimeve (shih nenin 8 të Ligjit mbi vlefshmërinë e nënshkrimeve dhe kopjeve).

<sup>57</sup> Nenet 89(1) dhe 90 i ligjit mbi kontratat dhe detyrimet i publikuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë*, Nr. 29/1978 më 26 maj 1978.

<sup>58</sup> Neni 9 i Ligjit për vlefshmërinë e nënshkrimeve dhe kopjeve.

<sup>59</sup> Përveq rasteve të identifikuar nga monitorët e OSBE-së, divizioni penal i DD-së ka inicuar hetimet penale për 43 rast të transaksioneve mashtruese pasiqë ata kishin pranuar ankesa nga personat e zhvendosur.

lëshuar autorizimin në gjykatën në Kragujevc, Serbi. Kjo i ka mundësuar njërit nga të paditurit që në emër të pronarit të ndjerë, të ia shes pronën të paditurit tjetër. Duke shfrytëzuar atë autorizim të falsifikuar, të paditurit kryen dhe vërtetuan transaksionin pronësor pranë gjykatës komunale në Klinë/Klina, e cila nuk kishte mundësi të dijë nëse autorizimi është lëshuar bazuar në kartelën e falsifikuar të identifikimit. Padiësi në këtë rast, një serb i Kosovës i zhvendosur në Serbi pas konfliktit, i cili në ndërkohë u kthye në Kosovë, ishte i biri i pronarit të regjistruar dhe trashëgimtari i vetëm i pronës. Më 27 shtator 2004 ai kërkoi që gjykata të prish transaksionin pronësor të falsifikuar të vërtetuar nga gjykata komunale në Klinë/Klina, dhe për ta shpallur atë si pronar i ligjshëm për shkak se prona nuk ishte shitur. Më 20 tetor 2005 gjykata miratoi kërkesën si të bazuar duke vendosur se të paditurit kishin realizuar kontratën e shitblerjes bazuar në dokumente të falsifikuara duke ia atribuar pronën padiësit.

Në 11 raste të ngjashme pranë Gjykatës Komunale në Klinë/Klina, një numër i serbëve të Kosovës nga ajo komunë të cilët kishin ikur në Serbi pasi që KFOR-i kishte ardhur në Kosovë, paraqitën kërkesa kundër shqiptarëve të Kosovës të cilët kishin okupuar në mënyrë ta paligjshme shtëpitë e tyre.<sup>60</sup> Ata pohuan se të paditurit kishin marrë pronat e tyre pa njohurinë e tyre duke përdorur autorizime të falsifikuara të lëshuara nga gjykatat në Serbi dhe Mal të Zi, të cilat u kishin lejuar palëve të treta për të shitur pronat, domethënë në të mirë të padiësve. Duke i shfrytëzuar këto autorizime të falsifikuara të paditurit kishin vërtetuar transaksionet pronësore të falsifikuara pranë gjykatës komunale në Klinë/Klina, zyrtarët e të cilëve kishin injoruar faktin se autorizimet e lëshuara në Serbi dhe Mal të Zi ishin falsifikuar. Për shkak se padiësi ishin zhvendosur në Serbi dhe nuk kishin kontakt fizike me pronat e tyre, ata kishin kuptuar për shitjen e shtëpive të tyre vetëm pasi që këto transaksione ishin vërtetuar në gjykatën komunale në Klinë/Klina, kur disa prej tyre janë kthyer në Kosovë.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, një serb i Kosovës i cili për momentin është duke jetuar në Serbi kishte kërkuar më 10 gusht 2005 që gjykata të njeh të drejtat e tij pronësore për një shtëpi në Prizren, tani e okupuar nga i padituri i dytë, shqiptar i Kosovës. Në bazë të padisë, i padituri i dytë bleu pronën pa njohurinë apo ndërhyrjen e padiësit dhe nëpërmjet të dokumenteve të falsifikuara kishte lëshuar një autorizim në gjykatën e Mitrovicës/Mitrovica, duke i mundësuar së këndejmi një avokati nga Beogradi që të shes shtëpinë në emër të padiësit Përderisa ai autorizim parashihte mundësinë e delegimit të pushtetit të përfaqësimit, personi i autorizuar nga Beogradi lëshoi një autorizim tjetër pranë të njëjtës gjykatë në emër të një avokati turk të Kosovës nga Prizreni, gjithashtu i paditur në këtë rast duke i mundësuar këtij të fundit që të shes pronën e kontestuar në përfaqësimin e nënkuptuar të padiësit. Me atë autorizim të dytë, të paditurit vërtetuan kontratën e shitblerjes pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Paraqitësi i kërkesës zbuloi këtë transaksion mashtrues më vonë gjatë procedurës së DPÇPB-së për dëbimin e të paditurit të dytë nga shtëpia.<sup>61</sup>

Siç tregojnë këta shembuj dhe rastet tjera të raportuar, përdorimi i kartelave të falsifikuara të identifikimit për nxjerrjen e autorizimeve zyrtare në Serbi dhe Mal të Zi që iu mundëson personave në Kosovë që të shesin pronat e Serbëve të Kosovës që janë zhvendosur në Serbi

<sup>60</sup> Kërkesat ishin paraqitur më 18 shkurt 2004 dhe 9 dhjetor 2005.

<sup>61</sup> Për më tepër letërnjoftimi i padiësit e paraqitur pranë gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica për vërtetim të prokurës mbante një fotografi dhe shënimet personale të cilat nuk përputheshin me ato të padiësit. Ky fakt i vërtetuar nga monitoruesit e OSBE-së nëpërmjet të marrjes pjesë në gjykim në të cilin padiësi ishte i pranishëm, dhe konsultimin e dokumenteve në arkivin e gjykatës komunale në Mitrovicë/Mitrovica, kishte mbetur i pavërejtur nga gjykata në Prizren. Përkundër ekzistimit të kësaj dëshmie se letërnjoftimi i padiësit ishte i falsifikuar gjykata në Prizren kishte dështuar për të mbledhur informata për shkak se nuk kishte komunikuar me gjykatën në Mitrovicë/Mitrovica.

është praktikë e shpeshtë që ndodh në gjykata.<sup>62</sup> Vërtetimi në Kosovë i origjinalitetit të këtyre autorizimeve duhet të bëhet nga DD-ja nëpërmjet të komunikimit me Ministrinë e Drejtësisë në Serbi dhe Mal të Zi.<sup>63</sup> Megjithatë, kjo procedurë shumë rrallë ndiqet, mirëpo edhe kur ndiqet ajo nuk është gjithmonë efektive për shkak se në shumë raste DD-ja nuk ka ndonjë mënyrë tjetër për të vërtetuar vlefshmërinë e dokumenteve të prezantuara për shkak se autoritetet në Serbi dhe Mal të Zi zakonisht nuk iu përgjigjen këtyre kërkesave. Atëherë kur ka përgjigje zakonisht kjo merr aq kohë sa që shkakton vonesa të paarsyeshme në procedurat gjyqësore në Kosovë<sup>64</sup>. Vetëm nëpërmjet të një bashkëpunimi më të mirë me autoritetet në Serbi dhe Mal të Zi ka mundësi që kjo procedurë të jetë efektive.

Përkundër përdorimit të kartelave të falsifikuara të identifikimit për falsifikimin e autorizimeve ligjore dhe vërtetimin mashtrues të qarkullimit të pronës, OSBE-ja ka vërtetuar se dokumentet tjera gjithashtu janë falsifikuar dhe prezantuar si dëshmi para gjykatave në kontestet pronësore.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Istog/Istok, pesë romë të Kosovës, që për momentin jetojnë në Gjermani, kërkuar më 24 maj 2004 që gjykata të prish kontratën e shitblerjes nëpërmjet të së cilës, të paditurit, dy shqiptarë të Kosovës kishin blerë shtëpinë familjare të paditësve. Në bazë të padisë, të paditurit kanë përdorur çertifikatën e falsifikuar të vdekjes së babait paditësve,<sup>65</sup> që kishte qenë pronari i regjistruar i pronës për të vërtetuar trashëgiminë për pronën për paditësin e parë. Për më tepër, të paditurit kishin përdorur kartelën e falsifikuar të identifikimit të lëshuar nga një gjykatë në Mal të Zi që i mundësonte një avokati nga Serbia për të shitur pronën në emër të paditësit të parë si trashëgimtar i vetëm i personit të vdekur. Duke përdorur dokumentet e falsifikuara të paditurit vërtetuan kontratën mbi shitblerjen e shtëpisë pranë gjykatës komunale në Istog/Istok dhe kishin regjistruar pronën në fjalë në emër të tyre në zyrën kadastrale. Sipas padisë, paditësi i parë nuk kishte lëshuar ndonjë autorizim për t'ia shitur pronën të paditurve.<sup>66</sup>

Në një shembull të dytë në Gjykatën Komunale në Prishtinë/Priştina paditësi, një shqiptarë e Kosovës, pohoi se më 7 prill 1996 kishte blerë një banesë në Prishtinë/Priştina nga i padituri, një serb i Kosovës. Për shkak se kontrata e shitblerjes e prezantuar si dëshmi nga paditësja nuk ishte vërtetuar nga gjykata dhe kryetari i kolegjit kishte dyshime mbi vlefshmërinë e saj, gjykata kërkoi nga Drejtorati i kriminalitetit të SHPK-së që t'i ekzaminojë nënshkrimet e palëve dhe të vlerësojë origjinalitetin e tyre. Raporti i ekspertizës i dorëzuar policisë konfirmonte se nënshkrimi i të paditurit në kontratën e shitblerjes së pronës së kontestuar ishte i falsifikuar dhe bazuar në këtë dëshmi gjykata refuzoi padinë si të pabazë.

<sup>62</sup> Në bazë statistikave të Departamentit të drejtësisë për momentin ekzistojnë 36 ankesa të transaksioneve mashtruese që janë në zhvillim e sipër në Kosovë.

<sup>63</sup> Qarkorja e drejtësisë DD/DIR/344/JH/04 dhe DD/LPD/0371/er/05.

<sup>64</sup> Bazuar në statistikat e ofruara nga DD, prej 25 Korrikut 2004 deri me 26 Korrik 2005 DD-ja kishte kërkuar nga Ministria e Drejtësisë të Serbisë dhe Malit të Zi verifikimin e origjinalitetit të dokumenteve të autorizuar për 272 raste. Në këtë moment, më shumë se një vit më vonë pas atyre kërkesave DD-ja nuk ka pranuar përgjigje në lidhje me 57 raste të cilat mbeten të pezulluara për kohë të pacaktuar.

<sup>65</sup> Çertifikata e vdekjes e lëshuar nga pala e paditur është lëshuar në Serbi, përderisa i vdekuri, babai i paditësit kishte vdekur në Gjermani. Paditësit paraqitën si dëshmi çertifikatën e vërtetë të vdekjes së babait të tyre e cila ishte lëshuar në Bremen, Gjermani dhe e cila mbante datën tjetër nga ajo e dokumentit të shfrytëzuar nga pala e paditur për vërtetimin e transaksionit.

<sup>66</sup> Deri sa vazhdonte ky kontest, prokurori publik i Pejës/Peć ka filluar procedurën penale kundër të paditurve për veprën penale "legalizim të përmbajtjes së pavërtetë", në pajtim me nenin 334 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovë në të cilin thuhet se "Kushdo që e vë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pavërtetë, e paraparë të shërbejë si provë në një çështje ligjore në një dokument publik, në një regjistër ose libër dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet" dhe se "kushdo që e përdor dokumentin, regjistrin ose librin e tillë, që e din se është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni". Procedura penale për këtë lëndë është duke vazhduar.

Nëse përdorimi i dokumenteve zyrtare të falsifikuara me vlerë të posaçme dëshmuese veç ngrit shqetësime serioze, kur dokumentet e përdorura përbëjnë bazë sipas të cilës të drejtat pronësore janë të regjistruara, problemi bëhet edhe më trazues. Kështu qëndron puna kurdo që ka shfrytëzim të pranueshëm të dokumenteve jo të rregullta kadastrale të cilat teoritikisht duhet të jenë dëshmitë më të qëndrueshme në provimin e të drejtave pronësore për shkak se çdo qarkullim i paluajtshmërisë duhet të regjistrohet në kadastrë.<sup>67</sup> Nëse këto dokumente gjithashtu keqpërdoren dhe gjykatat nuk janë në gjendje të zbulojnë këto parregullsi, kjo minon në mënyrë serioze besueshmërinë e gjyqësisë në rregullimin e kontesteve pronësore.

Në këtë kontekst, OSBE-ja ka identifikuar një sërë rastesh në të cilat listat poseduese të prezantuara si dëshmi kishin qenë të parregullta. Disa nga këto dokumente nuk përmbanin numrin hyrës në regjistrat komunal kadastral, nënshkrimin e zyrtarit publik i cili kishte lëshuar listën poseduese, nënshkrimin e drejtorit të zyrës komunale kadastrale apo vulën e zyrës komunale kadastrale dhe të gjitha kërkesat formale për vlefshmërinë e listave poseduese.<sup>68</sup>

Sipas ligjit në fuqi, kur lëshohet në formë të duhur, dokumenti publik dëshmon saktësinë e asaj çka është e theksuar në të.<sup>69</sup> Ligji gjithashtu thekson se kurdo që gjykata ka ndonjë dyshim përkitazi me origjinalitetin e dokumentit, ai mund të kërkojë nga agjencia për të cilën pohohet se ka lëshuar dokumentin të deklarohet në këtë drejtim.<sup>70</sup>

Përkundër kësaj kornize ligjore, në disa raste në të cilat listat e parregullta poseduese është dashur të ngrisin dyshime në lidhje me origjinalitetin e tyre, gjykatat jo vetëm që kanë pranuar këto dokumente si të vlefshme mirëpo gjithashtu edhe i kanë vlerësuar ato si dëshmi në aktgjykimet e tyre të formës së prerë, pa ua dorëzuar ato zyrës komunale kadastrale për të cilat supozohet se i kanë lëshuar me qëllim të vërtetimit të origjinalitetit të tyre. Përpos shkeljes së ligjit, kjo praktikë minon sistemin e qarkullimit të pasurisë në Kosovë, duke lejuar mashtrimin dhe duke ndikuar në kredibilitetin e shënimeve kadastrale.

Në një kontest pronësor të inicuar më 26 shkurt 2004 pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, paditësit parashtruan si dëshmi listën poseduese të cilës i mungonte

<sup>67</sup> Neni 33 i ligjit për marrëdhëniet themelore pronësoro-juridike të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 6/80

<sup>68</sup> Shih nenin 230 të LPK-së. Sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) procedura për të fituar listën poseduese, që mund të shfrytëzohet për qëllime zyrtare, që përbëhet nga hapat si në vijim (sekuenca e të cilave mund të dallojë): a) pala e interesuar dorëzon një kërkesë zyrës kadastrale komunale; b) pala e interesuar paguan taksat për shërbimet e zyrës komunale kadastrale; c) kërkesa është e regjistruar në librin komunal kadastral; d) lista poseduese shtypet, e) zyrtari i zyrës komunale kadastrale nënshkruan listën poseduese; f) drejtori i zyrës kadastrale komunale nënshkruan dhe vulos listën poseduese; dhe g) lista poseduese i jepet pronarit apo personit të autorizuar ligjor. Lexo gjithashtu Udhëzimin Administrativ Nr. 2004/08, nxjerrë nga Ministria e Shërbimeve Publike, mbi zbatimin e ligjit për kadastrën që thekson në nenin 23 (2) se "certifikatat, skicat, kopjet e planeve dhe dokumentacionin tjetër u lëshohet subjekteve juridike dhe personave fizik në bazë të standardeve të përcaktuara nga AKK."

<sup>69</sup> Lexo Radoslav Cosic, *Komentaret për ligjin mbi procedurën kontestimore*, Beograd 1998, faqe 125, që deklaron se sipas nenit 230 LPK "prezumimi juridik që dokumentet publike janë origjinale mund të refuzohet. Palët mund të dëshmojnë që faktet e paraqitura në dokument janë të pavërteta, që dokumenti nuk është lëshuar nga organi kompetent apo që dokumenti është i falsifikuar. Kur gjykata dyshon për origjinalitetin e dokumentit, ajo është e obliguar për të ndërmarrë masat për sqarimin e vlefshmërisë së dokumentit [...]" (përkthimi jozyrtar).

<sup>70</sup> Neni 230 (4) LPK-së. Në rastin e listave poseduese agjencia kompetente do të ishte zyra komunale kadastrale (Shih nenin 3.3, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, që delegon përgjegjësinë për mbajtjen e shënimeve kadastrale komunave).



numri i protokollit që tregon futjen në regjistrat komunal kadastral,<sup>71</sup> nënshkrimin (apo emrin) e referentit, si dhe nënshkrimin e drejtorit dhe vulën e komunës. Gjykata pranoi si dëshmi këtë listë poseduese gjatë shqyrtimit kryesor. Në aktgjykimin e vet, gjykata bëri të ditur se ka pranuar si dëshmi listën poseduese në fjalë dhe përfundoi se “nga ajo që është thënë [dhe] dëshmitë e pranuar, [...] gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

Në një kontest tjetër pronësor pranë Gjykatës Komonale në Gjilan/Gnjilane, ngjau një situatë e ngjashme. Paditësit paraqitën padinë më 12 tetor 2004 dhe paraqitën si dëshmi dy lista poseduese. Njëri nga ta ishte një dokument i vlefshëm që mbante të gjitha informatat e nevojshme dhe vulën gjegjëse. Megjithatë, lista tjetër poseduese nuk e kishte as numrin e protokollit që tregon futjen e listës poseduese në regjistrin kadastral,<sup>72</sup> dhe as nënshkrimin e drejtorit apo vulën e komunës.<sup>73</sup> Përsëri, gjykata pranoi si dëshmi të dyja listat poseduese gjatë shqyrtimit kryesor dhe në aktgjykimin e vet të shpallur në të njëjtën datë, gjykata pranoi se i konsideron të dyja listat poseduese si të besueshme në mesin e dëshmive tjera.

Në shembujt e mësipërm gjykatat që vërtetuan këto qarkullime të pasurisë nuk kishin vërejtur falsifikimet e çertifikatave të vdekjes të lëshuara nga gjykatat në Serbi dhe Mal të Zi dhe ishin bazuar në listat poseduese të parregullta. Më tutje, gjykatat dështuan t’ia përcjellin këto dokumente të falsifikuara apo të parregullta DD-së apo zyrës kadastrale me qëllim të vërtetimit të origjinalitetit të tyre.<sup>74</sup> Si rezultat, disa qarkullime mashtruese të pasurisë ishin vërtetuar dhe gjykatat kishin legalizuar këto qarkullime të paligjshme të pasurisë duke penguar procesin e kthimit të pakicave në Kosovë.

## *2. Kërkesat pronësore kundër personave në mungesë pa njohurinë e tyre*

Një problem tjetër që ndikon në kontestet pronësore është fakti se në shumë raste paditë janë ngritur kundër personave në mungesë, zakonisht pronar serb të Kosovës të zhvendosur vendndodhja e të cilëve është e panjohur. Për shkak se gjykata nuk mundi të gjejë vendndodhjen e të paditurve, gjykimet zakonisht shtyhen derisa të jetë e mundur të gjinden adresat e tyre nëpërmjet të Departamentit të Drejtësisë për t’i thirrur ata rregullisht apo për të emëruar përfaqësuesin e përkohshëm për të vepruar në emër të tyre, proceset e tilla gjyqësore zakonisht zgjasin disa muaj. Ky problem jo vetëm që ndikon në rrjedhjen e shpejtë të lëndëve të gjykatës që kanë të bëjnë me pasurinë duke shkaktuar vonesa të panevojshme,<sup>75</sup> mirëpo gjithashtu krijon vështirësi serioze për gjykatat në sigurimin e respektimit të plotë të drejtës së të paditurit për gjykim të drejtë.

Në fakt, e drejta për gjykim të drejtë kërkon që çdo person të ketë të drejtë të gëzojë qasje në gjykatë.<sup>76</sup> Prania efektive dhe pjesëmarrja e të paditurit në kontestet pronësore nuk është

<sup>71</sup> Më 27 korrik 2005 OSBE-ja kontrollon librin e regjistrat të zyrës përkatëse kadastrale dhe nuk kishte gjetur këtë listë poseduese të regjistruar në datën e përmendur në këtë dokument.

<sup>72</sup> Gjithashtu në këtë rast, OSBE-ja kontrollon regjistrin në zyrën kadastrale më 27 korrik 2005 dhe nuk kishte gjetur listën poseduese të regjistruar siç është nxjerrë në datën e përmendur në dokument.

<sup>73</sup> Edhe pse nënshkrimi që i përgjigjet referentit ishte vendosur, emri i këtij të fundit nuk ishte shtuar.

<sup>74</sup> Qarkoret e Drejtësisë DD/DIR/344/JH/04 dhe DD/LPD/0371/er/05 dhe neni 230 (4) LPK

<sup>75</sup> Lexo aktgjykimet Poiss kundër Austrisë, A 117, par. 60 (1987), dhe Hentrich kundër Spanjës, KEDNJ, sipas të cilës e drejta për t’u gjykuar brenda periudhës së arsyeshme kohore dhe detyra e mëtejme e gjykatave që të jenë të kujdesshme dhe të sigurojë një proces të shpejtë është veçanërisht me rëndësi në lëndët pronësore që kanë të bëjnë me titullin pronësor ndaj tokës.

<sup>76</sup> Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Lexo gjithashtu aktgjykimet e Kremzow v. Austria, Aktgjykimi i 21.09.1993, Seria A, Nr. 268-B (1994) 17 EHRR 322, dhe X kundër Suedisë, 30.06.1959 (1958-9), App. 434/58, 2 vjetari 354, në faqen 370, sipas të cilit kurdo që është e nevojshme për korrektësinë e procedurës që pala e paditur të jetë e pranishme dhe të merr pjesë në gjykim për shkak të rëndësisë së saj për interesat e palës së paditur, ai/ajo nuk duhet të jetë i pranishëm.

vetëm kërkesë e të drejtës për gjykim të drejtë *per se* mirëpo gjithashtu edhe e parimit të barazisë së armëve në procedurë sipas të cilës të paditurit i jepen të drejtat procedurale sikurse edhe paditësit.<sup>77</sup>

Duke qenë kërkesë e gjykimit të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë imponon një detyrim pozitiv në institucionet publike për të siguruar praninë e të paditurit në procedurën civile.<sup>78</sup>

Duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të sigurisë në Kosovë dhe problemet rreth lirisë së lëvizjes që ndikojnë në komunitetin serb të Kosovës, e drejta e tyre për qasje në gjykata është penguar në mënyrë serioze. Me qëllim të dhënies së ndihmës në zgjidhjen e këtij problemi UNMIK-u ka krijuar zyrën ndërlidhëse me gjykatat në disa zona të banuara me serb në Kosovë.<sup>79</sup> Edhe pse ky është një zhvillim pozitiv ai nuk zgjidh problemin e qasjes në gjykata kurdo që ndonjë pjesëtar i pakicave gjendet jashtë Kosovës dhe kur adresa e tij/saj është e panjohur, në të cilin rast kontesti pronësor zakonisht vazhdon në *mungesë* përderisa pala që është në mungesë mbetet në mos-dijeni përkitazi me kërkesën pronësore juridike të paraqitur kundër pronës së tij/saj në Kosovë, duke qenë i mbrojtur nga përfaqësuesi i përkohshëm i emëruar nga gjykata.

OSBE-ja ka hasur në një numër shembujsh të rasteve të tilla dhe ka raportuar mbi problemet e përballura përkitazi me emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në kontestet pronësore që kanë të bëjnë me pakicat etnike.<sup>80</sup> Kjo pjesë e raportit ofron një pasqyrë të aktiviteteve përcjellëse mbi shqetësimet dhe rekomandimet pasi që më herët ishin raportuar nga OSBE-ja dhe një pasqyrë mbi atë se si gjykatat për momentin janë duke u përballur me këtë çështje.

### *2.1 Çështjet periodike përkitazi me emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në kontestet pronësore që përfshijnë pakicat etnike*

Shqetësimet kryesore të identifikuara nga OSBE-ja përkitazi me procedurën e emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm në kontestet pronësore që kanë të bëjnë me pakicat janë paraqitur në vazhdim:

- a) Fakti se pas dështimit për të gjetur të paditurin në adresën e ofruar nga paditësi apo kur kjo adresë është e panjohur për paditësin gjykatat nuk kanë bërë përpjekje të arsyeshme për të gjetur të paditurin nëpërmjet të mjeteve tjera të mundshme;<sup>81</sup>
- b) Dështimi i gjykatave për të demonstruar se vendimi për të emëruar përfaqësuesin e përkohshëm është i domosdoshëm për të parandaluar pasojat e dëmshme për palët që shkaktohet nga vonesa në gjetjen e të paditurit dhe emërimin e përfaqësuesit ligjor të rregullt;<sup>82</sup>

---

Duke marrë parasysh rezultatet e mundshme të kontesteve pronësore kundër personave të zhvendosur, këto raste janë veçanërisht të ndjeshme për shkak se rezultati përfundimtar mund të jetë që palët e paditura në mungesë nuk do të jenë në gjendje të kthehen në pronat e tyre në Kosovë.

<sup>77</sup> Neni 5 i LPK-së deklaroi se “gjykata i jep secilës palë mundësi për t’u shprehur përkitazi me kërkesëpaditë dhe deklaratat e palës kundërshtare.”

<sup>78</sup> Lexo aktgjykimin e Golder kundër UK, A 18, 1975, KEDNJ

<sup>79</sup> Zyrat ndërlidhëse të gjykatave janë përgjegjëse për sigurimin e të drejtës për qasje në gjykata për të gjithë pjesëtarët e komunitetit serb duke iu ofruar atyre transportin dhe duke i dorëzuar atyre fletëthirrjet për gjyq.

<sup>80</sup> Raporti tematik për emërimin e përfaqësuesve në kontestet pronësore që përfshin pakicat si palë të paditura, publikuar nga OSBE-ja në prill 2005.

<sup>81</sup> Lexo nenin 148 i LPK-së përcakton se “nëse pala nuk mundet të kuptojë adresën e personit të cilit shkresa i është dorëzuar [...] gjykata përpqet të merr informata nga organi kompetent administrativ apo të fitojë informata të nevojshme në ndonjë mënyrë tjetër.”

<sup>82</sup> Sipas nenit 84 të LPK-së [përfaqësuesi i përkohshëm emërohet vetëm me kusht që procedura e rregullt për emërimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjaste gjatë duke shkaktuar pasoja të dëmshme për një apo dy palët.

- c) Dështimi për të shpallur emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në mënyrë të duhur;<sup>83</sup>
- d) Procedura joadekuatë e ndjekur për përzgjedhjen dhe kompensimin e përfaqësuesve të përkohshëm zakonisht avokatë shqiptar të Kosovës, të sugjeruar dhe kompensuar nga paditësit, duke ngritur kështu dyshime për animet e mundshme të përfaqësuesit të përkohshëm në të mirë të pozitës së paditësit; dhe
- e) Rezultati i dobët i punës së avokatëve të emëruar si përfaqësues të përkohshëm të cilët kishin qenë pasiv në shumicën e procedurave të përcjella nga OSBE-ja duke dështuar që të sfidojnë dëshmitë e paraqitura nga paditësit apo për të propozuar dëshmitë në mbrojtje të të paditurit në mungesë dhe shpeshherë edhe duke dështuar që të marrin pjesë në seancat gjyqësore pa arsyetim.

Pasiqë OSBE-ja ka raportuar mbi këto probleme, disa gjykata janë përpjekur që të korrigjojnë praktikën e tyre me qëllim të respektimit të procedurës ligjore mbi emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm, disa herë duke u përballur me probleme të paparashikueshme gjatë përpjekjes për të marrë aktivitete përcjellëse pas rekomandimeve të nxjerra nga OSBE-ja. Në vijim janë paraqitur shembujt e rasteve të monitoruara në të cilat gjykatat janë përpjekur për të përdorur organet administrative në dispozicion apo masat tjera me qëllim të gjetjes së vendndodhjes së të paditurve në mungesë para se të vendosin për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć që ka të bëjë me një padi pronësore të ngritur më 29 maj 2005 gjykata nuk ka mundur të gjejë vendndodhjen e tre të paditurve serbë të Kosovës, që për momentin janë të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi. Në përgjigje të kërkesës së paditësit për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit, gjykata vendosi që së pari të përpiqet të gjejë vendndodhjen e tyre nëpërmjet të Departamentit të Drejtësisë.<sup>84</sup>

Në një rast tjetër pronësor të iniciuar më 3 mars 2003, Gjykata Komunale në Vushtrri/Vučitrn është përpjekur disa herë që të gjejë vendndodhjen e të paditurve në mungesë nëpërmjet të Zyrës për ndërlidhje të gjykatës që është përgjegjëse për vendosjen e lidhjes ndërmjet të gjykatës dhe personave të zhvendosur serb nga rajoni i Vushtrrisë/Vučitrn. Për shkak se këto përpjekje nuk ishin të suksesshme, gjykata përpiqet të gjejë vendndodhjen e të paditurve nëpërmjet të Zyrës për ndërlidhje me gjykata në Graçanicë, përsëri pa sukses. Përfundimisht, pas emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të përfaqësuar ata, gjykata u përpoq të njoftojë të paditurit për atë emërim nëpërmjet të lajmërimit publik të vendosur në gjykatën komunale në Zubin Potok, ku të paditurit përkohësisht kanë pasur vendbanimin e tyre pas konfliktit. Përkundër këtyre përpjekjeve, gjykata ishte në pamundësi të gjejë vendndodhjen e të paditurve dhe vazhdoi rastin.

Në një rast pronësor pranë Gjykatës Komunale në Gjiilan/Gnjilane, padia ishte paraqitur më 21 maj 2003 mirëpo i padituri serb i Kosovës mungonte dhe adresa e tij në Serbi ishte e panjohur. Gjykata kërkoi të gjejë vendndodhjen e të paditurve nëpërmjet të Departamentit të drejtësisë para procedurës për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Megjithatë, procedura e kërkesave dhe përgjigja nga Departamenti i drejtësisë nuk kishte dhënë ndonjë rezultat dhe gjykimi ishte shtyrë në mënyrë të përsëritur. Si rezultat i kësaj situatë, rasti është zgjidhur në mënyrë serioze.

<sup>83</sup> Neni 86 i LPK-së thotë se “[...] gjykata bën shpalljen e cila publikohet në gazetën zyrtare [...] dhe vendoset në tabelën e shpalljeve dhe sipas mundësisë bëhet publike në ndonjë mënyrë tjetër.” Në shumicën e rasteve të monitoruara nga OSBE-ja shpallja ishte bërë në gazetën në gjuhën shqipe që janë në dispozicion vetëm në Kosovë, të cilat nuk ka gjasa që të lexohen nga të paditurit serbë Kosovës që janë të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi.

<sup>84</sup> Vlen të ceket se kërkesat e dërguara Departamentit të Drejtësisë nuk kishin dhënë rezultate dhe gjykimi gjer më tani është shtyrë në mënyrë të përsëritur për shkak të mungesës së të paditurit.

Përfundimisht pas përpjekjeve të dështuara të gjykatës për gjetjen e vendndodhjes së të paditurit, procedura kishte vazhduar në mungesë të tij nëpërmjet të emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm për ta përfaqësuar atë.

Përpjekjet e gjykatës për të gjetur vendndodhjen e të paditurve që mungojnë nëpërmjet të Departamentit të drejtësisë dhe organeve tjera ekzistuese administrative para zhvillimit të procedurës për emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm paraqet një zhvillim për t'u lavdëruar. Megjithatë, siç tregojnë shembujt e sipërpërmendur, përpjekjet e tyre të vlefshme nuk kanë dhënë rezultate për shkak se vendndodhja e të paditurve nuk mund të gjendej, duke mbetur në mungesë dhe pa dijeni për lëndët pronësore të iniciuara kundër tyre.

Një fushë tjetër e përmirësimit qëkur OSBE-ja ka raportuar për këto probleme paraqet një përpjekje nga disa gjykata për të përdorur mjetet e duhura për publikimin e shpalljeve të emërimeve të përfaqësuesve të përkohshëm. Në disa raste, gjykatat janë përpjekur që të shpallin emërimin në gazetata serbe që shpërndahen në Serbi dhe Mal të Zi ku të paditurit qëndronin me vendbanim në vend të gazetave në gjuhën shqipe siç ishte praktika e mëparshme.<sup>85</sup> Këto përpjekje janë përballur megjithatë me pengesa serioze në bazë të deklaratave dhe ankesave të disa gjyqtarëve bëra monitoruesve të OSBE-së për shkak se gazetata në gjuhën serbe që janë kontaktuar nga gjykatat kanë refuzuar në mënyrë të vazhdueshme për të publikuar shpalljet e gjykatës duke deklaruar se ato nuk i pranojnë dhe nuk ndjekin urdhrat e gjykatave të UNMIK-ut në Kosovë.

Në një rast që përfshin 15 kërkesa pronësore pranë Gjykatës Komunale në Suharekë/Suva Reka kundër 24 serbëve të Kosovës nga ajo komunë që për momentin janë të zhvendosur në Serbi, gjykata vendosi më 21 qershor 2004 që të emërojë tre përfaqësues të përkohshëm për të mbrojtur të paditurit në mungesë. Ky vendim është marrë nga gjykata pa bërë ndonjë përpjekje për të gjetur vendndodhjen e të paditurve në mungesë apo së paku pa shpallur në mënyrë të duhur atë emërim. Megjithatë, pasi që OSBE-ja kishte shpallur raportin e vet, gjykata pezulloi rastin me qëllim që të përpiqet dhe të gjejë vendndodhjen e të paditurve në mungesë dhe të shpall emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm nëpërmjet të publikimit të tyre në gazetata në gjuhën serbe. Përkundër këtyre përpjekjeve gjer më tani gjykatat nuk kanë pasur mundësi që të thërrasin të paditurit apo të publikojnë shpalljet në gazetata në gjuhën serbe.<sup>86</sup>

Në një rast pronësor të iniciuar më 6 shkurt 2004 pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priştina, i padituri serb i Kosovës ishte i zhvendosur në Serbi dhe mungonte gjatë tërë procedurës. Pas disa përpjekjeve të dështuara për të gjetur vendndodhjen e të paditurit, gjykata kishte emëruar një përfaqësues të përkohshëm për të dhe kishte arritur të shpall emërimin në fjalë në gazetën serbe "Novosti," që shpërndahet në tërë Serbinë. Përkundër këtyre përpjekjeve për të ndjekur kornizën ligjore dhe për të mundësuar të paditurin për të marrë pjesë në rastin që ishte në zhvillim kundër tij, gjykata vazhdoi procedurën pa praninë e tij dhe përfundimisht vendosi që të atribuoi pronësinë mbi pronën e kontestuar palës së tretë. Vendimi përfundimtar kur nuk i ishte komunikuar të paditurit i cili përkundër të gjitha përpjekjeve për ta gjetur atë kishte mbetur në mos-dijeni për atë se ekzistonte një rast i iniciuar kundër tij në gjykatë.

---

<sup>85</sup> Disa gjykata vazhduan të shpërfillin procedurën e shpalljes me të cilën publikohet vendimi për të emëruar përfaqësuesit e përkohshëm në gazetata në gjuhën shqipe të publikuara vetëm në Kosovë.

<sup>86</sup> Megjithatë vlen të ceket se tre të paditur serb kishin kuptuar për këto raste të gjykatave nëpërmjet mjeteve tjera dhe lëshuan prokurën në emër të avokatëve të emëruar fillimisht si përfaqësues të përkohshëm. Që nga atëherë gjykata vazhdoi përkritazi me kërkesëpadinë kundër tre të paditurve përderisa rastet e mbetura mbeten në pritje e sipër përderisa vendndodhja e të paditurve ende është e panjohur dhe gjykata është duke bërë përpjekje për t'i gjetur ata.

Ndonëse këta shembuj tregojnë përpjekjet e disa gjykatave për të ndjekur rekomandimet e lëshuara nga OSBE-ja dhe për të respektuar procedurën ligjore mbi emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm ato nuk kanë qenë krejtësisht të suksesshme. Në fakt, në shumicën e rasteve nuk ishte e mundshme që të gjendet vendndodhja e të paditurve në mungesë nëpërmjet të Departamentit të Drejtësisë dhe shpalljet e emërimeve të përfaqësuesve të përkohshëm shumë rrallë ishin në gjendje të publikohen në gazetata serbe. Sidoqoftë, siç tregojnë shembujt e fundit është e mundshme që të publikohet një shpallje e tillë në gazetën në gjuhën serbe dhe për këtë arsye përpjekjet e tilla janë të lavdërueshme. Megjithatë, shumica e sfidave për të respektuar ligjin dhe të drejtat e të paditurve ende duhet të tejkalohen.

Nëse këta janë shembuj të praktikave të mira në shumicën e rasteve gjykatat kanë vazhduar që të mos respektojnë procedurën ligjore mbi emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm. Gjykatat kanë dështuar shpesh që të arsyetojnë vendimet e tyre për të emëruar përfaqësuesin e përkohshëm bazuar në nevojën për t'ju shmangur vonesës së gjatë të procedurës, dhe nuk kanë përzgjedhur përfaqësuesin e përkohshëm nëpërmjet të procedurave të qarta dhe transparente, dhe në vend të kësaj kanë pranuar përsëri përfaqësuesit që sugjerohen dhe paguhen nga paditësit. Për më tepër rezultati i punës së përfaqësuesve të përkohshëm vazhdoi që të jetë i dobët dhe pasiv që shkonte në dëm të të paditurve në mungesë. Shembujt në vijim ilustrojnë këto lloje të problemeve.

Në një rast pronësor të paraqitur më 26 shkurt 2004 pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, një përfaqësues i përkohshëm ishte emëruar për të mbrojtur të paditurin në mungesë me sugjerim të paditësit. Pas urdhrit të kryetarit të trupit gjykues gjatë gjykimit avokati i paditësit pagoi përfaqësuesin e përkohshëm për shërbimet e tij me vlerë 101 euro me para ta gatshme. Rezultati i punës së përfaqësuesit të përkohshëm në këtë rast ishte tejet i dobët duke marrë një rol pasiv gjatë procedurës duke mos kundërshtuar listën e parregullt poseduese të shfrytëzuar si dëshmi gjatë paditësit madje edhe duke konfirmuar faktet e padisë në të mirë të paditësit. Gjykata vendosi që të miratojë kërkesëpadinë si të bazuar duke shfrytëzuar deklaratat e përfaqësuesit të përkohshëm në mbështetje të kërkesës si dëshmi valide.<sup>87</sup>

Në një rast pronësor të iniciuar më 23 korrik 2004 pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, u emërua përfaqësuesi i përkohshëm për të mbrojtur një serb të Kosovës adresa e tanishme e të cilit në Serbi ishte e panjohur për gjykatën. Për shkak se kontrata e blerjes mbi të cilën ishte bazuar padia ishte djegur gjatë konfliktit, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit pas vërtetimit nëpërmjet të marrjes në pyetje të dëshmitarëve se paditësi ka okupuar pronën për më shumë se 30 vite i propozoi gjykatës se kërkesa duhet të korrigjohet për të bazuar të drejtën e pronësisë së paditësit mbi bazën e posedimit të fituar, në vend se në kontratën e shkatërruar të shitblerjes. Pas propozimit të përfaqësuesit të përkohshëm, kryetari i trupit gjykues urdhëroi paditësin të korrigjojë padinë. Në këtë rast përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit ishte mjaft pro-aktiv, mirëpo në favor të paditësit në vend se të klientit të tij që mungonte.

Shembujt e përshkruar mësipër që përfaqësojnë një trend të gjerë të rasteve të tilla në Kosovë tregojnë se në shumicën e rasteve, gjykatat dështojnë në përmbajtjen e rregullave procedurale mbi emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Fakti se ligji nuk përkufizon në mënyrë të qartë metodën e pagesës së përfaqësuesit të përkohshëm është një problem shtesë, për shkak se gjykatat thjeshtë aplikojnë rregullin e përgjithshëm të bazuar në shpenzimet e procesit ligjor

---

<sup>87</sup> Në aktgjykim gjykata deklaroi se “nga gjithë çka është thënë, dëshmitë e administruara, pranimit i deklaratës së kërkesëpadisë nga përfaqësuesi i përkohshëm (...), gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.”

dhe urdhërojnë paditësin që të paguajë shpenzimet.<sup>88</sup> Kjo praktikë ngrit dyshimet e fuqishme për animet e përfaqësuesit të përkohshëm ndaj paditësit që ia paguan honorarin, që janë konfirmuar në mënyrë të vazhdueshme në rastet e monitoruara nga OSBE-ja ku përfaqësuesi i të paditurit në mungesë ishte qoftë pasiv apo ka vepruar në favor të paditësit. Kjo gjendje rezulton në mosrespektimin e të drejtave të të paditurve në mungesë, zakonisht pronarët e pronave të përkatësisë serbe të cilët nuk shohin drejtësinë duke u realizuar dhe si rrjedhojë nuk mund të parashohin një kthim në pronat e tyre të mëhershme në Kosovë.

Në fakt edhe nëse gjykatat bëjnë përpjekje për të ndjekur procedurat ligjore, një aplikim korrekt dhe efikas i mekanizmit të përfaqësuesit të përkohshëm në praktikë është mjaft i komplikuar për shkak të problemeve sistemore siç janë vështirësia e madhe në gjetjen e vendndodhjes së palëve në mungesë apo mungesa e bashkëpunimit ndërmjet të autoriteteve në Serbi dhe Mal të Zi dhe autoriteteve në Kosovë. Në këtë kontekst, për momentin është tejet vështirë që të gjindet një zgjidhje për këtë problem të ndërlikuar që do të respektonte dispozitat ligjore të procedurës kontestimore dhe të drejtave të të gjitha palëve për gjykim të drejtë brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Me qëllim të gjetjes së një zgjidhje për këtë problem Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës kërkoi nga Gjykata Supreme në Kosovë që të nxjerr një rekomandim përkitazi me zbatimin e duhur të ligjit të zbatueshëm në rastet që kanë të bëjnë me emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm në procedurat civile veçanërisht kur të paditurit vijnë nga radhët e komuniteteve pakicë. Si përgjigje në këtë kërkesë, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dërgoi një letër më 13 mars 2006 të gjitha gjykatave në Kosovë duke i udhëzuar të gjithë kryetarët e gjykatave që të ndalojnë me praktikën e emërimit të përfaqësuesve të përkohshëm deri kur Gjykata Supreme të nxjerr një mendim për atë se si duhet të merreni me këto çështje.<sup>89</sup> Edhe pse nxjerrja e mendimit këshillëdhënës nga Gjykata Supreme mund të ndihmojë në harmonizimin e zbatimit të ligjit mbi përfaqësuesit e përkohshëm nga të gjitha gjykatat në Kosovë, mundësisht duke kontribuar në rritjen e efikasitetit të sistemit, udhëzimi i dërguar gjykatave për të ndaluar të gjitha rastet e tilla derisa mendimi i tillë të nxirret, nuk është i bazuar në ligj dhe përbën një ndërhyrje jo të duhur në pavarësinë e gjykatave. Ky udhëzim jo vetëm që bie jashtë kompetencave të Gjykatës Supreme, e cila nuk mund të jep urdhra për gjykatat tjera për pezullimin e lëndëve që janë në zhvillim e sipër, mirëpo gjithashtu edhe parandalon palët në ato raste që të kenë qasje në drejtësi pa vonesa të panevojshme për aq derisa zgjat pezullimi. Për këtë arsye, për momentin ende nuk ekziston ndonjë zgjidhje sa i përket problematikës së rasteve pronësore të iniciuara kundër personave në mungesë, për shkak se përfaqësuesi i përkohshëm nuk është mekanizëm efektiv në praktikë dhe gjykatat janë në pritje e sipër të udhëzimeve nga Gjykata Supreme për atë se si të vazhdohet me këto raste.

### 3. Trashëgimia nga e kaluara

Është fakt përgjithësisht i pranuar se kërkesat ligjore formale për transaksionet pronësore shumë rrallë janë respektuar nga njerëzit në Kosovë në ta kaluarën. Ky realitet mund t'u atribuohet disa faktorëve siç është kultura e brishtë ligjore apo fakti se shumë njerëz kishin zgjedhur për të mos i respektuar këto formalitete në mënyrë që t'i shmangen pagesës së taksave për transaksionet pronësore. Një nga sqarimet për këtë gjendje të çështjes ishte ekzistimi i ligjeve diskriminuese të miratuara nga qeveria serbe që kufizonin qarkullimin e pasurisë ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve serbe dhe shqiptare në Kosovë.<sup>90</sup> Këto ligje

<sup>88</sup> Neni 152 i LPK-së parasheh që secila palë mbulon shpenzimet që i ka shkaktuar vetë me veprimet e veta.

<sup>89</sup> Siç kanë vërtetuar monitoruesit e OSBE-së, pas pranimit të letrës së Gjykatës Supreme, gjykatat në Kosovë kanë ndaluar që të merren me rastet kur ekziston ndonjë propozim për të emëruar përfaqësuesin e përkohshëm për palën në mungesë. Të gjitha këto raste janë në pritje e sipër derisa gjykata supreme të nxjerr një mendim që udhëzon gjykatat për atë se si duhet vazhduar.

<sup>90</sup> Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet në transaksionet e paluajtshmërive të publikuar në *Gazetën Zyrtare të Serbisë*, Nr. 30 i 22 korrikut 1989; Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji të

nënshtrojnë çdo kontratë të pronës që lidhet ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike të Kosovës për miratim nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore,<sup>91</sup> duke siguruar që qarkullimi i tillë i pasurisë nuk mund të ndodhë në rast se ata të kenë shkaktuar ndryshimin e strukturës nacionale të popullatës apo emigrimin e anëtarëve të një kombi përkatës apo kur qarkullimi i tillë i pasurisë do të mund të provokonte trazira, pasiguri dhe jo-barazi kundrejt pjesëtarëve të ndonjë grupi tjetër etnik në Kosovë.<sup>92</sup>

Edhe pse UNMIK-u revokoi këto ligje diskriminuese në vitin 1999,<sup>93</sup> para kësaj date ky legjislacion kishte ndikuar që shumë serbë dhe shqiptarë të Kosovës të lidhin kontratat e shitblerjes të cilat nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore për vlefshmërinë e tyre. Kjo trashëgimi e bën punën e gjykatave në vendosjen e kontesteve pronësore mjaft të vështirë duke marrë parasysh mungesën e shpeshtë të shënimeve formale që do të dëshmonin transaksionet e vjetra pronësore. Pas konfliktit në Kosovë ky problem u rëndua edhe më tepër për shkak të zhvendosjes së njerëzve, shpërbërjes së institucioneve dhe shkatërrimit fizik apo zhdukjes së kontratave dhe shënimeve kadastrale për të drejtat pronësore, duke krijuar një gjendje ku dëshmitë në rastet pronësore janë përgjithësisht të dobëta me shumë pak dokumente zyrtare për dëshmimin e të drejtave pronësore. Si rezultat i gjithë këtyre faktorëve, gjykatat në përgjithësi është dashur që të nxjerrin aktvendime gjyqësore mbi kontestet pronësore duke u bazuar vetëm në deklaratat e dëshmitarit. Këto dëshmi zakonisht propozohen nga e vetmja palë që merr pjesë në rast për shkak se pala që mungon nuk ka mundësi të kontribuojë në procedurën e provave dhe të ndihmojë gjykatës në gjetjen e të vërtetës.

Përfundimisht, korniza ligjore që rregullon të drejtat pronësore është aq e komplikuar dhe e shpërndarë sa që krijon vështirësi shtesë për gjykatat në zbatimin e ligjit. Ligjet pronësore që për momentin janë në fuqi<sup>94</sup> janë të shumta dhe të shpërndara nëpër disa tekste ligjore që rregullojnë të gjitha aspektet e ndryshme të të drejtave pronësore dhe shpesh u referohen institucioneve të cilat nuk ekzistojnë më. Për të ndërlikuar më tej situatën, që nga viti 1999 disa rregullore të UNMIK-ut janë miratuar në mënyrë të njëpasnjëshme mbi çështjet pronësore të cilat paraprakisht janë rregulluar me ligjet jugosllave duke rezultuar me huti të madhe legjislative pa qartësi sa i përket bashkëveprimit ndërmjet shumë ligjeve para ardhjes së UNMIK-ut mbi të drejtat pronësore dhe ndryshimeve të mëpasme në sistem përmes rregulloreve të reja të UNMIK-ut. Ky prodhim i shtuar dhe josistematik i legjislacionit ka krijuar një kornizë ligjore tejet të ndërlikuar që është tejet e vështirë për t'u kuptuar dhe zbatuar nga gjykatat që merren me çështjet e qarkullimit të pasurisë (e lëre më nga individët që duhet të ndjekin kërkesat ligjore në kontratat pronësore), duke ndikuar kështu në zgjidhjen e kontesteve pronësore. Së këndejmi, harmonizimi ligjor do të ishte i dobishëm për sistemin e të drejtave pronësore.

### 3.1. Kontratat joformale

Një nga problemet më të zakonshme që ndikon në kontestet pronësore rrjedh nga ekzistimi i gjerë i kërkesave pronësore bazuar në kontratat joformale apo gojore që d.m.th, transaksionet

---

publikuar në *Gazetën Zyrtare të Serbisë*, Nr. 42 të 28 shtatorit 1989, dhe në *Gazetën Zyrtare të Serbisë* Nr. 22 të 18 prillit 1991, më tutje LNPTP.

<sup>91</sup> Departamenti i Ministrisë së Financave i qeverisë së Serbisë.

<sup>92</sup> Neni 3 (1) i LCSLRET. Në praktikë, pushteti që ligji lejonte dhe bazat e pakuptimta të aplikimit të tij kanë rezultuar në aplikimin diskriminues që parandalon të gjitha transaksionet pronësore ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës.

<sup>93</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/10 mbi anulimin e legjislacionit diskriminues që ndikon në të drejtat banesore dhe pronësore nga PSSP-ja më 13 tetor 1999.

<sup>94</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 dhe Rregullores së UNMIK-ut 2000/59, përkundër rregulloreve të UNMIK-ut të miratuara nga PSSP-ja, ligji i zbatueshëm në Kosovë është ligji që ishte në fuqi gjer më 22 mars 1989, plus ligjet e caktuara të cilat ishin në fuqi pas asaj date dhe të cilat nuk ishin diskriminuese.

pronësore të cilat dështojnë të plotësojnë kërkesat ligjore për vlefshmëri por të cilat pa marrë parasysh atë, pranohen si dëshmi nga gjykatat.

Sipas ligjit, “[k]ontrata në bazë të së cilës bartet e drejta për shfrytëzim apo pronësi të paluajtshmërisë, duhet të përpilohet me shkrim dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen në gjykatë” (përkthimi jozyrtar).<sup>95</sup> Përkundër vërtetimit gjyqësor, transaksionet pronësore të paluajtshmërisë janë gjithashtu objekt i regjistrimit në librat kadastral, kërkesë formale e obligueshme veçanërisht në rastet kur bartja bëhet nëpërmjet të veprimeve gjyqësore.<sup>96</sup> Shumë ligje tjera i referohen rëndësisë së regjistrimit kadastral për sistemin e mbrojtjes së pronës si bazë themelore e dëshmisë në të cilat bazohet puna e gjykatës përkitazi me qarkullimin e pasurisë.<sup>97</sup>

Përkundër kësaj kornize ligjore OSBE-ja ka identifikuar disa raste gjyqësore në të cilat padia ishte bazuar në kontratat e shitblerjes të cilat kanë dështuar që të përmbushin këto kërkesa mirëpo ende janë pranuar si dëshmi të vlefshme nga gjykatat në kundërshtim me ligjet e përmendura.

Në dy raste të ngjashme pronësore pranë Gjykatës Komonale në Gjilan/Gnjilane, i njëjti paditës, shqiptar i Kosovës kërkoi më 1 korrik 2004 që gjykata të pranojë të drejtat e tij pronësore mbi pronat të cilat ai gjoja i ka blerë prej dy serbëve që gjenden të zhvendosur në Serbi vendndodhja e të cilëve është e panjohur. Në të dyja rastet kërkesa është bazuar në kontratat gojore të shitblerjes që kurrë nuk janë vërtetuar në gjykatë apo regjistruar në kadastër të lidhura ndërmjet të palëve shumë vite më parë në prani të dëshmitarëve. Për shkak se të paditurit kishin ikur për në Serbi pas konfliktit, paditësi nuk mundet të rregullojë gjendjen dhe kështu kërkoi nga gjykata që të pranojë të drejtat e tij pronësore me qëllim të regjistrimit të tyre në zyrën kadastrale. Edhe pse nuk ka pasur dokumente zyrtare të paraqitura si dëshmi dhe se të paditurit që mungonin nuk kishin përfaqësim në procedurë, gjykata aprovoi kërkesën bazuar kryesisht në dëshmitë e dëshmitarëve të palës paditëse.<sup>98</sup> Gjykata më tutje i konsideroi kontratat gojore si bazë e vlefshme sipas të cilës paditësi mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmerinë që është objekt i kontestit duke konsideruar që ato hynë në fuqi posa palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre (të paguajnë çmimin dhe të dorëzojnë posedimin). Mungesa e çfarëdo kërkesave formale për transaksionet e paluajtshmerive as që është konsideruar nga gjykata.<sup>99</sup>

<sup>95</sup> Neni 4(2) i ligjit për bartjen e pronës së paluajtshme, më tutje LBPP.

<sup>96</sup> Përfshirë vërtetimin e kontratave nëpërmjet të procedurës jokontestimore dhe aktgjykimet në kontestet pronësore që është mjet i zakonshëm i fitimit të të drejtave pronësore nëpërmjet të bartjes së tyre. Shih nenin 33 dhe 20(1) të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore, më tutje LMTHP të publikuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Kosovës*, Nr. 6/80, më 1 shtator 1980.

<sup>97</sup> Shih për shembull nenin 3 (2) të ligjit për matjen dhe kadastrin e tokës të publikuar në *Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*, Nr. 12/80, sipas të cilës “kadastrin e tokës është dëshmia e vetme për tokën dhe objektet në të.” Shih gjithashtu nenin 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut N. 2002/22 për shpalljen e ligjit N. 2002/05 për themelimin e regjistrimit të të drejtave pronësore të paluajtshme të publikuar më 20 dhjetor 2002, që thekson se “të drejtat pronësore të pronës së paluajtshme që i përkasin tokës, ndërtesave dhe banesave regjistrohen në regjistër.”

<sup>98</sup> Duhet të ceket se përfaqësuesi i përkohshëm i palëve të paditura kishte mbetur pasiv duke mos propozuar kurrfarë dëshmish në mbrojtje të klientëve të tyre që mungojnë dhe duke mbështetur gjithmonë kërkesat e tyre.

<sup>99</sup> Gjykata u thirr në nenin 73 të ligjit për kontratat dhe detyrimet (*Gazeta Zyrtare e RSFJ-së*, N. 29/1978) për të përfunduar që mungesa e formës me shkrim të kontratës nuk ka ndikuar në vlefshmërinë e këtyre transaksioneve pronësore përderisa palët kontraktuese të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuese. Megjithatë, ky argument nuk mund të zbatohet për shkak se transaksionet pronësore në fjalë kërkojnë jo vetëm të kenë formë me shkrim mirëpo edhe të vërtetohen në librat kadastral (neni 33 i LBPR). Këto janë kërkesa themelore formale pa të cilat transaksioni nuk konsiderohet si obligative në aspektin ligjor (lexo nenin 4 (3) të LTRP).



Në një lëndë tjetër pronësore pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane një shqiptar i Kosovës paraqiti padinë më 26 shkurt 2004 kundër një serbi të Kosovës bazuar në kontratën me gojë që siç pohohet ishte lidhur më 2 shkurt 2000. Për shkak se në atë kohë gjykatat në Kosovë nuk kanë funksionuar si duhet, palët nuk kanë mundur t'i formalizojnë kontratat e tyre me shkrim dhe t'i vërtetojnë ato në gjyq ashtuqë ishin pajtuar që ta regjistrojnë këtë bartje të pasurisë në një datë të mëvonshme.<sup>100</sup> Pasiqë i padituri më vonë kishte lëshuar Kosovën, paditësi kishte humbur dijeninë për vendndodhjen e tij dhe si rrjedhojë e kësaj ishte bërë e pamundshme të vërtetohet kontrata e shitblerjes siç ishin pajtuar palët. Kështu, paditësi kishte kërkuar që gjykata të vërtetojë transaksionin e pretenduar, duke u bazuar në dëshmitë e dhëna në gjyq nga dëshmitarët të cilët kishin qenë të pranishëm gjatë lidhjes së kontratës gojore. Bazuar në këta dëshmitarë, të cilët ishin propozuar vetëm nga paditësi për shkak se i padituri mungonte dhe përfaqësuesi i tij i përkohshëm nuk propozoi kurrfarë dëshmish, gjykata aprovoi padinë duke pranuar kontratën gojore si mjet të përshtatshëm nëpërmjet të së cilës mund të bartet prona e kontestuar dhe duke konsideruar se nga dëshmitë e dëshmitarëve ishte vërtetuar se të dyja palët kontraktuese kishin përmbushur detyrimet e tyre.<sup>101</sup>

Përderisa në shembullin e parë të përshkruar më lartë dështimi i palëve për të respektuar kërkesat ligjore për bartjen e pasurisë rezultonte nga konteksti shoqëroro-politik që mbretëronte në Kosovë në atë kohë kur gjoja ishte kryer shitblerja, në shembullin e dytë mungesa e kontratës valide ishte për shkak të gjendjes së dobët të sistemit gjyqësor menjëherë pas konfliktit kur thjeshtë nuk ishte e mundur që të ndiqen procedurat ligjore. Nëse konteksti që qëndron pas secilës situatë është i rëndësishëm për të kuptuar problemin e mospërfilljes të kërkesave më elementare formale për qarkullimin e pasurisë, mënyra se si gjykatat kishin vepruar nuk mund të jetë immune nga kritikata. Në secilin rast gjykata kishte dështuar që të respektojë rregullat elementare të të drejtave pronësore të cilat parashikojnë që kontratat për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme duhet të bëhen me shkrim, të vërtetohen në gjykatë dhe regjistrohen në librat kadastral ose përndryshe ato nuk janë detyimore.<sup>102</sup> Duke pranuar kontratat gojore si mjet i vlefshëm për bartjen e pasurisë dhe aprovimin e padive pronësore bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve në vend të dokumenteve zyrtare, gjykata kishte shpërfillur ligjin në mënyrë flagrante.

Përderisa mbështetja në kontratat gojore si bazë për padi pronësore është identifikuar nga OSBE-ja në disa raste, një numër i madh i lëndëve pronësore të monitoruara bazoheshin në kontratat joformale të shitblerjes të lidhura me shkrim mirëpo kurrë të vërtetuara në gjykatë apo të regjistruara në librat kadastral. Këto lloje të lëndëve përbëjnë një trend shqetësues duke pasur parasysh se njëra nga palët në kontest në përgjithësi mungon gjatë procedurës dhe si rezultat gjykata mbështetet kryesisht në dëshmitë e propozuara nga paditësi.

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, paditësi, shqiptar i Kosovës, kishte paraqitur padi më 17 nëntor 2003 duke pandehur se kishte fituar të drejtën mbi pronën e kontestuar në bazë të kontratës së lidhur shumë vite më parë me të paditurit, që ishin pesë serbë të Kosovës që për momentin janë të zhvendosur në Serbi. Për shkak të ligjeve diskriminuese që ishin në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, palët nuk ishin qenë në mundësi që të vërtetojnë këtë kontratë në gjykatë dhe ta regjistrojnë bartjen e pasurisë në kadastrë. Si rezultat, e vetmja dëshmi e paraqitur në gjykatë ishte kontrata e pavërtetuar në gjykatë dhe deklaratat e dëshmitarëve që dëshmonin në të mirë të paditësit. Të paditurit, adresat e të cilëve në Serbi janë të panjohura, që të

<sup>100</sup> Së pari nëpërmjet të vërtetimit të kontratës në gjykatën komunale në Vranjë, Serbi, pastaj duke e përdorur atë vërtetim zyrtar që të vërtetojë kontratën pranë gjykatës komunale në Gjilan/Gnjilane.

<sup>101</sup> Shih vërejtjet në fusnotën 75.

<sup>102</sup> Neni 4 i LTRP-së.

gjithë mungonin gjatë procedurës, dhe përfaqësoheshin nga një përfaqësues i përkohshëm i cili nuk kishte propozuar kurrfarë dëshmish. Përkundër mungesës së dëshmive të përshtatshme për të provuar fitimin e të drejtës pronësore, gjykata kishte aprovuar kërkesëpadinë bazuar në dëshmitë e dhëna në gjyq nga dëshmitarët dhe duke e konsideruar kontratën me shkrim të lidhur nga palët si formë të vlefshme për bartjen e pasurisë në të cilën thirret kërkesëpadia.

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, më 21 nëntor 2003, paditësi që ishte shqiptar i Kosovës kishte kërkuar që t'i njihej e drejta e tij ligjore mbi pronë duke pandehur se ai kishte fituar të drejtën pronësore mbi pronën e kontestuar në bazë të një kontrate me shkrim të lidhur me të paditurin serb të Kosovës i cili mungonte gjatë procedurës dhe ishte i zhvendosur në Serbi. Kjo kontratë kurrë nuk ishte vërtetuar pranë gjykatës apo ishte regjistruar në kadastrë, por megjithatë gjykata e pranoi atë si bazë e vlefshme për fitimin e të drejtës mbi pronë, duke aprovuar kërkesëpadinë vetëm në bazë të kontratës me shkrim dhe deklaratave të paditësve. Kështu, pa mbledhur së paku dëshmi në të mirë të paditurit, përfaqësuesi i të cilit kishte qëndruar pasiv, gjykata kishte urdhëruar njohjen gjyqësore të të drejtave pronësore të paditësit dhe regjistrimin e tyre në zyrën kadastrale.

Siç demonstron këta shembuj, përkundër kërkesave të detajuara ligjore të përcaktuara për bartjen e paluajtshmërisë, gjykatat kanë shpërfillur në mënyrë të vazhdueshme këto kërkesa gjatë vendosjes lidhur me kontestet pronëse. Edhe pse ligji është mjaft i qartë në këtë drejtim, që thekson se transaksionet pronësore të cilat dështojnë të përmbushin këto kërkesa formale nuk kanë karakter ligjor obligativ, gjykatat përsëri kanë vendosur që t'u japin vlerë ligjore këtyre transaksioneve të realizuara qoftë në mënyrë gojore apo me shkrim me nënshkrime të pavërtetuara në gjykata dhe jo të regjistruara në zyrën kadastrale. Megjithatë ekziston një alternativë ligjore për zgjidhjen e këtyre rasteve pa u mbështetur në kontratat e pavlefshme të shitblerjes që përbëhet nga provimi i parashkrimit fitues të pronës nga ana e paditësit gjatë periudhës kohore të përshkruar në nenin 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore. Megjithatë paditësit nuk kishin bazuar kërkesën e tyre në parashkrimin fitues dhe gjykatat nuk kishin konsideruar këto në aktgjykimet përfundimtare të tyre<sup>103</sup> Për më shumë, fakti se këto vendime bazohen vetëm në dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar nga paditësi pasiqë i padituri në mungesë zakonisht nuk është në dijeni për lëndën në gjykatë, ngrit shqetësime shtesë jo vetëm për shkak të mosrespektimit të sundimit të ligjit mirëpo gjithashtu edhe të mungesës së mbrojtjes që gjykatat ua ofrojnë palëve që mungojnë në këso padi.

### *3.2 Problemet rreth pronës së trashëguar*

Kur të merren parasysh shkatërrimet institucionale që kanë ndodhur në Kosovë si rezultat i ngjarjeve të viteve 90-ta, si dhe konfliktin gjatë viteve 1998-99, është e natyrshme se disa çështje me të cilat ballafaqohen gjykatat sot kanë origjinën e fakteve dhe rrethanave nga e kaluara. Shumë nga rastet që janë në shqyrtim kanë filluar në vitet e 90-ta, para gjykatave të përbëra krejtësisht me gjyqtarë serbë, dhe ishin pezulluar për disa vite për shkak të konfliktit. Përveç kësaj, si pasojë e konfliktit, shumë prona janë shkatërruar dhe dokumentet zyrtare (siç janë të dhënat kadastrale mbi paluajtshmërinë ose regjistrat civil të individëve) janë zhdukur. Në rastet tjera, njëra nga palët ka vdekur ose është zhvendosur, dhe kontesti prapë përmban objekt të papërcaktuar. Këto situata, të rënduara pas një zvarritje të gjatë të procedurës, vjetërsia e fakteve dhe dëshmive, ia vështirësojnë gjykatave që në ditët e sotme të merren me

<sup>103</sup> Në rast kut padisa pronësore ngritet në bazë të nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore, porta e dëshmive do të jetë mjaftë e hapur që të mos lejohet aprovimi i padisë duke u bazuar vetëm në deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga paditësi, duke kërkuar në këtë mënyrë mjete tjera dëshmuese me të cilat arsyetohet vendimi i gjykatave.

këto konteste të vjetra pronësore, pasi në shumë raste ato nuk posedojnë të gjitha elementet e kërkuar a për t'u zgjedhur rasti në mënyrë adekuate.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, ishte ngritur një padi pronësore më 23 shtator 1997 kundër komunës së Pejës/Peć, nga se kjo e fundit e kishte për qëllim ta eksproprijojë shtëpinë e paditësit. Si rezultat i konfliktit në Kosovë ky rast nuk kishte përfunduar, dhe kishte mbetur i suspenduar deri në vitin 2005, kur ishte riinicuar nga ana e avokatit të paditësit. Në ndërkohë, kjo pronë e kontestueshme ishte shkatërruar, paditësi kishte vdekur dhe përfaqësuesit e komunës ishin ndërruar. Në vend që ngrihet padia e re, avokati i paditësit e kishte shndërruar padinë e mëparshme në kërkesë për kompensim, pa ndonjë parashtresë tjetër në formë të shkruar. Përkundër të gjithë këtyre ndërrimeve, gjykata kishte pranuar të vazhdojë me këtë rast, edhe pse përfshinte paditësin i cili kishte vdekur, një objekt i cili nuk ekzistonte më dhe me një padi me kërkesë tjetër (për kompensim në vend se për mbrojtje të pronës). Faktori i vetëm i përbashkët i rastit të tanishëm me atë që ishte inicuar në vitin 1997 është prezenca e avokatit të paditësit, autorizimi i të cilit për përfaqësimin e paditësit, pa ndonjë intervenim të trashëgimtarëve duket i dyshimtë.

Në tri raste të njëjta para Gjykatës Komunale në Pejë/Peć paditësi, ndërmarrje shoqërore, kishte kërkuar që t'i njihet e drejta ligjore pronësore mbi tre dyqane në qendër të Pejës/Peć, dhe largimin e të paditurve të cilët tanimë i kishin uzurpuar ato. Këto dyqane ishin shkatërruar gjatë konfliktit, ishin rindërtuar nga ana e komunës së Pejës/Peć dhe iu ishin dhënë të paditurve, të cilët tanimë ishin pronar të një pjese të lokaleve. Sipas të paditurve, këto janë prona të reja të paluajtshme, pasi pronat e kërkuara paditësi nuk ekzistonin më, kështu edhe padia duhet të refuzohet pasi objekti i padisë nuk ekziston më. Për të komplikuar këtë rast edhe ashtu të vështirë, edhe pse ishte bërë rindërtimi mbi rrënojat e objektit të vjetër të rrënuar por që i kishte muret ende aty, zyra kadastrale kishte bërë regjistrim të ri të asaj prone. Kështu, tani për tani ekzistojnë dy parcela kadastrale që i referohen të njëjtës pronë, secila parcelë në emër të njëres nga palët në këtë kontest të ndërlikuar pronësor.

Në dy raste të ngjajshme pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, padia pronësore, që ishin parashtruar më 1 dhjetor 2004 dhe 29 maj 2005, ishin bazuar në kontratat me shkrim të bëra para konfliktit dhe që ishin shkatërruar gjatë konfliktit. Pasi të paditurit serbë të Kosovës mungonin gjatë procedurës, ata nuk kishin mundur që drejtëpërdrejtë të kundërshtojnë faktet e pandehura nga paditësit ose të paraqesin dëshmi në mbrojtjen e tyre. Dhe si pasojë, gjykata ishte ballafaquar me konteste për të cilin nuk kishte ndonjë dokument zyrtar për ta bazuar vendimin e saj, dhe iu kishte dashur që të mbështetet vetëm në dëshmitarët e propozuar nga ana e paditësve. Në këtë rast, ngjarjet e konfliktit pronësor kishin ndikuar në procedurat e provave duke penguar kështu punën e gjykatës në vlerësimin e së vërtetës.

Në të gjitha këto raste, ngjarjet të cilat çështje të jashtme të punës së gjyqësisë kishin ndikuar në punën e gjykatave për të arritur vendim adekuat. Këto probleme kryesisht janë të ndërlidhura me ndikimin që konflikti në Kosovë ka pasur në funksionimin e institucioneve dhe sundimit të ligjit, duke shkaktuar pengesa në jetën institucionale dhe duke shkatërruar dëshmitë dhe të objekteve esenciale për punën e gjykatave. Kështu, për shkak të këtyre rrethanave të jashtme gjykatat nuk kishin qenë në gjendje t'i shqyrtojnë këto raste në mënyrë të kënaqshme, për shkak se kapaciteti i tyre të vlerësojnë dëshmitë dhe faktet ishte tejte i kufizuar për shkak të ngjarjeve që drejtëpërdrejtë i atribuohen konfliktit.

#### 4. Rekomandimet:

- Çdo dokument zyrtar i lëshuar në Serbi dhe Mal të Zi dhe që është parashtruar në gjykatat e Kosovës si dëshmi për kontestet pronësore ose në procedurën për certifikimin e transaksioneve pronësore duhet t'i referohen Departamentit të drejtësisë, në mënyrë që të bëhet verifikimi i origjinalitetit të atij dokumenti;
- Gjykata duhet të vazhdojë me kontestin pronësor ose procedurën e certifikimit vetëm pasi që dokumenti i sipërpërmendur të vërtetohet dhe konsiderohet nga ana e Departamentit të drejtësisë të jetë autentik; nëpërmjet kontakteve me institucionet në Serbi dhe Mal të Zi që e kanë lëshuar atë dokument, duke ia atribuar atij validitetin zyrtarë;
- Nëse Departamenti i Drejtësisë ose gjykata ka dyshim se dokumenti i cili është prezantuar si dëshmi në ndojnë rasti pronësor është i falsifikuar, do të duhet që *ex officio* t'ia referojë rastin autoritetve ndjekëse për fillimin e hetimeve për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, bazuar në nenin 197(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.<sup>104</sup>;
- Të gjitha regjistrat kadastrale në Kosovë duhet të rregullohen dhe të azhurnohen;
- Kur dokumentet e parregullta kadastrale prezantohen si dëshmi në kontestet pronësore, gjykatat duhet që t'i referojnë ato dokument zyrtarë kadastrale që supozohen të kenë lëshuar ato dokumente, në mënyrë që të vërtetohet origjinaliteti i tyre, para se ato të pranohen si dëshmi;
- Në rast se gjyqtarët nuk i vërejnë parregullsitë të dokumenteve të paraqitura kadastrale si dëshmi të drejtave pronësore, avokati i palës kundërshtare duhet të sfidojë pranueshmërinë e atyre dokumenteve si dëshmi;
- Kurdoherë që i padituri në një kontest pronësor mendohet të jetë jashtë Kosovës, dhe kur gjykata nuk e din vendndodhjen e tij/saj, gjykata do të dorëzojë thirrjen në Departamentin e drejtësisë në mënyrë që të gjejë se ku është i padituri nëpërmjet lidhjeve zyrtare me autoritetet në territorin në të cilin i padituri për momentin është duke jetuar;
- Departamenti i drejtësisë duhet të përmirësojë mekanizmat e gjetjes së vendndodhjes së palëve që mungojnë të cilët për momentin jetojnë në Serbi dhe të Mal të Zi, si dhe të përmirësojë procedurat e verifikimit të origjinalitetit të dokumenteve të lëshuara në atë territor dhe që janë prezantuar pranë gjykatave në Kosovë, dhe këtë ta bëjë nëpërmjet një bashkëpunimi të ngritur me autoritetet në Beograd dhe Podgoricë;
- Kryetarët e gjykatave duhet të sigurojnë që gjyqtarët civil janë të vetëdijshëm për karakterin e veçantë të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm dhe për nevojën për të shfrytëzuar një organ relevant kompetent administrative, ose kur të jetë e domosdoshme, mjetet e arsyeshme alternative në mënyrë që të di për vendndodhjen e palëve që mungojnë para se t'i qasen kësaj mase;
- Së fundi, kryetarët e gjykatave duhet të sigurojnë se të gjithë gjyqtarët janë të vetëdijshëm për mundësinë që kanë autoritetet gjyqësore të UNMIK-ut. për kërkimin e të dhënave personale nga regjistri civil qendror në bazë të Urdhërësës administrative

<sup>104</sup> Aprovuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26

të UNMIK-ut nr. 2002/16 Kërkohet nga gjyqtarët të shfrytëzojnë shërbimet e regjistrat civil qendror për tentimet e tyre të gjejnë vendndodhjen e të paditurve;

- Në përputhje me kërkesat e nënvizuar në ligj, gjyqtarët të cilët lëshojnë vendimin për të caktuar përfaqësuesin e përkohshëm duhet të cekin se çfarë hapash janë ndërmarr për të ditur se ku gjendet vendndodhja e të paditurve, dhe të demonstrojnë se çfarë dëmi mund të ketë prej shtyrjeve nëse përcillet procedura e rregullt për caktimin e përfaqësuesit ligjor;
- Kur të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurit që i takojnë komuniteteve minoritare, gjyqtarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të publikuar ato shpallje në mënyrë të rregullt. Në veçanti, nëse të paditurit në mungesë janë serbë të Kosovës, caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm duhet të shpallet në gazeta në gjuhën serbe, do të ishte e preferuar edhe në ato të cilat dalin në Serbi dhe Mal të Zi, në mënyrë që të forcojë edhe më shumë përpjekjet e gjykatës;
- Njësitë për inspektim gjyqësor duhet të hetojë rastet kur caktohet përfaqësuesi i përkohshëm ligjor në mënyrë të ngutshme ose pa arsytim të duhur;
- Sa i përket praktikave jo-uniforme në zgjedhjen e përfaqësuesve të përkohshëm, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të lëshojë një opinion ligjor që e qartëson procedurën e këtij emërimi;<sup>105</sup>
- Gjykata Supreme e Kosovës duhet të ndalojë me dhënien e udhëzuesve gjykatave për të suspenduar rastet që janë në shqyrtim, duke kufizuar veprimet e saja në lëshimin e qarkoreve këshilluese sipas autorizimeve që ka me ligj;
- Gjykatat në Kosovë nuk do të duhej t'i përmbahenin çfarëdo lloj udhëzimi nga Gjykata Supreme e Kosovës që i urdhëron ato që ta pezullojnë rastin ku përfshihet përfaqësuesi i përkohshëm;
- Do të duhej të aprovohet një ligj i ri që do të rregullonte në mënyrë të qartë mënyrën e pagesës së përfaqësuesit të përkohshëm, i cili nuk do të duhej të paguhet nga paditësi në mënyrë që të evitohen konfliktet e interesave të avokatit i cili vepron si përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurin në mungesë;
- Oda e avokatëve të Kosovës duhet të ndërmer veprime disiplinore kundër anëtarëve të saj që dështojnë t'i përmbushin detyrat e tyre kur ata të jenë të caktuar si përfaqësues të përkohshëm;
- Në paditë pronësore të bazuara në kontratat për shitblerje të pronës, gjykatat nuk duhen të vendosin duke u bazuar vetëm në kontratat gojore dhe ato joformale të shitblerjes, që nuk janë të vërtetuara në gjykatë e as të regjistruara nëpër librat kadastrale, pa ndonjë dëshmi tjetër që do të vërtetonte të drejtën pronësore;
- Do të duhej të të aprovohet një ligj i ri i cili do të harmonizonte sistemin e të drejtave pronësore në të gjitha aspektet e tij, duke filluar nga kërkesat formale të shitblerjes së pronës deri në posedimin e fituar, prej regjistrimit të pronës në regjistrat kadastrale deri te e drejta e servitutit, duke zëvendësuar kështu ligjet e shpërndara që i rregullojnë këto çështje. Ligji i ri për të drejtat pronësore duhet të azhurnohet sipas situatës së tanishme në Kosovë, pa ndonjë referencë në institucione në sistemin jugosllav i cili nuk ekziston më.

<sup>105</sup> Shih nenin 31 (7) të Ligjit mbi gjykatat e (Gazeta zyrtare e KSAK 21/78).

### Kapitulli 3

#### NDËRHYRJET NË PROCEDURAT GJYQËSORE DHE GJYQËSIA

Një ndër parimet më të rëndësishme që qeveris një shoqëri demokratike është ndarja e kompetencave. Kompetencat legjislative, përmbarese dhe gjyqësore duhet të ndahen dhe zyrtarët të cilët punojnë në këto degë duhet të përmbahen nga ndërhyrja në fushat tjera jashtë kompetencave të tyre. Në Kosovë, parimi i ndarjes së kompetencave është pjesë e Kornizës Kushtetuese, që citon se “[I]PVQ-të dhe zyrtarët e tyre do të [...] [p]romovojnë dhe respektojnë parimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet legjislacionit, përmbaruesit dhe gjyqësisë.”<sup>106</sup>

Sa i përket gjyqësisë, parimi i ndarjes së kompetencave përbënë në garanci shumë të rëndësishme të pavarësisë së saj, ashtu siç është dhënë edhe me standardet ndërkombëtare.<sup>107</sup> Sipas Parimeve themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësisë, “[ë]shtë detyrë e të gjitha institucioneve qeveritare dhe institucioneve tjera që të respektojnë dhe observojnë pavarësinë e gjyqësisë,” e cila do të vendosë për çështjet para tyre dhe pa ndonjë “kufizim, ndikime të parregullta, nxitje, presione, kërcënime ose ndikime të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nga çdo kënd apo për çfarëdo arsye të ndryshme.”<sup>108</sup>

Në nivelin rajonal, e drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshëm është kërkesë themelore mbi të drejtën për gjykim korekt siç është e mbrojtur edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe me legjislacionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>109</sup>

OSBE ka identifikuar disa shembuj në të cilat autoritetet lokale dhe qendrore kishin provuar apo edhe me të vërtetë kanë ndërhyrë në procedurat gjyqësore. Këto veprime janë ndërmarr ose nga ana e autoritetit vendor i cili kishte ndërhyrë në punën e gjykatave nëpërmjet ndikimit të tyre në fushat tjera që kështu i kanë refuzuar t’i përmbahen urdhëresave gjyqësore në rastet kundër komunave, ose nga Departamenti i Drejtësisë (DD) nëpërmjet udhëzuesve të drejtpërdrejt që i kishin dërguar në gjykata me ç’rast u kishin urdhëruar gjyqtarëve që mos të vazhdonin me disa kategori të veçanta të rasteve. Edhe pse mund të ketë disa arsye për këtë ndërhyrje të DD-së, mënyra se si kjo është bërë, pa ndojnë afat kohor të definuar dhe pa

<sup>106</sup> Kapitulli i II i Rregullores së UNMIK-ut 2001/9, 15 maj 2001 mbi Kornizën kushtetuese për IPVQ në Kosovë.

<sup>107</sup> Shih nenin e 10 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut, e cila citon se “Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij.” I njëjti parim gjithashtu është garantuar edhe me Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, që në mënyrë të dukshme i referohet “[...] nga një panel të pavarur, dhe të paanshëm i themeluar me ligj [...]” Dhe në mënyrë më të veçantë, Komisioni mbi të drejtat e njeriut ka theksuar rëndësinë e sigurimit të pavarësisë së gjyqësisë nga degët ekzekutive dhe legjislative (Komisioni për të drejtat e njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 13, *barazia para gjykatave dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur themeluar sipas ligjit*, Neni 14 (3).

<sup>108</sup> Parimet themelore të KB mbi pavarësinë e gjyqësisë, paragrafët 1 dhe 2, të adoptuara në kongresin e shtatë të KB për parandalimin e krimit dhe trajtimin të të paditurve, e mbajtur në Milano 26 gusht deri 6 shtator 1985 dhe i vërtetuar me Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të KB 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985. ky dokument më tutje citon se “nuk duhet të ketë ndonjë ndërhyrje e parregullt në procesin gjyqësor” dhe kishte theksuar dhe parimin “e autorizon dhe kërkon nga gjykata që të sigurojë që procedurat gjyqësore të kryhen në mënyrë të drejtë dhe të respektohen të drejtat e palëve në procedurë” (paragrafët 4 dhe 6).

<sup>109</sup> Neni 6 (1) i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Në një të *Campbell dhe Fell kundër MB/UK*, A 80 par. 33, 81 (1984), Gjykata evropiane kishte deklaruar se kur bëhet vlerësimi i pavarësisë së gjykatës, duhet të kihet parasysh “mënyra e caktimit të anëtarëve dhe kohëzgjatjes së detyrës së tyre zyrtare, ekzistencës së garancive kundër ndikimeve të jashtme dhe pyetjes së a paraqet ai trup gjykues paraqitjen e pavarësisë.”

prezantuar ndonjë zgjidhje alternative për rastet e pezulluara, shkel mbi pavarësinë e gjykatave. Ky kapitull do t'i adresoj këto çështje dhe do të ofrojë shembuj konkret ku autoritetet zyrtare në mënyrë jo të rregullt kishin ndërhyrë në rastet në gjykata.

### 1. Ndërhyrjet jo të rregullta nga ana e autoriteteve komunale

Njëri nga problemet e identifikuar nga ana e OSBE-së kishte qenë ndërhyrja e autoriteteve lokale nëpër procedurat gjyqësore. Në disa shembuj autoritetet komunale haptazi i kishin penguar procedurat gjyqësore, në rastet tjera ata kishin bërë presion mbi gjyqtarët në lidhje me kontestet në të cilat ata ishin palë, përderisa në një numër të rasteve ata kishin shfrytëzuar autoritetin e tyre që të ndikojnë në palën e tretë dhe kështu kishin parandaluar gjykatat që të ushtrojnë detyrën e tyre. Format e tilla të ndërhyrjes në gjyqësi e shkelin parimin e ndarjes së kompetencave rrezikojnë pavarësinë e gjyqësisë.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Prizren një palë kishte ngritur padi kundër komunës më 2 prill 2005, duke kërkuar zbatimin e një marrëveshje gjyqësore.<sup>110</sup> Gjatë rrjedhës së procedurës gjyqtari që merrej me rastin ishte parandaluar që të bëjë inspektimin e vendit në tri raste të ndryshme. Kjo pengesë ishte shkaktuar nga refuzimi i ekspertit të gjeodezisë (punëtor i komunës) që të jetë prezent në inspektim dhe të kryej detyrën e tij siç ishte urdhëruar nga gjykata. Gjatë seancës së mbajtur më 20 qershor 2005, ky ekspert e kishte arsyetuar veprimin e tij duke deklaruar se ai kishte vepruar sipas urdhrave të Drejtoratit komunal për gjeodezi dhe kadastër që ai mos ta bëjë ekspertizën e kërkuar. Dhe si rezultat i kësaj procedura ishte penguar për një kohë në dobi të komunës e cila ishte palë e paditur në këtë rast.

Edhe pse nuk ishte paraqitur asnjë urdhër me shkrim e komunës, nga eksperti për të arsyetuar thëniet e tija në rastet e sipërpërmendura, OSBE mendon se deklarata e tij është e besueshme. Në fakt, urdhëresa e supozuar e Drejtoratit në fjalë përputhet me refuzimin e komunës që të respektojë marrëveshjen gjyqësore dhe me tentimet e vazhdueshme të saj që të parandalojë përmbarimin e asaj marrëveshje duke parashtruar një padi të re para gjykatës komunale kishte sfiduar vlefshmërinë e marrëveshjes gjyqësore. Urdhëresa e sipërpërmendur e Drejtoratit përbën ndërhyrje jo-legjitime me procedurat gjyqësore dhe në rrjedhën e duhur të drejtësisë. Pasi të gjithë ekspertët e licencuar të gjeodezisë janë punëtorë të komunës, veprimi i komunës në mënyrë të suksesshme e kishte parandaluar që të bëhet inspektimi i vendit. Duhet të theksohet se sipas ligjit të zbatueshëm, eksperti është i obliguar që t'i kryej detyrat të cilat kërkohen nga autoritetet gjyqësore.<sup>111</sup> Veç kësaj, ligji gjithashtu përcakton se “organet shtetërore janë të obliguara që t'i ndihmojnë gjykatat në kryerjen e funksioneve të tyre.”<sup>112</sup> Kështu, veprimi i komunës së Prizrenit, përbën ndërhyrje jo të rregullt në procedurën gjyqësore, duke penguar punën e gjykatës dhe shkelur ligjet procedurale.<sup>113</sup>

Përveç ndërhyrjes në procedurat kontestimore, OSBE gjithashtu kishte identifikuar edhe rastet kur komuna në mënyrë të suksesshme kishte ndërhyrë në procedura përmbaruese. Kjo ndërhyrje kryesisht kishte të bëjë me pengimin e përmbarimeve, nëpërmes ushtrimit të ndikimit të komunave në subjektet tjera duke i parandaluar ato t'i përmbahen urdhrave të gjykatës.

<sup>110</sup> Marrëveshja gjyqësore kishte përbërë transferimin e posedimit të pronës nga komuna në paditësin.

<sup>111</sup> Neni 253 (1) LPK.

<sup>112</sup> Neni 18 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta, *Gazeta zyrtare KSAK, nr. 21/78*.

<sup>113</sup> Në këto raste gjykatat duhet t'i referohen zyrës së prokurorit publik për çdo tentim të ndërhyrjes së parregullt që do të vinte nga ana e anëtarëve të komunave dhe që do të shpinte në mbajtjen e përgjegjësisë penale të ndjekur sipas detyrës zyrtare *ex officio*, në pajtim me obligimin e tyre të paraparë nën nenin 197 të KPPPK, të promulguar nëpërmjet rregullores së UNMIK-ut 2003/26 të 6 korrikut 2003.

Në lidhje me një numër të konsiderueshëm të përmbarimeve pranë Gjykatës Komunale të Vushtrrisë/Vučitrn, kryetari i gjykatës i kishte treguar OSBE-së për një njoftimin me shkrim që ia kishte bërë Drejtori i Bankës "KSB" duke e informuar gjykatën se më 10 dhjetor 2004 ai kishte pranuar instruksionet nga kryetari i kuvendit komunal që mos t'i ekzekutoj vendimet e gjykatës kundër asaj komune ose përndryshe ajo (komuna) do të mbyllte të gjitha llogaritë në atë bankë. Sipas informatave të marra në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë/Vučitrn, që nga prilli i vitit 2005, kishte pasur më shumë se dyzet raste në të cilat Kasabanka kishte dështuar t'i përbushte urdhrat e gjykatës që ishin nxjerr në procedurat përmbaruese.

Të gjitha rastet e sipërpërmendura tregojnë për shembujt ku komuna kishte ndërhyrë me, ose kishte tentuar të ndërhyjë në punën e gjyqësisë duke shkelur kështu ligjin e aplikueshëm, dhe që kishte rezultuar në pengesë për administrimin e gjyqësisë nga gjykatat. Këta shembuj tregojnë mospërfilljen e autoriteteve komunale për autoritetin e gjykatave që nuk janë vetëm shkelje e obligimeve të institucioneve publike për t'i ndihmuar gjykatave në ushtrimin e funksioneve të tyre,<sup>114</sup> por gjithashtu është edhe një praktikë brengosëse për arsye se kjo paraqet prirje të komunave që t'i shkelin parimet e ndarjes së kompetencave mbi të cilat bazohen sistemet demokratike.

## *2. Ndërhyrjet jo të rregullta nga ana e Departamentit të Drejtësisë*

OSBE-ja, në nivele të ndryshme është e vetëdijshme që një numër i konsiderueshëm i padive të parashtruara nga serb të Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve për kompenzim dëmi të pronës të shkatëruara pasi NATO kishte hyrë në Kosovë në vitin 1999 janë duke u mbajtur të pezulluara pas një letre të DD-së dërguar në adresë të kryetarëve të gjykatave të qarkut, komunale dhe kryetarit të gjykatës supreme në gusht të vitit 2004.<sup>115</sup> OSBE kishte intervistuar një numër të gjyqtarëve civil lidhur me këtë çështje dhe ka konstatuar se pas pranimit të asaj letre gjykatat nuk ishin marrë me asnjërin nga paditë që binin në atë kategori. Njëra nga arsyetimet e dhëna nga ana e DD-së për mbajtjen pezull të atyre rasteve ishte fakti se një ngarkesë e madhe e rasteve të tilla do të kërkonte një përkrahje të madhe logjistike, për shkak se në të kundërtën do të pengonte shumë punën e gjykatave, duke i ngritur numrin edhe ashtu të madh të lëndëve. Dhe arsyeja tjetër e atyre instruksioneve ishte fakti se shumica e paditësve serbë të Kosovës do të kishin nevojë për përcjellje në udhëtimin e tyre për në gjykata për shkaqe sigurie, që gjithashtu do të kërkonte planifikime dhe koordinime të veçanta në ofrimin e transportit për një numër aq të madh të paditësve.

Në pikëpamjen e kornizës ligjore në Kosovë<sup>116</sup> dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e vendosur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), OSBE-ja është e mendimit se letra e sipërpërmendur paraqet një ndërhyrje të parregullt nga ana e ekzekutivit në funksionimin e gjyqësisë, pasi që gjykatat nuk duhet të pranojnë instruksione nga asnjë aktor i jashtëm lidhur me atë se cilat raste t'i dëgjojnë së pari dhe cilat t'i mbajnë pezull. Menaxhimi i lëndëve është funksion i gjyqësisë, kështuqë është në kompetencën e gjyqtarëve të vendosin si ta menaxhojnë numrin e madh të lëndëve, në mënyrë të pavarur nga autoritetet ekzekutive. Për më tepër, udhëzimet e dhëna nga DD-ja seriozisht e kanë kompromituar të drejtën për qasje në gjykatë të paditësve serbë të Kosovës, dhe rezikon që t'a shkel të drejtën e tyre për të pasur një rast të gjykuar brenda kohës së arsyeshme.<sup>117</sup>

<sup>114</sup> Neni 18 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta, *Gazeta zyrtare KSAK, nr. 21/78*.

<sup>115</sup> Sipas statistikave të Departamentit të administratës gjyqësore, ishin parashtruar mbi 17.000 ankesa nga serbët e Kosovës për dëmet e pronës së tyre që ishin bërë pas vitit 1999.

<sup>116</sup> Kapitulli II i Rregullorës së UNMIK-ut 2001/9, e 15 Majit 2001 mbi Kornizën Punuese Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë

<sup>117</sup> Kjo çështje gjithashtu kishte ngritur brengat brenda Institutit të Ombudspersonit në Kosovë, i cili e kishte adresuar këtë çështje në Departamentin e drejtësisë në shumë raste. Shih raportin e pestë vjetor të Ombudspersonit-vitit 2004-2005 i adresuar PSSP-së të KB, 11 korrik 2005, mund të gjendet në <http://www.ombudspersonkosovo.org>.



GjEDNj ka cekur disa raste se e drejta për qasje në gjykatë është pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë dhe kjo duhet të pasqyrohet në mënyrë efikase.<sup>118</sup> Edhe pse nën disa rrethana të veçanta autoritetet mund të bëjnë kufizime sa i përket ushtrimit të kësaj të drejte, ‘margjina e vlerësimit’ që kanë ata në dispozicion nuk duhet të shpij deri te kufizimet të cilat mund të dëmtojnë esencën e të drejtës.<sup>119</sup> Për më tepër, çdo kufizim duhet të ketë “qëllimin legjitim” dhe duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, që do të thotë se duhet të jetë “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit në mes mjeteve të shfrytëzuara dhe qëllimit që duhet të arrihet.”<sup>120</sup> Duke pasur parasysh këto kërkesa, arsyet për suspendim janë të debatueshme.<sup>121</sup>

Problemi kryesor nuk është arsyetimi i parashtruar nga DD-së për intervenimin e vet në këto raste, por mënyra se ai intervenim ishte ndërmarrë në shkelje të standardeve për të drejtat e njeriut siç është përcaktuar nga GjEDNj. Në disa situata Gjykata Evropiane kishte pranuar ndërhyrjen qeveritare në procedura gjyqësore, përmes suspendimit të përkohshëm të një numri të madh lëndësh që i përkisnin çështjes së njejtë, që përfaqëson një problem sistematik në rrethanat e post-konfliktit, duke i kufizuar kështu palës të drejtën për qasje në drejtësi në pajtim të qëllimit legjitim.<sup>122</sup> Megjithatë, sipas gjykatës këto pezullime duhet të jenë të përkohshme (me një kufizim të qartë kohor), do të duhet të bëhet në pajtim me ligjin si dhe në ndërkohë duhet të prezantohen masa të reja apo legjislacion i ri në mënyrë që të korrigjohet problemi.<sup>123</sup> Këto kërkesa për kufizim të së drejtës së palëve për qasje në gjykatë nuk ishin përmbushur situatën në fjalë. Së pari, për shkak se kërkesës për suspendim të këtyre rasteve të përfshira në letër i mungonte ndonjë bazë ligjore dhe binin jashtë kompetencave të DD-së.<sup>124</sup> Së dyti, pezullimi krijoi paqartësi ligjore sepse asnjë afat kohor nuk ishte definuar në lidhje me kohëzgjatjen e tij. Përfundimisht, intervenimi nuk i përmbushi kërkesat e përcaktuara nga GjEDNj për shkak se prej se vitit 2004 kur letra ishte dërguar, DD-ja nuk kishte prodhuar ndonjë masë apo legjislacion të ri për të zgjidhur problemin duke e lënë të pavendosur deri në ditët e sotme.<sup>125</sup> Rrjedhimisht intervenimi i DD-së jo vetëm që ka ndikuar në pavarësinë e gjykatave por edhe ka kufizuar të drejtën e qasjes në gjykatë për më shumë se 17.000 paditësve, serb të Kosovës pa ndonjë bazë ligjore, duke e parandaluar kështu kompensimin për personat të cilëve i është shkatëruar prona që nga viti 1999 përmes shfrytëzimit të së drejtës për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme

Në një rast para Gjykatës Komunale në Gjakovë/Đakovica, Kisha Ortodokse Serbe kishte ngritur padi më 12 gusht 2004 kundër komunës së Gjakovës/Đakovica,

<sup>118</sup> Shih aktgjykimet nga gjykata për rastin *Golder kundër UK*, A 18, 1975 dhe *Airey v. Irland*, A32, 1979.

<sup>119</sup> Shih *Ashingdane v. UK*, A 93, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, paragrafi 57 (1985).

<sup>120</sup> *Ibidem*. Shih gjithashtu *Lithgow v. UK*, A 102, par. 194 (1985).

<sup>121</sup> Pasiqë ka shumë raste tjera civile të inicuar nga serbë të Kosovës që për momentin janë të zhvendosur në Serbi, të cilat nuk janë suspenduar për shkak të ofrimit të përcjelljes së paditësve për në gjykatë, Në fakt, në shumicën prej atyre rasteve palët, serbë të Kosovës në të vërtetë vijnë vetëm në gjykatë për t’i mbrojtur paditë e tyre.

<sup>122</sup> Shih *Kutic v Kroacisë*, nr. 48778/99, GJEDNJ 2002-II

<sup>123</sup> Shih *Acimovic v Kroacisë*, nr. 61237/00, GJEDNJ 2003-XI, dhe *Multiplex v Kroacisë*, nr. 58112/00.

<sup>124</sup> Departamenti i Drejtësisë mundet dhe shumë herë ka lëshuar qarkore të drejtësisë, direktiva jodetyrimore që kanë për qëllim të qartësojnë dhe harmonizojnë aplikimin e ligjit ekzistues nga ana e gjykatave. Mirëpo, letra në fjalë nuk i referohet aplikimit të ndonjë ligji ekzistues; por në të kundërtën, është një kërkesë, e inetrpretuar nga gjykatat si instruksion, e cila i thotë gjykatave që të mos e zbatojnë ligjin duke mos u marrë me një numër të konsiderueshëm lëndësh që binë nën jurisdiksionin e tyre.

<sup>125</sup> Në Mars të vitit 2006 UNMIK-u krijoi Agjencinë Kosovare për Pronë (AKP) përmes Regullores së UNMIK-ut 2006/10 në mënyrë që t’i adresoj paditë që kanë të bëjnë me pronën e paluajitshme duke përfshirë këtu kontestet për pronë banesore, bujqësore dhe ekonomike që rezultuan nga zhvendosja e komuniteteve pas konfliktit. Por KPA nuk ka jurisdiksion t’i zgjidh me mijëra padi për kompensim të dëmeve shkaktuara gjatë dhe pas konfliktit të cilat edhe më tej mbesin të pezulluara.

Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), UNMIK-ut dhe KFOR-it, për kompensimin e dëmit të shkatërrimit të tre kishave ortodokse në atë qytet pas vitit 1999, rrënojat e të cilave ishin mënjanuar gjatë trazirave të marsit të vitit 2004. Padiësit nuk e dinë se cilët individë i kishin shkatërruar kishat, por pasi të paditurit kishin mbajtur përgjegjësi për parandalimin e atyre akteve të dhunës, ata janë të obliguar që të bëjnë kompensimin e dëmeve të shkaktuara të padiësve. Shpejt pas ngritjes së padisë, më 26 gusht 2004, gjykata kishte pranuar instruksione nga DD-ja që kishte kërkuar që gjykatat t'u shmangen proceduarave kur kanë të bëjnë me padi të këtij lloji. Gjykata Komunale në Gjakovë/Đakovica iu ishte përmbajtur atyre instruksioneve, duke e mbajtur rastin të pezulluar për disa muaj, derisa padiësi kishte vendosur që të tërheq kërkesën më 2 shkurt 2005.<sup>126</sup>

Në këtë drejtim është e rëndësishme që të bëhet një dallim në mes padive të ngritura kundër UNMIK-ut ose KFOR-it, personeli i të cilëve ka imunitet që i garantohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/47, dhe të cilët mund të konsiderohet se bien jashtë mandatit të gjykatave dhe padive të ngritura kundër komunave të Kosovës apo individëve. Përderisa mund të ketë arsye legjitime valide për t'i mbajtur të pezulluara rastet kundër UNMIK-ut ose KFOR-it<sup>127</sup>, të njëjtat arsye nuk ekzistojnë edhe për ankesat për kërkim të kompensim të dëmit dhe që janë parashtruar kundër komunave ose individëve të cilët nuk e gëzojnë të njëjtin imunitet nga procesi ligjor. Kështu, sa i përket padive të parashtruara nga serbët e Kosovës kundër komunave dhe kundër individëve për kompensim të dëmit të pronës të shkaktuar pas vitit 1999, ndërhyrja e DD-së nuk ka baza ligjore, për shkak se si komuna, ashtu edhe individët duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre para gjykatave në Kosovë. Ndoshta duke pasur parasysh këtë dallim DD-Ja kishte lëshuar një letër të re më 15 nëntor të vitit 2005 që kishte kërkuar nga gjykatat që të procedojnë ato raste që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të bërë nga ana e individëve të identifikuar fizik pas tetorit 2000.<sup>128</sup>

Edhe po qëse letra e dytë ka për qëllim të krijojë një zhvillim pozitiv, me qëllim të sigurimit të qasjes në drejtësi për disa padiës, nuk është mënyrë e rregullt për të adresuar problemin. Së pari, të dërgohet një udhëzim në adresë të gjykatave dhe t'iu shpjegohet se cilat raste janë nën juridiksionin e tyre dhe që duhet të procedohen, dhe cilat raste duhet të mbahen pezull rezulton me ndërhyrje të parregullta me gjyqësi, ashtu siç është përshkruar më sipër. Gjykatat duhet të jenë të lira dhe të pavarura për të vendosur se cilat raste të duhet të procedohen duke u bazuar në kompetencat e tyre. Së dyti, edhe në qoftë se qëllimet për udhëzimin e dytë janë të mira, kjo në praktikë nuk e zgjidhë problemin. Kjo është për shkak se shumica e padive

<sup>126</sup> Në ndërkohë në komunën e Gjakovës/Đakovica, me pranimin e heshtur të zyrtarëve të UNMIK-ut, kishte autorizuar ndërtimin e monumentit memorial të "Martirëve të luftës së UÇK-së" në tokën ku më parë kishte qenë kisha, dhe monumenti ishte ngritur në dhjetor të vitit 2005. Kjo kishte shpie deri te intervenimi i PSSP-së që kishte shpërfillur vendimin e komunës e cila ia kishte dhënë tokën Shoqatës së veteranëve të luftës.

<sup>127</sup> Sipas neneve 2, 3 dhe 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe të personelit të tyre që punojnë në Kosovë. Sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, nëse parashtrohet ndonjë ankesë nga individët kundër këtyre institucioneve për shkatërrim të pronës e cila nuk kishte rezultuar për shkak të operacioneve ushtarake-të domosdoshme, UNMIK-u ose KFOR-i duhet të krijojë një Komision për shqyrtimin e ankesave për t'u marrë me ato ankesa. Për ç'do rast, të themi se kompetencat për të krijuar komisionet e tilla bien jashtë juridiksionit të gjykatave.

<sup>128</sup> Vlen të theksohet se arsyetimi në këto dy letra janë kundërtënëse. Arsyetimi për të pezulluar ankesat kundër komunave, KFOR-it dhe UNMIK-ut janë të njëjtat arsye të cilat ekzistojnë në relacionin e ankesave kundër individëve (siguria për padiësit serbë të Kosovës). Kështu, nuk ka ndonjë arsye pse ankesat e mëparshme duhet të mbahen të pezulluara përderisa ankesat e mëvonshme duhet të procedohen nga gjykatat. Udhëzuesi i dytë i DD-së duket se i injoron faktet e ofritit të sigurisë së serbëve të Kosovës që ata të vijnë nëpër gjykata, që duket se i arsyetojnë pezullimet e rasteve kundër komunave, UNMIK-ut dhe KFOR-it, gjithashtu ekzistojnë kur ankesat parashtrohen edhe kundër personave fizik. Kështu, sipas logjikës së njëjtë, nuk duhet të ketë arsye të vazhdohet me ankesat kundër personave por jo edhe me ankesat kundër komunave, KFOR-it dhe UNMIK-ut.

janë ngritur kundër komunave, UNMIK-ut dhe KFOR-it, dhe prapë të gjitha këto raste vazhdojnë të mbeten të pezulluara për arsye të letrës së parë të DD-së. Veç kësaj, edhe në rastet kur paditë ishin ngritur kundër individëve, për kompensim të dëmit, ato gjithashtu janë ngritur kundër komunave, KFOR-it dhe UNMIK-ut, kështu gjykatat janë duke iu përmbajtur letrave nga DD që mos i dëgjojnë rastet. Kjo është për shkak se përderisa komunat, KFOR-it dhe UNMIK-ut zakonisht janë palë të paditura, gjykatat për këtë shkak vendosin që mos të vazhdojnë me rastet kundër individëve sepse kjo do të kërkonte modifikimin e padisë.<sup>129</sup> Kështu, si rezultat i letrave të DD-së, dhe mënyrës se si janë të interpretuara ato nga ana e gjykatave, më shumë se 17.000 raste të këtij lloji mbeten të pezulluara për një kohë të paparashkuar.

Duhet të shtohet se letrat e sipërpërmendura janë të interpretuara nga shumica e gjyqtarëve të cilët merren me lëndët civile si të jenë gjithashtu të zbatueshme për ankesat për kompensim kundër komunave, dhe UNMIK-ut si rezultat i dëmeve të pronave të shkaktuara gjatë trazirave të marsit 2004. Në të vërtetë, një numër i gjyqtarëve i kishin thënë OSBE-së se ata kanë vendosur të mos i caktojnë seancat dëgjimore për ato lëndë për shkak të udhëzuesve të pranuar nga DD-ja, dhe si rezultat shumë pak raste civile janë proceduar sa i përket kompensimit të dëmit të pronës të shkaktuar gjatë trazirave të marsit të vitit 2004.

Dhe si pasojë, edhe pse shumë persona ishin dënuar për veprën penale të dëmtimit të pronës të shkaktuar gjatë trazirave të marsit 2004, OSBE-ja ende nuk ka identifikuar ndonjë rast civil për kompensim që kishte dalë si rezultat i atyre dënimeve. Në anën tjetër, ekzistojnë disa padi për kompensim dëmi të pronës së serbëve të Kosovës të shkaktuara gjatë trazirave të Marsit, të parashtruara kundër komunave, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut<sup>130</sup>, por ato ende mbeten të pezulluara deri në ditët e sotme, për shkak të instruksioneve të Departamentit të Drejtësisë.

Në katër padi të ngjashme të parashtruara para Gjykatës Komonale në Gjilan/Gnjilane nga ana e një numri i kushërinjve të serbëve të Kosovës si dhe fqinjëve të tyre nga i njëjti qytet, kundër komunës. IPVQ dhe UNMIK-ut, paditësit kishin kërkuar që t'u kompensohet dëmi i shkaktuar gjatë trazirave të marsit kur atyre u ishin rrënuar shtëpitë dhe ata ishin dashur që të ikin në Serbi. Pas letrave të DD-së, gjykata nuk është marrë aspak me këto raste duke i mbajtur ato pezull pa afat të caktuar kohor.

Përderisa shqyrtohet qështja e suspendimit për kohë të pacaktuar të këtyre kategorive të rasteve, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm për rolin e gjykatave nga pikëvështrimi i pavarësisë juridike. Gjykatat gjithashtu duhen të kuptojnë se ato kanë një rol në ruajtjen e pavarësisë së tyre në vlerësimin se cilat raste bien nën jurisdiksionin e tyre dhe cilat raste duhet të procedohen. Derisa rrethanat e jashtëzakonshme mund të hyjnë në lojë, siç është përshkruar më lart, ato janë përjashtime dhe mund të lejohen vetëm në disa parametra; si parim i përgjithshëm, gjyqësori do të duhet të jetë i liruar nga ndërhyrjet prej sektorëve tjerë të qeverisë.

<sup>129</sup> Vazhdimi me rast do të kërkonte modifikimin e padisë në mënyrë që të përjashtohet nga lista e palës përgjegjëse në këtë rast komunat, UNMIK-u dhe KFOR-i (rastet e ngritura kundër tyre janë pezulluar nga udhëzuesi i DD-ë) dhe referohet vetëm për t'u identifikuar personat fizik. Sipas nenit 190 të LPK modifikimi i padisë mund të bëhet vetëm atëherë kur ankuesi kërkon një gjë të tillë, dhe mbetet që gjykata të vendosë për ta aprovuar apo jo. Pasi gjykatat ishin udhëzuar që mos të merren fare me rastet, duket tw jetw e pamundshë që ata do të aprovonin një gjë të tillë sipas nenit 190 (6). Dhe si pasojë të gjitha këto raste kanë mbetur të pezulluara edhe përkundër udhëzuesit më të ri të DD-së që i obligojnë gjykatat që të vazhdojnë me personat fizik.

<sup>130</sup> Shumica e këtyre ankesave tregojnë se palët përgjegjëse ishin përgjegjëse për të imponuar rendin publik dhe të parandalonjë dëmet e trazirave të marsit, dhe kështu mbahen përgjegjëse për të bëjnë kompensimin e palëve ankuese për dëmet, duke u bazuar në nenin 180 të Ligjit mbi kontratat dhe detyrimet.

Është me rëndësi të shtohet se problemi i rasteve të pezulluara nga gjykata nuk ekziston vetëm për rastet e dëmeve të shkaktuara të pronës së serbëve të Kosovës që nga viti 1999, pasi për momentin ekzistojnë më shumë se 2.700 padi të pezulluara para gjykatave, të parashtruara nga shqiptarët e Kosovës kundër Serbisë dhe individëve serbë të Kosovës për dëmet e shkaktuara gjatë konfliktit të cilat gjithashtu mbahen pezull.<sup>131</sup> Edhe pse nuk ekziston ndonjë udhëzues nga DD-ja sa i përket këtyre rasteve, të gjitha ato janë pezulluar për shkak se gjykatat nuk kanë pasur kapacitet që të merren me padi për kompensim dëmi kundër personave që nuk janë prezent (shumica serbë të Kosovës vendndodhja momentale e të cilëve është e panjohur) si dhe mungesa e juridiksionit të gjykatave kosovare për t'i gjykuar rastet e ngritura kundër shtetit të Serbisë. Kur merret parasysh dimensionimi i problemit, ku shumica e dëmeve të pronave ishin shkaktuar gjatë konfliktit nga të gjitha palët në konflikt, dhe që ngritin çështjen e përgjegjësisë shtetërore për dëmet e shkaktuara kundrejt individëve, zgjidhjet e këtyre rasteve mund të bëhen vetëm me krijimin e *ad hoc* tribunalit ose të një komisioni të veçantë që do të mirrej vetëm me padi për kompensim dëmi të shkaktuar gjatë konfliktit në Kosovë.

### 3. Rekomandimet

- Autoritetet komunale dhe organet e tyre duhet të përmbahen nga çfarëdo ndërhyrje ose tentimet për ndërhyrjeve në punën e gjykatave.
- Zyrtarët komunal duhet të bashkëpunojnë me gjyqësorin, duke i ndihmuar gjykatave që t'i kryejnë detyrat e tyre dhe t'i ndërmarrin veprimet të cilat ua kërkojnë gjykatat.
- Gjatë kryerjes së detyrave, gjykatat duhet t'i referohen zyrës së prokurorit publik për çfarëdo tentimi të ndërhyrjes së parregullt që vjen prej anëtarëve të komunave ose nga ndonjë autoritet tjetër të Kosovës, në mënyrë që të konstatojnë ekzistimin e akteve që do të shpinin në përgjegjësinë penale të cilat *ex officio* do të ndiqeshin penalisht në pajtim me obligimet e tyre të paraparë me nenin 197 të KPPK.<sup>132</sup>
- Gjykatat duhet të jenë në përputhje me parimin e pavarësisë së gjyqësisë dhe të rezistojnë ndaj ndikimeve dhe presioneve të jashtme gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
- Në mënyrë që të janë në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi pavarësinë juridike, gjykatat në Kosovë duhet të vlerësojnë kompetencën e tyre për t'u marrë me paditë e ngritura në adresë të tyre dhe të vendosin se a të procedojnë apo jo me rastet të bazuara në kufinj të juridiksionit të tyre
- Në këtë drejtim gjykatat duhen ta shpallin vehten jokompetente dhe t'i procedojnë të gjitha paditë e parashtruara kundër personave të identifikuar për dëm të pronës të shkaktuar gjatë ngjarjeve që ndodhën që nga viti 1999 duke përfshirë këtu edhe paditë për kompensim që kanë të bëjnë me trazirat e Marsit të vitit 2004.
- Në drejtim të arsytimit të dhënë më lart, Departamenti i Drejtësisë duhet të merr parasysh ndryshimin apo revokimin e udhëzuesve të vet të lëshuara në Gusht 2004 dhe Nëntor 2005 përmes të cilave u është kërkuar gjykatave të mos i procedojnë paditë e parashtruara nga Serbët e Kosovës për kompenzim të dëmit të

<sup>131</sup> Sipas statistikave të marra nga Departamenti i administratës gjyqësore.

<sup>132</sup> Veprat e tilla penale mund të përfshijnë, për shembull, pengimin e dëshmitë, që paraqet veprë penale sipas nenit 309 të KPPK, të nxjerr nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2003/25 të 6 korrikut 2003, ose vepra penale e korrupsionit në formën e dhënies së mitos, sipas nenit 344 të të njëjtit kod.

shkaktuar nga ngjarjet që ndodhën që nga viti 1999. Kjo duhet të bëhet në pajtim me gjetjen e një zgjidhjeje alternative që adreson këto raste përbrenda kohës së duhur.

- Si zgjidhje e mundshme për paditë që bien jashtë juridiksionit të gjykatave të Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe UNMIK-u duhet të konsiderojnë krijimin e një komisioni të veçantë për ankesa për zgjidhjen e padive për kompensim të dëmit të shkaktuar si nga serbët e Kosovës, ashtu edhe nga shqiptarët e Kosovës, dhe që ishin shkaktuar në Kosovë që nga viti 1999, dhe të cilat mund të përfshijnë përgjegjësinë e KFOR-it, UNMIK-ut, Serbisë dhe Malit të Zi ose IPVQ-ve.

## Kapitulli 4

### ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Njëra nga veçoritë kryesore të sistemit të drejtë gjyqësor është ekzistimi i një strukture efikase për zbatimin e aktgjykimeve. Në fakt, derisa nuk është zbatuar vendimi përfundimtar i gjykatës, nuk është respektuar plotësisht e drejta për gjykim të drejt.<sup>133</sup>

Procedura përmbaruese është mënyra e zakonshme ligjore e mundësuar për të detyruar palën që të respektojë aktgjykimin përfundimtar ose çfarëdo obligimi tjetër që është i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme nëpërmjet një dokumenti përmbarues, në rast se ai/ajo nuk e zbaton atë vullnetarisht. Kështu, ekziston dallim i qartë në mes procedurës kontestimore dhe procedurës përmbarimore: përderisa procedura kontestimore përcakton ekzistimin e të drejtës për ankesë nga ana e njëjës palë në kontest gjyqësor, procedura e përmbarimit është e paraparë të jetë e drejtuar në realizimin efikas të drejtës së paraparë me ligj.

Në Kosovë, procedurat e përmbarimit janë të rregulluara me Ligjin mbi procedurën e përmbarimit.<sup>134</sup> Ligji përcakton dokumentet të cilat duhet të konsiderohen të jenë dokumente përmbaruese,<sup>135</sup> dhe të cilat mund të jenë bazë për propozimin e procedurës përmbaruese.<sup>136</sup>

Ky kapitulli i adreson shqetësimet e identifikuar nga OSBE- në lidhje me procedurën e përmbarimit. Shqetësimi kryesor i identifikuar është fakti se në shumë raste aktgjykimet detyrimore ose nuk ishin ekzekutuar, ose janë ekzekutuar me vonesa të mëdha, dhe kështu kanë penguar seriozisht të drejtën e një seance të drejtë gjyqësore brenda kohës së arsyeshme. Sipas informatave të mbledhura nga OSBE kjo bëhet për shkak të disa faktorëve siç janë shkelja e dispozitave të ligjit të procedurës së përmbarimit, ose kërcënimit dhe sulmeve kundrejt gjyqtarëve që janë të përfshirë në procedurën përmbaruese.

#### *1. Dështimi i gjykatave në procedimin e menjëhershëm të procedurës përmbarimore*

Sipas ligjit të zbatueshëm, pasi që kreditori të ketë parashtruar kërkesën për përmbarim, gjykata është e obliguar që menjëherë të procedojë dhe “të shqyrtojë rastin sipas radhës që e ka pranuar, përveç nëse natyra e kërkesës ose rrethanat e veçanta kërkojnë që të procedohet në ndonjë mënyrë tjetër”.<sup>137</sup> Ligji gjithashtu rregullon se si vendimi për përmbarim duhet të dorëzohet të kreditori dhe te debitori.<sup>138</sup> Këto dispozita kanë qëllim që të sigurojnë mbarëvajtjen e lehtë të procedurës përmbarimore, sipas radhës të cilën e ka pranuar propozimin për përmbarim nga ana e gjykatës.

Përkundër rregullave që kërkojnë veprim të shpejtë të gjykatave kur paraqitet propozimi për përmbarim, OSBE ka përcjellë raste në të cilat gjykatat nuk kanë vepruar shpejtë ndaj propozimit të kreditorit, dhe me këtë ka ndikuar në të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

---

<sup>133</sup> E drejta e parashtrimit të padisë që ka të bëjë me të drejtat dhe obligimet civile para gjykatës do të ishte ilustruese nëse aktgjykimi përfundimtar i gjykatës do të mbetej jo funksional në dëm të njëjës palë. Shih aktgjykimin e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut Hornsby v. Greece, ku gjykata kishte theksuar se “do të ishte e pabesueshme që neni 6(1) [i Konventës evropiane] do të përshkruante në detaje procedurat e garantuara për lehtësime-procedurat që janë të drejta, publike dhe ekspeditive-pa implementimin e vendimit gjyqësor.” GJEDNJ, 19 mars 1997, paragrafi 40.

<sup>134</sup> Shih nenin 1(1) të Ligjit mbi procedurën e përmbarimit, Gazeta zyrtare e RSFJ, nr. 29/78.

<sup>135</sup> Shih nenin I, kapitullin I të LPP, nenet 16 ff. .

<sup>136</sup> Nenet 34 ff. LPP.

<sup>137</sup> Nenet 2 (1) dhe 10(1) LPP.

<sup>138</sup> Neni 39 LPP.

Në një rast mbi marrëdhënie të punës para Gjykatës Komunale në Gjiilan/Gnjilane, më 15 qershor 2004 gjykata kishte shpallur aktgjykimin që kishte konstatuar shkarkimin e paditësit nga komuna të jetë jo e ligjshme.<sup>139</sup> Ky aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut Gjiilan/Gnjilane më 8 nëntor 2004.<sup>140</sup> Më 7 mars 2005, kreditori kishte parashtruar një kërkesë për përmbarrim për “rikthim në vendin e mëparshëm të punës dhe për kompensim të të ardhurave personale.” Asnjë vendim nuk ishte bërë nga autoritetet gjyqësore në lidhje me këtë kërkesë për përmbarrim. Dhe më vonë ky rast ishte parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës për t’u shqyrtuar<sup>141</sup>, por në ndërkohë kreditori kishte vdekur.

Në këtë rast, OSBE kishte vërejtur se gjykata fare nuk kishte proceduar me kërkesën për përmbarrim të parashtruar nga kreditori. Dhe në të kundërtën e asaj që është paraparë me ligj, vendimi për kërkesën për përmbarrim kurrë nuk ishte marrë.<sup>142</sup> Vlen të theksohet se sipas ligjit, kërkesa për rishqyrtim nuk do të ndalojë përmbarrimin e aktgjykimit përfundimtar.<sup>143</sup>

Në rastin e dytë para Gjykatës Komunale në Prizren, kishte pasur një aktvendim përfundimtar ku gjykata gjeti se i padituri kishte ndërhyrë në të drejtën e paditësit për posedimi në lidhje me një pjesë të paluajtshmërisë dhe kishte urdhëruar atë që të mos ndërhyjë.<sup>144</sup> Pasi i padituri kishte dështuar që t’i përmbahet asaj urdhërese, kreditori kishte parashtruar kërkesën për përmbarrim të aktgjykimit dhe kishte kërkuar nga gjykata që të gjobis debitorin.<sup>145</sup> Në këtë rast, seanca dëgjimore e caktuar për procedurën përmbarrimore ishte shtyrë tri herë (më 8 dhe 12 korrik 2005 dhe më 9 gusht 2005) pa ndonjë arsytim të duhur.<sup>146</sup>

Në të dyja rastet e përshkruara më sipër gjykatat kishin dështuar që të procedojnë me shkathësi kërkesën për përmbarrimin nga ana e kreditorëve. Ky dështim kishte shkelur të drejtat e kreditorit për të pasur aktgjykimin përfundimtar të ekzekutuar brenda kohës së arsyeshme.

## *2. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në procedurën për përmbarrim: frikësimi dhe korrupsioni i gjyqtarëve*

Për shkak të përgjegjësisë së drejtpërdrejt të zbatimit të aktgjykimeve përfundimtare të gjykatës, gjyqtarët përmbarrues lehtë mund të jenë cak të presioneve të ndryshme nga (si për shembull kërcënimet, ofendimet ose ofrimet e mitos), kjo komprometon aftësitë e tyre për t’u

<sup>139</sup> Edhe pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë kishte pranuar anulimi kërkesës së paditësit nuk kishte pasur bazë, gjykata nuk kishte gjykuar për të obliguar komunën për ta rikthyer atë në pozitën e mëparshme të punës. *De facto*, ky mosveprim kishte ndikuar në përmbarrimin e aktgjykimit. Megjithatë, kjo nuk duhet të paraqet pengesë në gjykatën që t’i përmbahet LPP.

<sup>140</sup> Duhet të theksohet se njëri nga problemet i cili do të mund të kishte ndikim negativ në përmbarrimin e aktgjykimit kundër komunave është fakti se komunat sipas rregullores UNMIK 2000/45 kërkojnë të argumentojnë për rastin. Sipas interpretimit, komunat e “reja” nuk do të mbahen përgjegjëse për veprat e kryera gjatë administratës së mëparshme. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka qenë e këtij pajtimi: “[...] ankesat e paditësve për palën përgjegjëse që është komuna në këtë rast, nuk mbanë përgjegjësi në relacionin e organeve komunale të autoritetit të mëparshëm, po qeveria e re komunale ... nga ana e gjyqit konsiderohet se kjo është e pa bazë”.

<sup>141</sup> Nenet 382 ff. LPK.

<sup>142</sup> Neni 10 (1) LPP.

<sup>143</sup> Neni 384 LPK.

<sup>144</sup> Sipas ankesës, vendimi ishte mbajtur pezull në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit.

<sup>145</sup> nenet 225 dhe 226 LPP.

<sup>146</sup> Në dy datat e para, gjykata ishte arsytuar për shtyrjet për shkak të dështimit të thirrjes së debitorit. Në datën e tretë, shtyrja ishte arsytuar në baza të kërkesës me shkrim që e kishte parashtruar avokati i debitorit, i cili kishte kërkuar shtyrjen e rastit derisa ai të kthehet nga pushimet verore. Sipas nenit 26 (5) LPP këto nuk mund të pranoheshin si bazë për shtyrje.

marr me përmbartimet në mënyrë të pavarur dhe efikase. Këta gjyqtarë janë më të ndjeshmit sa i përket kanosjeve dhe tentimeve për korrupsionit.

Gjatë periudhës së raportimit OSBE-e kishte vërejtur raste kur gjyqtarët përgjegjës për procedurën e përmbartimit kishin qenë të kërcënuar ose edhe ishin sulmuar gjatë kohës kur ata kishin tentuar që t'i kryejnë ekzekutimet.<sup>147</sup> Kjo është një çështje e shqetësimit serioz për shkak se kërcënimet e tilla dhe sulmet ndaj anëtarëve të gjyqësisë mund të rrezikojnë pavarësinë e tyre.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priştina që përfshihet kërkesa për përmbartim të një mase të përkohshme, më 6 qershor 2005 gjykata kishte vendosur që t'a shqiptoj masën e përkohshme dhe kishte urdhëruar debitorin që të ndalojë me ndërtimet në pronën që ishte në pronësi të kreditorit. Pasi që debitori nuk iu ishte përmbartur urdhrave të gjykatës, më 19 korrik 2005 gjyqtari përmbartues kishte tentuar që ta zbatojë vendimin. Megjithatë, përderisa gjykata ishte në vendin e ngjarjes debitori kishte sulmuar gjyqtarin dhe kreditorin. Policia pastaj kishte paraburgosur debitorin.

Fakti që individët përdorin forcën ose kërcënimin në mënyrë që të parandalojnë gjyqtarët të kryejnë detyrën e tyre, përveç se përbën vepër penale kjo tregon edhe mungesën e respektit të popullatës ndaj gjykatës, realitet i cili është brengosës sepse minon sundimin e ligjit. Në mënyrë që të luftohen këto praktika, është me rëndësi që gjyqtarët që përfshihen në një situatë të tillë, tua zbulojnë të dhënat relevante autoriteteve kompetente në mënyrë që shkelësit të ndiqen penalisht. Krahas kësaj, OSBE është e mendimit që siç është e paraparë në procedurën penale,<sup>148</sup> duhet të merret në konsideratë caktimi i një gjyqtari ndërkombëtar që të merret me raste civile (sidomos me lëndët ku përfshihen procedura të vështira përmbartimore).

Faktori tjetër i jashtëm që mund të ndikoj në procedurën e përmbartimit është korrupsioni. Edhe pse OSBE ka hasur vetëm në dy raste të praktikës së tillë,<sup>149</sup> kjo mund të jetë shqetësim që mund të ndikojë në rastet tjera ekzekutive. Zyra e Kombeve të Bashkuara për kontrollin e drogave dhe parandalimin e krimit ka konsideruar se shtyrjet e përmbartimit të urdhrave të gjykatës, mungesa e qasjes publike në të dhënat e procedurave të gjykatës në marrjen e vendimeve janë indikatorë për korrupsionin e gjyqësisë.<sup>150</sup> Këta faktorë janë të identifikuar nga ana e OSBE-së si një problem që ndikon në sistemin e gjyqësisë kosovare. Aq më tepër kur të mirren parasysh edhe pagat e ulëta të gjyqtarëve, kjo krijon një rrethanë në të cilën palët mundën lehtë që të ndikojnë te gjyqtarët në mënyrë që ata t'i përshpejtojnë rastet e tyre duke iu ofruar atyre mito, dhe gjyqtarët janë cak i lehtë i dhënies së mitos. Edhe pse janë vetëm disa raste të raportuara të korrupsionit në gjyqësi, kjo konsiderohet nga ana e popullatës së Kosovës të jetë një problem i madh që ndikon në sistemin gjyqësor.<sup>151</sup> Dhe duke e njohur rëndësinë e këtij problemi, UNMIK-u kishte hapur një zyrë të prokurorit special, në dhjetor të vitit 2004, në mënyrë që të hetojë krimet financiare dhe korrupsionin. Megjithatë, nuk ka pasur rezultate të dukshme deri më tani në punën e këtij njësi, për shkak se ka vetëm disa raste të lehta të korrupsionit pranë gjykatave, dhe si rezultat korrupsioni ende trajtohet si një

<sup>147</sup> OSBE gjithashtu kishte qenë e informuar nga ana e një gjyqtari cili merrej me procedurat për përmbartim se kishte pasur kërcënime gjatë përmbartimit të tyre, edhe nganjëherë sulme.

<sup>148</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 mbi Caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtar dhe/ose ndërrimin e vendit.

<sup>149</sup> Në njërin prej rasteve gjyqtari i procedurës përmbartuese ishte ndjekur për vepër penale të shtrëngimit sipas nenit 267 (1) të KPPK, për shkak se kishte shtyrë përmbartimin dhe kishte kërkuar para nga kreditori për të vazhduar me rastin. Dhe një rast tjetër është nën hetim.

<sup>150</sup> Shih raportin e ZKBKDP "forcimi i integritetit gjyqësor kundër korrupsionit" i lëshuar në mars 2001 pas konferencës së mbajtur në Vjenë.

<sup>151</sup> Sipas raportit të USAID mbi korrupsionin në Kosovë të korrikut 2003, të gjithë profesionistët avokatë të Kosovës janë të korruptuarit e tretë, dhe në vendin e katërt janë gjyqtarët. Ky përfundim ishte bazuar në anketimin, në të cilën personat ishin pyetur se cilët persona iu kishin kërkuar para të gatshme, dhurata për të zgjedhur rastet e tyre.



praktikë e përgjithshme dhe e padënueshme brenda sistemit gjyqësor. Në mënyrë që të ketë rezultat në këtë drejtim, kërkohet një luftim edhe më i madh i korrupsionit.

#### *4. Rekomandimet:*

- Gjyqtarët përbarues duhet të veprojnë menjëherë pas kërkesës së kreditorit për përbarim, në pajtim me ligjin mbi procedurën përbarimore.
- Instituti gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdojë me ofrimin e trajnimeve për gjyqtarët civil me tema të procedurave për përbarim, në veçanti në menaxhimin e rasteve, në mënyrë që të bëhen përbarimet në afat të caktuar kohor sipas ligjit.
- PSSP duhet të nxjerr një rregullore që lejon caktimin gjyqtarit ndërkombëtar në rastet civile, në veçanti ato raste që përfshijnë përbarimin e vendimeve të ndjeshme, ku gjyqtarët mund të jenë të prekur nga kërcnimet e palëve që të mos kryejnë përbarimet.
- UNMIK-u, me ndihmën e shteteve dhe organizatave donatore, duhet të forcojë kapacitetin e zyrës së prokurorit special për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht korrupsionin në një mënyrë më efikase, dhe kështu t'i dërgojë porosi të qartë gjyqësisë kosovare për luftimin e korrupsionit.
- Njësia e Inspeksionit Gjyqësor do të duhej të hetoj çfarëdo keqpërdorimi të gjyqtarëve që udhëheqin procedurat përbaruese që mund të qoj tek dyshimi për korrupsion apo që gjyqtari është objekt i kërcënimeve të jashtme ose formave tjera të presionit.